

Sebastien Gricourt u njoh me Shqipërinë para viteve '90 dhe kur u përpoq ta vizitonte si i ri, nuk mundi dot. Kjo sikur ia nxiti kërshërinë për vendin, gjuhën dhe kulturën tonë, ndaj filloi të mësonte shqipen dhe sapo u krijua mundësia, erdhi në Tiranë ku kaloi disa vjet. Gjatë kësaj kohe, u njoh me shkrimtarët shqiptarë dhe përktheu disa prej tyre. Aktualisht, punon pranë zyrës së KM në Kosovë dhe vijon përkthimim letërsisë shqipe në gjuhën frënge, duke ndihmuar edhe në lidhjen e autorëve nga Shqipëria me botuesit francez

SEBASTIEN GRICOURT

Njohja ime me gjuhën shqipe nga mosnjohja me Shqipërinë

Bisedoi Andreas Dushi



ExLibris

5 vjet nga numri i parë

Falenderim dhe mirënjohje të singertë lexuesit besnik dhe të gjithë bashkëpunëtorëve të nderuar, me ndihmën e të cilëve një ëndërr e dikurshme është bërë realitet.

FRANO KULLI DHE PROF. TEFË TOPALLI PËR BOTIMIN E RI TË VEPRËS SË MJEDËS:

E gjithë lënda poetike dhe shkrimet e tjera janë marrë nga botimet e para, më të hershmet, duke ruajtur origjinalitetin e tyre.

(fq. 4)

SHËNIME MBI LIBRAT

Të vërteta të "luftës së jetës" të Kadri Cakranit
**KUR HISTORIA SHKRUHET
NGA ATA QË KANË BËRË
HISTORI**

Nga Visar Zhiti

(fq. 16)

Shënime për romanin "Terror e dashuri" të autorit
Shkëlzen Maraveci

**MIDIS TERRIT
DHE DASHURISË**

Nga Behar Gjoka

(fq. 11)

**ETËHEM HAXHIADEMI DHE
GABRIELE D'ANNUNZIO:**

FATE TË SKAJSHME

Nga Shpend Sollaku Noë

(fq. 8)




"LETËRSI SHQIPE" APO "LETËRSI SHQIPTARË"?

Nga Agim Vinca

(fq. 11)

ERNESTO SÁBATO:
Duhet të zbulojmë ndjesinë
e të mrekullueshmes

Përktheu Granit Zela



(fq. 22)

NATASHA LAKO

"Kundërpërftyrimi"

DY FJALË HYRËSE MBI
POEZITË E NATASHA LAKOS

Nga Arian Leka

BIBLIOTEKË

— Veli Karahoda

(fq. 9)

*Fundi i palavdishëm
i Igor Bagrickit*

— Zija Çela

(fq. 10)

Pilisama selfie

— Agron Tufa

(fq. 14)

*Arratia e fundit
e Baltazar Ketës*

21 institucione nga vendi e bota
për konferencën ndërkademiçe,
ndëruniversitare "Letërsitë kom-
bëtare në sistemin universitar" në
Akademinë e Shkencave

(fq. 6)

**VLADIMIR PRIFTI
DHE FILMI I FUNDIT**

Nga Roland Gjoza

(fq. 19)

**TALLAVAJA VIRTUALE
DHE 'KRIJMTARIA LETËR'**

Nga Vangjush Saro

(fq. 18)

Në takimin tonë, z. Gricourt, më befasoi theksi thujtë i përkryer i gjuhës shqipe. Cila është historia juaj e njohjes dhe mësimit të shqipes? Ka ardhur nga njohja me Shqipërinë, apo jo? Përballjen e parë me gjuhën shqipe, në një vend ku flitej shqipja, si e kujtoni?


Faleminderit për komplimentin por në fund së fundit, meqë u hasa me gjuhën shqipe për herën e parë gjatë korrikut të vitit 1990 dhe mu në Kosovë (saktësisht në Fushë Kosovë duke ardhur përmes trenit prej Francës me dy shokë të tjerë), dhe meqë ky qëndrim i shkurtër dhe shumë prekës për djalin 20 vjeçar që isha e përcaktoi vullnetin tim ta mësoja gjuhën shqipe, besoj se nuk ka për t'u befasuar që ta flas. Sikur një mërgimtar që shkon në Francë, bie fjala, dhe që pas tre dekadave ende nuk flet frëngjisht... kjo për mua do të ishte më shumë e çuditshme. Ndërsa mendoj që kam edhe shumë për të mësuar, dhe nuk jam i sigurt që një jetë e tërë do të më mjaftojë, por me gjasë përkthimi letrar më jep mundësinë të përparoj.

Sa për pyetjet tuaja, do të thoja që njohja ime me gjuhën shqipe erdhi në të kundërtën nga mosnjohja me Shqipërinë, nga padijenja ime (dhe të shokëve me të cilët erdha) për këtë vend atëherë ende i mbyllur kur Blloku i Lindjes u shemb duke i hapur ashtu një pjesë e madhe e Europës kureshtjes së brezit tim. Por përballja ime me gjuhën shqipe - si një aktivist i thjeshtë në qytetin tim të atëhershëm (Angers) në Komitetin për të Drejtat e Njeriut apo edhe në Amnesty International – ndodhi me përballimin tim me shtypjen e një populli të tërë prej regjimit të Serbisë. Çka pashë dhe dëgjova gjatë këtyre pesë ditëve (policia na përzuri pasi u afruam me kufirin e Shqipërisë ku plani ynë fillestar dhe naiv ishte që të hyjmë në çfarëdo mënyre në këtë vend të mistershëm...), pra çka kuptova për padrejtësitë që ndodhin në Kosovë më mjaftoi për të marrë një vendim i cili përcaktoi shumë zgjidhje të mëtutjeshme të jetës sime.

Vitet që vijuan i kalova aq sa në Paris (për të mësuar gjuhën në INALCO) sa në Shqipëri ku jetova prej vjeshtës 1992 në një banesë të bllokut në Tiranë bashkë me një familje, dhe ashtu çdo vit nga një, tre, gjashtë a më shumë muaj sipas kursimeve të mia të nxjerra prej punëve të ndryshme që bëra në Francë (për shembull, fjalorin shqip e mësova vitin e parë duke punuar natën në një stacion benzine të periferisë së Parisit). Kariera ime e vertetë filloi në pranverë 1997 kur erdha si përkthyes në Komitetin ndërkombëtar të Kryqit të Kuq, organizatë me të cilën mbeta deri në vitin 2002 (dhe disa muaj shtesë më 2004).

Jeta juaj është ndërmjet disa vendeve me kultura nga më të ndryshmet. Nga njëri cep i botës, Afrika, në tjetrin, praktikisht keni përqafuar të katër pikat e horizontit. Prej pikëpamjes së dikujt që si përkthyes, ndërton ura për komunikimin mes kulturave, si mund ta rrëfeni përjetimin e një jete kaq intensive?

Mbas së pari, mendoj që jam larg të kem përqafuar kaq shumë pika të horizontit, por besoj që këto i kam parë mjaft për të kuptuar që në fund të rrugës s'ka më mirë se shtëpia e vet apo vendi i vet, dhe besoj që ky mësim vlen për çdo mërgimtar shqiptar. Çështja ime qëndroi se për një kohë shumë të gjatë nuk e pata të qartë ku (mund të) ishte shtëpia ime, por kjo është jashtë bisedës sonë dhe sot shoh më qartë paradoksalisht falë një martese të largët para 16 vjetëve...



Tash, për të kthyer pyetjes suaj do të thoja që sa më larg rrethanat profesionale dhe private më çuan (gjatë dhjetëveçarit 2010 veçanërisht), sa më mirë kuptova që nuk mund të shkëputja prej dy dekadave jete që kalova më herët në rajonin e Balkanit, dhe në veçanti nëpër treva shqiptare. Largimin e përjetova jo si një mungesë – sepse me gjithë propozimet profesionale që pata me qëllim u largova për të sfiduar veten – por e përjetova duke u bërë prapë një i paditur në vendin ku gjendesha (atëherë më 2010/11 ishte fjala për Afganistanin)... Edhe nëse nuk mungonin format e komunikimit, kryesisht përmes gjuhës angjeze, e vërteta është që komunikimi dhe marrëdhënie njerëzore tingëllonin artificiale sa për të mbuluar boshllëkun e një mundësie për një perjetim të mirëfillt të njohjes së tjetrit, dhe boshllëkun e njohjes apo te kuptimit të kulturës së njëri-tjetrit.

Pra kjo përvojë si do të tjerë që vijuan më afrian me kalimin e viteve me bindjen që koha po vinte kur më duhej të merrja pjesë në përpjekjet e ndërtimit të urave

të komunikimit. Dhe rrjedhimisht, për të vepruar me më shumë efektueshmëri e kisha vetëm gjuhën shqipe...

Walter Benjamin, nëse nuk gaboj, tek flet për kompleksitetin e gjuhës, e quan edhe si një mjet politik. Jeta juaj mes filologjisë dhe politikës, si e sheh këtë çështje?

Me sa duket, së vonshmi, përkthimi i fjalëve të Kryetarit të vendit tim në Tiranë treguan që ndërlikueshmëria e gjuhës mund të bëhet edhe pa dashje një mjet politik...

Por me gjithë mend, përvoja ime e paktë në mjediset politike – këtu le të theksojmë që punova dhjetë vjet në selinë e Partisë socialiste në Francë – më treguan përfundimisht që nuk ka drejtues ose drejtuese politike dhe qeveritare të vërtetë pa njohuri të thella letrare, historike dhe filozofike. Në këtë kuptim, vendi i gjuhës është qëndror për shembull për të nxjerrë mësimet e historisë dhe për të shtjelluar një



vizion të kuptueshëm nga të gjithë mbi të ardhmen, për të shpjeguar dhe arsyetuar veprimet dhe drejtimet, për të paraqitur jashtë qëllimet dhe përparësitë e vendit tënd, etj.

Le të marrim një shembull të kuptueshëm prej të gjithëve në Kosovë për lidhjen mes filologjisë dhe politikës. Kur para një dekade u pranua të futej në fjalorin shqip fjalën “asociacion” (pa i shkruar bile “asosiasion” siç do të duhej sipas rregullave fonetike, ndërsa që nuk pati ndonjë këmbëngulje për të zëvendësuar këtë fjalë me “shoqatën” për shembull), pra pa i dhënë paraprakisht në mënyrë të bindshme ndonjë kuptim dhe përmbajtje të qartë për të caktuar synimin dhe kufizimet e kësaj, atëherë nuk është për t'u habitur që çështja u zvarrit dhe u trashëguar për t'u zgjidhur nga ata vetë që kishin paralajmëruar prej fillimit për përmbajtjen e mangët... Kërkoj falje se më duket që këtu dola nga korniza e natyrës së intervistës, apo jo?

Ju jetoni përsëri në Kosovë që dy vjet ku tanimë jeni dhe këshilltar për çështjet europjane në Zyrën e Kryeministrit, saktësisht pranë Zëvendës Kryeministrit. Ndërkohë, i përkushtoheni jo pak përkthimit të letërsisë shqipe në gjuhën frënge. Si e ndani kohën...? Më mirë, si mund ta përshkruani një ditë tuajën?

Me të vërtetë, në krahasim me vitet e përparshme që kalova në Shqipëri si në Kosovë dhe kudoqoftë tjetër në rajon, këtë qëndrim tashmë dy vjeçarë në Prishtinë e përjetoj shumë ndryshe. Ndoshta kjo vjen nga mosha më e pjekur dhe nga përvojat që s'kanë nevojë të përsëriten... kështu që më parapëlqen sot më shumë një jetë të qetë dhe të balancuar ku dita ndahet mirë mes kohës së punës dhe asaj private, edhe nëse shpesh e para e kap të dytën meqë politika dhe punët shtetërore rrallë lejojnë dallimin. Megjithatë, synoj t'i përkushtoj përkthimin dhe shkrimin sa më shumë mbrëmjeve dhe një pjesë të fundjavëve, dhe kjo e bëj sipas dëshirës sime të momentit dhe një rradhitje që varet kryesisht nga afatet e mundshme që dalin prej premtimeve për botim.

Në një farë mënyre, ky përkushtim ka një lidhje me atë që thamë më lartë me domosdoshmëritë për urat e komunikimit... Veç se aty do të shtoja që ndiej brenda vetvetes një nevojë të veçantë për të kapur një farë vonese të grumbullar gjatë atyre viteve të mëparshme kur, për shkak të dinamikave të ndryshme lidhur me rrethanat dhe jetën të atyre koherave, nuk e dhashë vëmendjen e mjaftueshme veprimtarisë letrare dhe kulturore në



përgjithësi, siç pata bërë gjatë pjesës së parë të viteve 90 (përfshirë përkthimit të tre romaneve në një lloj ushtrimi që ia imponova vetes dhe pa synuar ndonjë botim).

Nga ana tjetër, gjej në përkthim një kënaqësi të veçantë në shumëllojshmërinë e teksteve, me të cilat merrem sipas dëshirës së çastit dhe shkallës së urgjencave për të përfunduar punën. Pra, e kuptuat që përkthimin nuk e bëj as për para as nën ndonjë trysni të padëshiruar, por për qejf dhe vetëm në bazë të vetëdëshirës, të miqësisë që mund të kem me ndonjë shkrimtar a shkrimtare apo të natyrës së përmbytjes së veprave në fjalë.

Kjo qasje ka të bëjë me lirinë e së vepruarit të cilën mendoj që më përkufizon më së shumti prej kohës së adoleshencës. Sigurisht se kjo vlen prej kohës kur vendosa ta mësoja shqipen pa asnjë plan tjetër përveç atij të kërkesës që çdo njeri ka të drejtë të përcaktojë jetën e vet si individ. Sipas meje, emancipimi i çdo njeriu dhe prej fëmijërisë do të duhej të ishte një qëllim thelbësor i çdo shoqërie të shëndoshë pa imponimin e ndonjë kornize të ngushtë dhe të pushtueshme shoqërore (si patriarkalizmi për shembull), autoritare dhe fetare.

Pasi mbaron një përkthim, cilat janë sfidat me të cilat përballeni? Sa e lehtë apo e vështirë është gjetja e një botuesi, reklamimi etj., i një shkrimtari shqiptar në Francë?

Kur mbaroj një përkthim, pason një çlodhje të shkurtër por e kënaqshme... sepse e di mirë që nuk morri fund puna meqë, pikërisht, dhe përveç rileximit që bëj vetë para një bisede shtesë për tekstin me autorin, mbeten përgatitja e një paraqitjeje të veprës dhe hulumtimi disa muajsh të një shtëpie botuese. Edhe nëse sot shumë prej këtyre i pranojnë dërgimet përmes internetit ka edhe shumë të tjera që kërkojnë ende dërgimin me postë. Pastaj ato kanë zakonisht tre muaj për të përgjigjur, ndërsa rrallë prej atyre përgjigjen, gjë që barazohet me një përgjigje negative gjithsesi.

Sa më takon mua, pasi i botova përmes tre shtëpive botuese që nga 2018 (përveç një tregim gjatë viteve 90 të mikut Bajram Sefaj) tre romane dhe një përmbledhje tekstesh teatroje (por edhe më herët një libër për Kosovën të botuar edhe shqip te Koha), kam filluar të fitoj një emër si përkthyes (edhe dy çmime me tragji-komeditë e mikut tjetër Jeton Neziraj), por as këto as cilësia e tekstit të paraqitur mjaftojnë për të depërtuar nëpër shtëpi botuese me rrezatim më të gjerë. Mjedisi i botimit letrar, në veçanti shtëpitë më të famshme, i ka veçoritë e saja tregtare të cilat e zvogëlojnë rrezikun e botimit të një autori të panjohur... Për të arritur më lehtë te sigurimi i botimit, më duket se, në vend që të lihen nismat shtëpive ose autorëve të ndryshëm, do të duhej një veprim politik më të theksuar për promovimin dhe vlerësimin e librit nga ana e Qeverive, brenda si jashtë vendit (me një përkushtim të veçantë për panairat e librave ku krijohen lidhjet mes botuesve). Me sa kuptova nga një takim të vonshëm, dhe më vjen mirë, Qeveria e Kosovës është duke rritur vëmendjen ndaj kësaj çështjeje.

Me Kadarenë, natyrshëm, mund të fillonte një marrëdhënie e qendrueshme mes letërsisë shqipe dhe kulturës franceze, por kjo nuk ndodhi. Fenomeni Kadare në Francë mbeti i veçuar, pa të dytë, paqja se pas '90 të tjerë shkrimtarë si Mira Meksi, Besnik Mustafaj e ndonjë tjetër u përkthyen dhe botuan në atë gjuhë... Gjithsesi, pse mendoni se



ndodhi kjo? Pse interesi i francezëve për Kadarenë nuk u pasua me një interes më të përgjithshëm për letërsinë shqipe në gjithë dimensionet e saj?

Pa dyshim që dukuria Kadare e ka ngritur emrin e Shqipërisë në altarin më të lartë të letërsisë botërore, dhe si rrjedojë, kërkohet një cilësi aq e lartë, dhe kjo ngjason me kërkesën e pa thënë por që nënkupton pyetjen: “Kush do ta zëvendësojë Kadarenë?” ... Mendoj që është një gabim i madh dhe që kjo ndikohet më shumë nga qëllime tregtare. Megjithatë, përveç emrave që përmendët, besoj se autoret si Fatos Kongolli për disa vjet rresht si edhe sot Ylljet Aliçka në vazhdimin e sipër depërtuan mjaft gjithashtu, ndërsa më kujtohet gjatë viteve 90 romanin e madh të Rexhep Qosjes (Vdekja më vjen prej syve të tillë), por ka edhe shumë të tjerë (dhe mes atyre më vjen mirë që më 2018 i dhashë mikut Eqrem Bashës një mundësi për një botim të dytë të një veprë të tij pas njëzet vjetëve).

Por ndoshta një element shpjegon kushtet për një interes më të përgjithshëm. Kur lexuesi (i cili bile rrallësohet nëpër botë) lexon autorin e ndonjë vendi, shpesh e bën sepse ka një kureshtje të veçantë për këtë vend për hir të ndonjë lidhjeje a përvoje vetore. Pra, ai ose ajo dëshiron të lexojë një përmbajtje që shpjegon diçka prej së kaluarës dhe më shumë për kohën bashkohore. Ndonjë tregim me përmbajtjen universale që do të shpëputej prej kontekstit vendor për shembull do të ishte pa interes për lexuesin mesatar, edhe nëse kjo letërsi mund të cilësohet me përmasë botërore.

Gjithsesi, mbetem optimist që me rritjen e vizitave turistike dhe të shkëmbimeve kulturore dhe ekonomike me Shqipërinë dhe me Kosovën, interesi po rritet për rajonin shqipfolës në përgjithësi. Prandaj po rritet aty nevojën e politikave të librave nga ana e qeverive për të anticipuar dhe për të përcjellë këtë rritje vëmendjeje. Ato mund të mbështesin më shumë pas mekanizmave të ndryshme europjanë që promovojnë shumëllojshmërinë gjuhësore, bile frankofonia është gjithashtu një mekanizëm institucional tjetër që e ka këtë qëllim.

Ju ishit në Kosovë edhe para lufte, edhe gjatë saj, edhe tani, pasi ajo ka mbaruar. Nuk e di sa mundësi keni pasur në dy rastet e para të merreni, lexoni apo

studioni letërsinë e shkruar atje, por nëse po, sikur ta krahasoni me atë që shkruhet sot, çfarë ndryshimesh vini re?

Pyetje me vend dhe vështirë të përgjigjem shkurt për një arsye të thjeshtë: sikur i kam jetuar disa periudha mjaft të ndryshme gjatë të cilave leximi i letërsisë shqipe pati disa shkallë dendshmërie, prej lartë deri poshtë... Sa për studimin e letërsisë le te them troç, nuk ndihem fare si një studjues i tillë, sikur ju për shembull, dhe besoj që kjo kuptohet qartë nëpër përgjigje të mia.

Gjatë pjesës së parë të viteve 90, lexova shumë dhe sa më shumë, prej më së mirës te më e keqja, gjithmonë për hir të kureshtjes edhe të mjeshtërimit të gjuhës. Prej vitit 1997, për shkak të ngjarjeve tragjike dhe të konflikteve që përfshihën trevat shqiptare deri në 2001, nuk pata kohë për të lexuar letërsinë. Më ka dashur viti 2002 kur u vendosa privatisht në Tiranë për t'u kthyer ngadalë asaj. Mbas andej përsëri isha shumë i zënë me detyrat e ndryshme lidhur me proceset që prekën Kosovën dhe rajonin. Por për t'u kthyer te nevoja e mbushjes së vonesave që përmenda më lartë, mund të them që tek unë u rrit dukshëm leximi shqip këto dhjetë vjet e fundit. Por mos mendoni që e kisha lënë krejt leximin vitet e mëhershme, përkundrazi, e kam një dobësi të vjetër për letërsinë në frëngjisht të autorëve të Amerikës latine...

Sa për ndryshimet mes fillimit të viteve 90 me ato të sotme, mund të them vetëm që, natyrshëm, përmbajtja pasqyron kohën sa u takon tematikave. Megjithatë, vë re një vazhdimësi kur ende sot në Shqipëri shkruhet për kohën e diktaturës komuniste, ndërsa të mos harrojmë që edhe gjatë asaj kohe fshehurazi shkrimtarët patën qasje klasikave dhe letërsisë moderne prej të cilave u frymëzuan sipas talenteve të tyre. Në atë kohë të viteve 90 shumë më pak lexova letërsinë shqip të Kosovës, por sa më përket mua më duket e dobishme që të sillen publikut në frëngjisht tekste të mëdhaja që pasqyrojnë dhjetëvjeçarët e fundit të shekullit të kaluar, sepse ashtu mund të kuptohet më mirë pse Kosova s'kishte rrugë tjetër përveç pavarësimit të vet... Pra, e kuptoni këtu që njëra e nxitjeve të mia që më shtynë në përkthim është gjithashtu natyra e mesazheve politike që mund të ngarkosh në këtë urë komunikimi të sipërmendur...

Po letërsinë shqipe në përgjithësi, sot, si e shihni, në raport me vetveten dhe me atë ndërkombëtare?

Mendoj se mënyra siç e shpreha nëpër përgjigjet e mia letërsia shqipe nuk ka asnjë arsye që të ketë ndonjë kompleks në krahasim me letërsinë ndërkombëtare. Siç e lashë të kuptoja, depërtimi dhe suksesi i saj varen edhe shumë nga faktorët e tjerë jashtë cilësisë së letërsisë në fjalë. Si e tillë, shkrimtarë dhe shkrime të mëdhenj mund të mbesim përgjithmonë vetëm në një gjuhë, sikur ka edhe shkrime më pak cilësore që megjithatë gjetën një rrugë jashtë...

Me një fjalë, nuk jam aq i prekur nga raporti i letërsisë shqipe me vetveten apo me atë ndërkombëtare sa jam tejet i shqetësuar nga ulja botërore e lexuesve dhe nga rritja e përdorimit të inteligjencës artificiale e cila tash pretendon të merret me krijimtarinë letrare... Prej asaj do të duhet të ruhem dhe të kemi, si shkrimtarë si përkthyes por edhe si çdo aktor tjetër të arteve krijuese... sepse nëse vazhdohet ashtu nuk di më çfarë domethënie do të ketë në të ardhme kërkesa e emancipimit të njeriut, pra çfarë kuptim do të ketë thjeshtë ideali i lirisë...

Dhe në fund, si përherë, një pyetje jo shumë e këndshme, bezdisëse zakonisht dhe tepër e zakonshme, por e pashmangshme: Planet tuaja afatmesme dhe afatgjata në lidhje me përkthimin, cilat janë? Po punoni me diçka? Keni dërguar ndonjë përkthim për botim?

Planet janë të shumta, dhe ndoshta mund të them në radhë përparësish se : 1) këto ditë jam duke u marrë me rileximin e librit të Enver Dugollit për masakrën në burgun e Dubravës “Qark i (pa) mbyllur burgjesh” në bazë të redaktimit të botuesit, sepse shpresojmë ta botojmë pas një muaji para panairit të librave të Balkanit në Paris më dhjetor, 2) menjëherë pas atij rilexim merrem me “Një fije shprese, një fije shkrepëse” para se të takohem këtë muaj me shkrimtarin Ag Apoloni, 3) e mbaroj gjithashtu para fundit të vitit përkthimin e “Bisedë përmes hekurash” të shkëmbimeve letrash mes Ismail Kadare dhe Ukshin Hotit (sepse botuesi i njëjtë për librin e Enver Dugollit ma siguroi vitin e ardhshëm botimin e këtij libri të dytë para 25 vjetorit të zhdukjes së këtij personaliteti të madh), 4) vazhdoj përkthimin e një romani të dytë, “Justina”, të shkrimtarit dhe studjuesit Luan Rama meqë kemi edhe një botim të premtuar, 5) vazhdoj gjithashtu përkthimin e romanit “Liria ime” të Mehmet Krajës për të cilin ia nisa, me një të tretë të përkthyer por pa sukses deri tani, hulumtimin për një botues, 6) kam edhe dy romane të tjerë që do të nisem prej janarit sepse edhe për këto ka premtime për botim pra edhe afate, por këtu i mbaj ende të fshehur veprat në fjalë, por mund të them që miku im i vjetër Zija Çela është përsëri mes atyre pas botimit në frëngjisht të “Djalli komik”, 7) mu më 24 mars, si një rastësi kohore e qëlluar bukur, do të dalë vëllimin e dy veprave të Jeton Nezirajt “Handke Project” dhe “Kthimi i Karl Majit”, dhe kushedi ndoshta do të merremi vesh për tekstin “Negotiating peace” i cili sigurisht më prek gjithashtu si temë, 8) është paraparë edhe një botim në Kosovë dhe në dy gjuhë të tregimeve të shkurtra të Nerimane Kamberit, 9)... mjaft ide të tjera... dhe besoj se tash për tash mjafton.

Faleminderit shumë për rastin që më dhatë pas bisedës së këndshme që patëm para disa javësh në Tiranë, ndërsa ju uroj juve edhe vazhdimësi, mbarësi dhe sukses në krijimtarinë tuaj letrare.

FRANO KULLI DHE PROF. TEFË TOPALLI PËR BOTIMIN E RI TË VEPRËS SË MJEDËS:

E gjithë lënda poetike dhe shkrimet e tjera janë marrë nga botimet e para, më të hershmet, duke ruajtur origjinalitetin e tyre.

Zoti Frano dhe profesor Tefë, pas bashkëpunimit të hershëm për botimin e kolanës së plotë të Fishtës, tanimë po përgatisni botimin kritik të veprës së dom Ndre Mjedës. Fishta erdhi atëherë pas një mungese shumëvjeçare, ndërsa Mjeda po vjen tani, ndonëse vepra e tij ka njohur shumë e shumë botime. Prandaj, z. Frano, për ju si botues, çfarë sjell të re ky botim? Po ju, prof. Tefë, si i jeni qasur veprës së Mjedës për përgatitjen e këtij botimi?

F. Kulli: Për saktësim ne kemi përgatitë dhe sapo ka dalë nga shtypi e është në stendën e Panairit të Librit **Veprën letrare të Ndre Mjedës**. Arsyeja e përzgjedhjes së këtij botimi ka pasë dy motive. Motivi i parë është se botimi i plotë, më i fundit i veprës së plotë të Mjedës ka qenë bërë në vitin 1988, pra fiks 35 vjet më parë i përgatitur nga studiuesi i pasionuar Rinush Idrizi dhe tani, sigurisht që nuk është më në treg. Një tjetër botim, i plotë është ai i bërë në Kosovë, në vitin 1982 nga shtëpia e atëhershme botuese “Rilindja” i përgatitur nga shkrimtari dhe studiuesi, akademik Sabri Hamiti, botim i cili ka arrit të vijë asokohe në Shqipëri në një numër mjaft të kufizuar kopjesh, siç më ka pohuar vetë akademiku. Ndërsa motivi i dytë, i cili, besoj se do të shërbejë edhe si përgjigje e pjesës së dytë të pyetjes suaj është se ç’të re, sjell botimi ynë?

E reja që sjell ky botim, kisha me thënë, është “vjetërsia” e tij. Që të shpjegohej. Teksti antologjik i veprës letrare të Mjedës që ne paraqesim është më “burimori”, sipas nesh. Duke filluar me kryeveprën “Juvenilia”, ne kemi sjellë të transiliteruar tekstin e botimit të 1917-ës, i bërë në gjallje dhe me përkujdesjen e autorit. Me të njëjtën metodë kemi përzgjedhur vjershat e papërfshira në “Juvenilia”, poemat “Lissus” “Scodra” “Liria”. Vjershat për fëmijë i kemi marrë nga tekstet e përgatitura nga vetë autori për shkollat shqipe nën titullin “Këndime për shkolla të para të Shqypënisë” në vitet 1926-1927. Gjithashtu janë sjellë, për herë të parë edhe strofa që, për shkak të rrethanave censuruese të kohës nuk gjinden në asnjërin prej botimeve të mëparshme dhe ato shënohen në footnote respektive.

Pra, e gjithë lënda poetike, por edhe shkrimet e tjera janë marrë nga botimet e para, më të hershmet, duke ruajtur origjinalitetin e tyre. Aty ku është parë e nevojshme, është bërë edhe shpjegimi i fjalëve e shprehjeve me përdorim më të rrallë. Sikundërse është ruajtur forma Mjedja e mbiemrit të tij, duke marrë për shembull botimet e bëra në gjallje të autorit

T. Topalli: Ky botim vjen pasi vite më parë, në hapa jo sigurt, shtypshkronja “Gjergj Fishta” bëri të mundur botimin e disa veprave letrare të para të poetit nga Zadrima, At Gjergj Fishta, dhe me studiuesin Tonin Çobani, që do të ishte “garanti” redaktorial i tyre, pa u shkëputur

nga Opera Omnis e autorit të Lahutës së Malcis, për më se 30 vjet të jetës së tij e deri më sot. Bash në këtë kohë të vrullshme redimensionimi të personaliteteve të letërsisë shqiptare, z. Kulli më bën të njohur dhe më fton një bashkëpunim për botimin e plotë të trashëgimit letrar të poetit, publicistit, polemikut të thekshëm, autorit të 6 melodramave, don Ndre Zadeja. Ky klerik i Lumë, Martir i Kishës në Shqipëri, u pushkatua me 25 mars të vitit 1945, me 14 burra, mes të cilëve kreshnikun e Malësisë Prek Cali, se kishte strehuar bashkëvëllain e tij, shkrimtarin publicistin, poetin dhe përkthyesin don Lazër Shatojën. Kujtoj me nderim se për veprën e Zadejes, më 1994, gjithë krijimtaria e fshehur për vite me radhë, u sigurua prej nipit të tij, gazetarit të arsimit tonë, lektorit të gjuhës latine në Universitetin e Shkodrës, të ndjerit z. Lec Zadeja, i cili iu kushtua me të gjitha forcat këtij botimi në dy vëllime në Shtypshkronjën “Gjergj Fishta” të F.Kullit.

Duke mos dashur të rikthej një debat të mbyllur, por sigurisht, është e pamundur ta shmang si pyetje. Kur u përgatit kolana e plotë e Fishtës, redaktimi që u bë krijoi polemika të forta. Pa u ndalë në shembujt që nxitën diskutime, desha të di, në dritën e këtij botimi të ri, si i shihni ato ç’u thanë atëherë? Do të ndiqet e njëjta metodë redaktimi e tekstit edhe me Mjedën?

F. Kulli: Unë të falënderoj që e sjell në kujtesë tani, Andreas. Botimi i veprës së

plotë të Fishtës ka pasë nisë njëzet e sa vjet më parë, dhe që përcjellë edhe me polemikat që ti përmend. Për disa kohë ka ecë ndërmjet moskuptimeve dhe keqkuptimeve jo të vogla, por sot, pas kaq kohe, unë si botuesi ndihem i lumtur prej ecurisë së saj. Dhe falënderues i përhershëm i redaktorëve të saj, miqve të mij: Tonin Çobani, Tefë Topalli, Ndue Zef Toma (i ndjerë), Hamit Boriçi dhe Stefan Çapaliku.

Ai botim, tashmë është emblema e veprës së Poetit Kombëtar të shqiptarëve. Është pasuar edhe me studime serioze vepra e tij, është botuar, gjithashtu edhe një fjalor i veprës, i cili besoj se ka shërbyer e shërben tejkalimin e shkëputjes gjysëmshkulllore të autorit me lexuesin e vet. Edhe këtu, falënderimet nuk rreshtin për profesor Tefën.

T. Topalli: Për modestinë që e karakterizon, Presidenti i Entit Botues “Fishta”, flet kaq shkurt, por ne që kemi qenë të njohur me nismat dhe planet e tij të punës me autorët të traditës në ato vite, e dimë se nuk ka qenë e lehtë puna me krijues dhe figura emblemë të kulturës sonë kombëtare; dhe kjo për disa arsye: së pari, trashëgimi letrar dhe gjuhësor, tashmë ishte në dorë të Prokurës Françeskane, Shkodër, një brez i ri frëterish pasionantë dhe të bindur se korpusi i tij ishte “pronë” vetëm e Kuvendeve të të “Varfërve të Asisit”, larg mendimit se vepra e tij ishte “pronë kombëtare”. Kjo e vuri Entin Botues dhe redaksinë e ngritur para një

përgjegjësie “ligjore”, deri edhe me akuza se vargu e proza e Fishtës po prekej në gjuhë, idioma dhe frezema, po tjetërsohej, ndërkohë që vetë françeskanët kishin nisur ribotimin anastatik të autorit, pa asnjë ndërhyrje. Nuk vonoi dhe të thirrurit në Redaksi, dolën para Gjykatës së Lezhës dhe z. Kulli u penalizua! E dyta, kishte zëra se u bënë konsulta që vepra e poetit të mund të botohej në standard, ndoshta një dëshirë më tepër se mundësi....! E treta, nuk ishte e lehtë të mbaje një qëndrim unik në gjithë ato trajta foljore, leksema të panjohura prej gjysmë shekulli largimi të veprës prej lexuesit, forma të lirikës poetike, ruajtjes së metrit, shpjegimit të frazeologjizmave në footnota; shkurt përballja me gjuhën e këtij autori që punoi mbi vargje e shprehje më tepër se 30 vjet! Dua të vë në dukje se vetëm në veprat 4, 7 dhe 8, mbi të cilat më takoi të punoja, u deshën gjithë fjalorët e gjuhës sonë: nga ai Bashkimit, i vitit 1954 dhe të tjerë deri në vitin 1980, pa lënë jashtë “Shpalimet” e Tahir Kolginit, Fjalorin e Benedikt Demës (ku kam punuar në dorëshkrim për botimin e tij), e të tjerë. Kjo vështirësi vinte nga ndalimi i veprës, për një kohë aq të gjatë; përndryshe çdo autor përdor leksikun e kohës së tij. Sa me kënaqësi ndiej se jo vetëm vargje, por strofa e poezi të plota dëgjojnë nga korçarë, gjirokastiritë, vlonjatë prej shkrimtarisë së Mjedës, Migjenit (bashkëkohës të Fishtës), që kanë qenë të pranishëm në librat tanë shkollorë dhe antologjitë letrare. Edhe me autorë të tjerë ka lidhje ky Ent Botues, si me trashëgimin letrar të don Ndoc Nikajt, Simon Rrotës, Vinçens Prendushit etj.

Me tekstin e Mjedës vjen një punë redaktuese më e lehtë, për faktin se vepra e tij është më e kapshme për lexuesin e sotëm dhe me përmasa të tjera nga ajo e Fishtës. Ajo ka pasur shumë ribotime që nga studiuesi e profesori Mark Ndoja, Mark Gurakuqi, Rinush Idrizi, si dhe rishtypje në Kosovë. Nuk duhet harruar gjithsesi që Mjeda, ashtu si më vonë Martin Camaj, kanë pasur në krijimtari edhe atributin e gjuhëtarit: janë autorë gramatikash e fjalorësh, studimesh gjuhësore dhe kanë hulumtime e kërkime akademike, sidomos për shkrimtarët tanë të vjetër, që nga Buzuku (doktoratë e Camajt, në Romë) deri tek P.Bogdani që modeloi e solli struktura origjinale të shqipes, nga Sibilat e famshme deri në prozën e stilin e tij.

Pas një enciklopedie mjediane si ajo e Mentor Qukut, mendoni se ka mbetur akoma



...E gjithë lënda poetike, por edhe shkrimet e tjera janë marrë nga botimet e para, më të hershmet, duke ruajtur origjinalitetin e tyre dhe, aty ku është parë e nevojshme, është bërë edhe shpjegimi i fjalëve e shprehjeve me përdorim më të rrallë. Janë sjellë, për herë të parë edhe strofa, që për shkak të rrethanave censuruese të kohës, nuk gjinden në asnjërin prej botimeve të mëparshme dhe ato shënohen në footnote përkatëse. Sikundërse është ruajtur forma Mjedja e mbiemrit të tij, duke marrë për shembull botimet e bëra në gjallje të autorit...

hapësirë ku mund të thuhet gjëra të reja për Kryepoetin, emërtim imi ky?

F. Kulli: Kjo pyetje më bën të përsëris më përndritje vlerësimin superlativ që unë kam për atë punë të jashtëzakonëshme mbi 40 vjeçare hulumtuese e studimeve të mikut tim të ndjerë Mentor Quku, përreth Poetit tonë, lirikut të papërsëritshëm, eruditit të pakundshoq, Mjedës së madh. Por, siç ju theksova më sipër, sipërmarrja jonë është krejt tjetër: botimi i veprës së Mjedës, çka nuk bie ndesh me Qukun, por si të thuash, e vijon punën e tij.

T. Topalli: E kam ndjekur punën e rrallë e të papërsëritshme të M. Qukut, qysh kur ai ishte arsimtar në *Barbullush të Shkodrës, si mësues e biolog. Ndoshta selia e heshtur dhe e shembur e Qelës së Kuklit, ku kishte krijuar e shërbyer Mjeda poet e gjuhëtar*, jo larg shkollës së tij, duhet ta ketë frymëzuar Qukun për atë vepër atdhetare e artistike, shkencore dhe studimore të klasikut dhe lirikut Mjeda. Në mbyllje të serisë së madhe monografike të tij, ai thoshte se kishte arritur vetëm gjysmën e punës për personalitetin Mjeda; gjysmën tjetër do ta përbënte paraqitja dhe komentit i veprës letrare e shkencore të autorit, kryesisht vargut të tij magjik. Fshat më fshat e shkollë më shkollë trokiste ky pasionant i dijes dhe i veprimtarisë atdhetare të fenomenit Mjeda, bisedat e tij me njerëz të thjeshtë që kur hapi shkollat e para në Zadrinë (Dajç), kur kishte projektuar qela e kisha (Sapë), kur ndihmonte bujqit në përdorimin e veglave bujqësore, sjellë prej tij nga Austria, kur hartonte Fjalorin botanik të zonës së Tejdritit e kur mbledhte fjalë plaka shqipe etj...

Duhet theksuar se rishtypjet, përveç risive që sjellin botuesit, plotësojnë edhe mungesat fizike të librit: nuk gjejmë sot më botimin e Mjedës në dy vëllime, të vitit 1988, as për nevojat e shkollës dhe as studimit; kopjet e pakta në biblioteka nuk i plotësojnë nevojat e njohjes dhe angazhimit akademik. Mjafton të përmendim këtu se në ditët tona nuk gjenden më vepra të poetit Agim Shehu, një prej poetëve tanë më të mirë të viteve 1960-1990, as krijimtarinë poetike (sidomos) të mësuesit të tij, prof. Vehbi Balës, studiues dhe monografist, *që ka shkruar 12 vëllime me vjersha (1946 – 1990)*, nuk e gjen askund, bile as në Biblioteka qytetesh të mëdha (këtë vit ai ka 100-vjetorin e lindjes). Kjo na krijon një vështirësi sa herë që duam t'i vjelim modelet e veprave të tyre për mikroteza e teza studimore në shkollat e larta.....!

Pashë se emri i autorit është lënë Mjedja, si në gjallje të tij. Pse kjo zgjedhje, kur përherë më vonë atij i jemi referuar si Mjeda?

F. Kulli: Besoj u sqarua në fundin e pyetjes së parë.

T. Topalli: *Është e vetmja "grindje grafike e simbolike" që kemi pasur me botuesin Kulli, kur ai kishte në dorë Juveniljen (një riprodhim anastatik), dalë në Vjenë, në vitin 1917, me emrin MJEDIA. Kalimi te trajtat historike të emrave, në një kohë që sot quhen edhe të kaluara e nuk përdoren më, sikurse mund të thuhet për trajtën "Mjedja apo edhe Mjedia", na u duk si snobizëm, por Enti Botues i mbahej mendimit të mirë se nuk duhet humbur edhe kjo trajtë ekzotike emnake. Ndërkohë, lexuesi duhet të mësojë se gjuhëtari ynë i njohur Kolë Ashta, që ka hartuar Fjalorin e veprës poetike të autorit të poemave "Liria" dhe "Andrra e jetës" etj., në vitin 1955 e lënë në dorëshkrim, ka përdorur trajtën "Mjeda"; po kështu, edhe Universiteti i Shkodrës, që ka publikuar këto ditë këtë vepër në një botim estetik të mirëpritur, nuk e ka lëvizur trajtën e prof. Ashtës. Në ditët tona na duket e parëndësishme kjo shumësi*



Portret nga Pashk Përvathi

trajtash, por pas shekujsh histori letërsie, mund të çojë në aludimin se ka pasur jo një, po dy Mjeda.....

Nëpërmjet këtij botimi, risillet në vëmendje Mjeda. Pas rindërtimit të shtëpisë së tij në Kukël nga dom Nikë Ukgjini dhe botimit për disa numra të revistës Mjedologji, është e drejtë se ngjan sikur është lënë pak mënjane një personalitet i tillë. Pas botimit të librit, keni një plan, ju Frano si botues dhe ju prof. Tefë, si pedagog me përvojë pune bukur të gjatë në Universitete: nga Shkodra (ndërkohë, lektor i jashtëm në Korçë, Tiranë, Beograd e Pordgoricë - për 11 vjet me radhë në kryeqytetin e Malit të Zi), për promovimin e veprës dhe krijimin e të hapësirave ku vepra dhe poeti të diskutohen, mendimet rreth tyre të rrahen?

F. Kulli: Sigurisht që kjo që ju thoni do të jetë vijim i punës për botimin e veprës. Ja, ne filluam që tani së bashku me këtë intervistë, për të cilën unë ju falënderoj. Ndërkohë janë programuar edhe biseda e madje edhe emisione dedikuara Mjedën nga gazetarë seriozë të kulturës në mediat televizive. Puna vijon...

T. Topalli: Shumë mirë që e përmendni DPH, historianin don Nikë Ukgjini, priftin kosovar, që shërben edhe famullinë e Kuklit, ndoshta me vullnetin e tij meshtarak, në tërheqje të figurës së Poetit, për të cilin ka gjetur relike të jetës së klerikut, vendin e punës, ka rindërtuar qelën e tij (jo shtëpinë), bën veprimtari përkujtuese për përvjetorë të lindjes së Mjedës, me pjesëmarrje studiuesish dhe boton revistën "Mjedologji", për ligjëratat e mbajtura, ku vijnë profesorë, akademikë, edhe nga Mali i Zi, Kosova e Tirana e Universitete të tjera në Shqipëri. Botohen në dy idiomat tona kryesore: në standard dhe në variantin e Veriut. Kuptohet, të gjitha këto lidhen me forcën financiare të don Nikës, i cili gëzon jo pak mbështetje mecenative të miqve të tij brenda e jashtë vendit. Për segmentin "lënie mënjane", duhet ditur se vitet e shekujt vijnë dhe i selektojnë veprat letrare dhe shkrimtarët; nuk mbeten të gjithë me gjithçka nga trashëgimi letrar dhe as për

antologji: për Mjedën themi se mjeshtëria e 11-rrokëshit në sonete dhe vargjet safike, do të jenë të paarritshme, sidomos kur rryma e korrente letrare qarkullojnë dhe përqafohen shpejt në artin botëror: Ja, b.f. për gjuhën e Poetit, vazhdon të jetë gjithëpërfshirës studimi i thelluar i prof. Jup Kastratit, për leksikun Fjalori poetik që shënuam më sipër, hartuar prej prof. Ashtës, analizat shkencore të artit të tij janë rilevuar nga studiues të njohur kosovarë; tani mund të gjenden hapësira për stilin dhe figuracionin, si dhe për risitë e sintaksës së vargjeve poetike mjediane.....

Jemi në ditët e Panairit të Librit, prandaj s'e shmang dot një pyetje për librin në përgjithësi. Zoti Frano, ju i keni sjellë letërsisë shqipe një numër të madh veprash dhe autorësh, mes të cilëve jam edhe unë, me novelën time të parë "Kur vdekja të na bashkojë", pra jeni përherë në komunikim me autorë e lexues, me të gjithë aktorët e botës shqipe së letrave. Ju, prof. Tefë keni formuar breza të tërë mësuesish, studiuesish dhe kritikësh, profesorë e studentë të shumë dalë nga auditorë ku ju keni qenë dhe jeni lektor... Si e mendoni dhe si e shikoni raportin e librit, letërsisë, gjuhës dhe produktit artistik, shkencor e kulturor sot në përballje me shoqërinë?

F. Kulli: Punëtorët e librit, po i quaj botuesit e të gjithë ata që merren me librin, në rrethanat e krijuara kanë zgjedhë qasje të reja në përshtatje me këto rrethana. Ashtu siç kanë bërë e bëjnë gjithëherë prej tridhjetë e sa vjetësh. Por një gjë thelbësore, që nuk ka ndryshuar është dashuria e pasioni për librin e për punën që bëjnë, ndoshta më i veçanti në të gjitha zëjet e këtushme. Nuk ka ndryshuar, gjithashtu shpërfillja e hatashme e enteve shtetnore të kulturës për librin, e pakrahasueshme për nga doza e saj me asnjërin prej vendeve përreth nesh.

T. Topalli: Një pyetje e vështirë, e lënë për në fund, çka kriteret pedagogjike kërkojnë që procesi sokratik i bisedës të ndërtohej me të kundërtën; megjithatë, jeta dhe puna, veprimtaria mësimore na dikton që shumë çështje e probleme të shihen pak më ndryshe, ose krejtësisht ndryshe nga dijet

teorike që na kanë ushqyer profesorët tanë – sipas shkollave të formimit të tyre. Unë kam kryer shkollën e mesme pedagogjike, në Shkodër, ku vetëm njëri prej pedagogëve tanë (kështu quhen në shumë politika arsimore europiane – në Gjermani – Schulmann) nuk kishte mbaruar Universitetet jashtë vendit, dy në BS, të tjerët vinin nga shkolla të larta përendimore: Klagenfurt (Austri), Gjermani, Itali e shumta, në Francë, Jugosllavi. Kur u hap Universiteti në qytetin e Shkodrës, 1957, profesorati u shpërngul nga shkolla pedagogjike në Institutin e lartë Pedagogjik. Fjala "ndryshim" që zë vend në pyetjen tuaj – drejtuar z. Fran, është e kuptueshme për cilësinë tipografike, shtypshkrimi, gjithnjë e më modern po bëhet, po dalin libra me paraqitje estetike, me lidhje të qëndrueshme, kopertina tërheqëse dhe karaktere të bukura. Por tingëllima e digjitalizimit dhe e IA (Inteligencës artificiale) po jehon krejt pranë punës sonë pedagogjike mësimore: studenti mendon se celulari, google, kompjuteri janë fillimi dhe fundi i enciklopedik i një fushe studimi, gjithçka sillet rreth atij mjeti magjik komunikues siç është celulari, si për njohuritë, ashtu edhe për një punë minimale shkencore, brenda një literature të limituar, sa premtojnë shkarkimet teknike të një veprë letrare apo shkencore. Sa për fjalën "shpërfillje", ndoshta, pas jetës dhe sigurisë së saj, mospërfillja ndaj librit po ndikon e do të ndikojë egërsisht në shoqërinë tonë...Shenjat janë të dukshme, prandaj dhe kambanat e alarmit duhet të bien pa pandërprerë.....

Ka një mbyllje interesante pyetja juaj, që aludon në njëfarë mënyre edhe me gjuhën letrare-standardin tonë dhe dialektet e të folurat e tyre, në raport me krijimin artistik. Koncepti apo termi "standard", për shumë kohë i përdorur si "gjuhë letrare kombëtare", "gjuhë e njësuar", "gjuhë zyrtare", "gjuhë e përbashkët", është ai variant që në shumë vende apo shkolla sociolinguistike quhet edhe "gjuhë e shkresës", një variant që duhet ta njohin të gjithë dhe nuk e flet askush, në jetën e përditshme apo në situata informale. Jetojnë ende breza kur, pas Kongresit të Drejtshkrimit, dramamturgu Kolë Jakova, në gjuhën e romanit "Fshati midis ujnavë", kalonte në regjistrin tjetër "Fshati midis ujërave" dhe personazhi i zgjuar komik, Prengë Sherri, duhej të fliste ashtu si edhe vetë Jakova duhej të mendonte si ta shkruante në normën e re! Kështu edhe për autorë që lëvronin vjershërinë: V. Bala, S. Gera, e shumë të tjerë. Nga jeta skenike, kujtohet edhe sot humori që lindte kur aktorët e talentuar të estradës së Shkodrës përpiqeshin të aktronin me një logos jashtë natyrës së tyre, duke krijuar dy linja: njëra e përmbytjes, tjetra e të folurit! Gjithë letërsia jonë e traditës është gjeneruar në dialekt, për disa shekuj, edhe gjatë Rilindjes, gjatë Pavarësisë, deri edhe në vitet 1970. Nuk mund të thuhet se është një letërsi e shkruar keq e nuk gjykohet nga kjo formë. Pa folur këtu për vlerat që sjellin prurjet dialektore e të folurat, çfarë po ngjet me letërsinë, cilët autorë mund të krijojnë bukur në dialekt, pa pasur një normë shkrimi! Shkrimtaria e M. Camajt: poet, prozator dhe gjuhëtar është rast shumë i veçantë, që duhet studiuar dhe, për idhtarët e gëgnishtes, mbase mund të merret si model formal, por mos po bëhet një zhurmë e madhe se u rrezikuaka standardi?!? Se dy kosovarë dhe dy këndej Morinës provojnë e krijojnë në variantin e Veriut! Çfarë paska dëmtuar gazeta e vetme letrare "ExLibris", sa herë që në të rrallë boton faqe letrare nga poetesha e re D. Dabishevci a ndonjë krijues tjetër! Po, për të dëmtuar dhe krijuar një shije të padashur gjuhësore, janë rastet kur edhe gazetarë e folës të TV shtetëror (edhe privat), shqiptojnë pyetje të tipit: Kush qytet të ka lënë mbresa?!? Kush janë përparësitë tuaja ???

Temat kryesore që u trajtuan në bazë të platformës së konferencës ishin: Statusi objektivisht i privilegjuar i letërsisë kombëtare / letërsive kombëtare në vend e në botë në sistemin universitar: sa i përgjigjen këtij statusi programet universitare në pikëpamjen e vendit dhe vlerësimit; E ardhmja e letërsive kombëtare në kushtet e globalizimit dhe përgjegjësia institucionale e rrjetit kombëtar të universiteteve: gjendja e sotme e letërsisë shqipe në kurrikulat universitare: kufizime dhe shpërpjesëtime; Historishkrimi i letërsisë si çështje shkencore dhe didaktike: periudha dhe autorë pa një vend të stabilizuar në programe; Probleme të kanonit letrar.

Në kontriburin e tij të shkëlqyer Matteo Mandalà (Universitè di Palermo): paraqiti para kolegëve: *Letërsia arbëreshe në dhe jashtë programeve universitare*; e Blerina Suta (Universitè di Napoli *L'Orientale*) solli: *Modele në përfaqësim letërsitë nacionale në disa universitete në Itali*.

Studiuesi Salajdin Salihu (Universiteti i Tetovës) solli: *Letërsia shqipe në programet universitare në Maqedoninë e Veriut*; ndërsa David Hosaflook e Teuta Toska (Instituti i Studimeve Shqiptare dhe Protestante, Universiteti i Elbasanit *Aleksandër Xhuvani*), sollën: *Për vendin e munguar të një letërsie fillesash: Qiriazët dhe shkrimet që na kanë lënë*;

Në studimin e *Letërsive të tjera kombëtare në disa sisteme universitare* Lumnije Jusufi (*Humboldt Universität*, Berlin): *Letërsia shqiptare si letërsi monologuale shqipe*; përkthyesi dhe profesori Edvin Cami nga Universiteti i Tiranës solli: *Problematika të letërsisë kombëtare në sistemin arsimor - një përvojë gjermane*;

Ndërsa Belfjore Zifla-Qosja e Anila Mullahi (Universiteti i Tiranës paraqitën parime të organizimit studimor të letërsisë botërore në sistemin arsimor të vendit (historiografia, letërsitë nacionale, rrymat dhe drejtimet, kanoni); ndërkohë që, Florinda Boriçi dhe Sidita Hoxhiq (Universiteti i Durrësit *Aleksandër Moisiu*, Universiteti i Tiranës): *Letërsia amerikane në kurrikulën e Universitetit të Tiranës dhe të Durrësit*;

Ledio Hala (Universiteti i Regensburgut, *Ludwig Maximilian Universität*, München): *Vendi i letërsisë gjermane në programet universitare të gjermanistikës në Gjermani - rasti i universitetit të Mynihut*.

Në seancat mbi letërsinë dhe identitetin Lili Sula (Universiteti i Tiranës) paraqiti: *Shenjat identitare të letërsisë shqipe dhe shenjat e tyre në programet e Universitetit të Tiranës*; ndërsa Eris Rusi (Universiteti i Korçës *Fan S. Noli*) parashtrroi: *Globalizmi letrar: ndërveprimi i letërsisë së huaj dhe letërsisë shqipe në kontekstin e kulturës dhe identitetit kombëtar*; Fikret Ramadani nga Universiteti i Prizrenit *Ukshin Hoti*) u paraqit me: *Statusi i letërsisë shqipe në universitetet e Kosovës*;

Në seancën që iu kushtua historiografisë dhe çështjeve të kanonit letrar, studiuesi Shaban Sinani (Akademia e Shkencave) solli kontributin e tij: *Të zgjedhësh a të përzgjedhësh: rikthim tek një projekt akademik për një histori letërsie shkencore e të dobishme për të vijuar me*:

Arben Prendi (Universiteti i Shkodrës *Luigj Gurakuqi*): *Disa pikëpyetje mbi letërsinë e gjysmës së dytë të shek. XX dhe fillimit të shek. XXI, në kuadrin e një historie të letërsisë shqipe*; Eldon Gjika (Universiteti i Tiranës): *Historia e historisë së letërsisë shqipe si provokim*; Evalda Paci (Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë): *Reflektime veprash e autorësh në një histori letërsie të shkruar shqipe (sprovë e sfidë receptimi)*; Abdulla Rexhepi (Universiteti i Prishtinës *Hasan Prishtina*) me kumtesën e veçantë: *Letërsia orientale e shkruar nga shqiptarët: përkthimi dhe studimi*; Bardhyl Demiraj (*Ludëig Maximilian Universität*, München): *Përmes filologjisë së tekstit tek letërsia e vjetër: disa përvoja në "Ludëig Maximilian Universität" të München-it*; Bruna Prifti (Akademia e Shkencave): *Dispensat si paratekste të historisë së letërsisë shqipe*:

Njëzet e një institucione nga më të rëndësishmet nga vendi e bota, përmes përfaqësimit prej profesorëve e studiuesve më në zë, u mbledhën më 14 nëntor 2023 në konferencën ndërkademiqe, ndëruniversitare, në sallën Aleks Buda të Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë në pesë seancat maratonë që ndoqën njëra-tjetrën për të problematizuar çështje fundamentale që lidhen me letërsitë kombëtare dhe çështje të kanonit letrar në sisteme universitare.

21 institucione nga vendi e bota për konferencën ndërkademiqe, ndëruniversitare “Letërsitë kombëtare në sistemin universitar” në Akademinë e Shkencave

rasti i autorëve të përjashtuar; Virion Graçi (Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë): *Dukuri dhe probleme të trashëguara të disidencës në letërsinë shqipe deri në bashkëkohësi*; Viola Isufaj (Universiteti i Tiranës): *Raporti midis zhanreve në letërsinë shqipe bashkëkohore: epërsia e romanit*; Meliza Krasniqi (Instituti Albanologjik i Prishtinës): *Periudha letrare apo periudha historike*; Merita Gjokutaj (Universiteti i Gjirokastrës *Eqrem Çabej*): *Një vështrim mbi tekste të historishkrimit të letërsisë shqipe dhe reflektimi i pikëvështrimeve të tyre në programet universitare*.

Së fundmi mbi : *Letërsia shqipe në kurrikula të tjera universitare* kumtuan Bajram Kosumi (Universiteti i Gjilanit *Kadri Zeka*): *Statusi i letërsisë nga burgu në programet universitare - një vështrim krahasimtar*; Valbona Gashi-Berisha (Universiteti i Prishtinës *Hasan Prishtina*): *Letërsia sot dhe rëndësia e saj në kurrikulat universitare*; Jonela Spaho (Universiteti i Korçës *Fan S. Noli*): *Letërsia moderne shqipe (1912-1939) në programin universitar*; ndërsa Ermir Xhindi (Universiteti i Vlorës *Ismail Qemali*) paraqitej me: *Letërsia shqipe në një perspektivë të studimeve kulturore në programet universitare - interpretimi i domosdoshëm i "pozitivizmit" tradicional*; Nerimane Kamberi (Universiteti i Prishtinës *Hasan Prishtina*): *"Letërsia në rrezik" – letërsia kombëtare dhe letërsia e huaj në frontin e përbashkët*; Ilir Shyta (Universiteti i Korçës *Fan S. Noli*): *Proza dhe poezia shqipe bashkëkohore në kurrikulën universitare*; e Drita Isufaj (Universiteti i Durrësit *Aleksandër Moisiu*): *Letërsia (shqipe) në programet e Universitetit "Aleksandër Moisiu"*.

Në mënyrë të qartë profesor Osman Gashi nga Universiteti i Prishtinës sqaron se çështja, e cila do të trajtohet në këtë punim, është Letërsia, në kuptimin më të gjerë të fjalës, me tërë përbërësit e saj, me ligjësitë e zhvillimit të saj, me historinë e saj e me parimet krijuese, mirëpo nga një këndvështrim që i kapërcen, deri diku, kornizat e interpretimit të saj të ngushtë, domethënë është e parë në raport me edukimin përgjithësisht e mësimdhënien në veçanti. Çështjet e tilla si kjo, që trajtojnë dukuri binare siç janë: letërsia – shoqëria, letërsia – religjioni, letërsia – politika, letërsia – historia, dhe më në fund, letërsia – mësimdhënia, bartin me vete rrezikun e shmangies nga fokusi i drejtpërdrejtë në letërsinë, si të tillë, e të kalimit tek trajtimi primar i problemeve pedagogjike, kulturore, psikologjike, sociologjike, mitologjike, historike, etj.

Siç parashtrroi studiuesi Dr. Ardian Muhaj nga Instituti i Historisë, Akademia e Studimeve Albanologjike në abstraktin e përcjellë, të cilin e shtjelloi në kumtesën e mbajtur:

Shkencat e identitetit si arkeologjia, gjuhësia, historia, letërsianë traditën e shkencës shqiptare kanë qenë të strukturuara nën konceptin dhe disiplinën shkencore të albanologjisë. Viteve tëfundit vërehet trysnia e globalizimit të dijes në shkencat e identitetit, në rastin konkret mbi albanologjinë. Njohja dhe kuptimi i veçorive të shkencave të identitetit shqiptar si dhe

ndërgjegjësimi i duhur mbi përkufizimin dhe kufizimet e këtyre shkencave janë thelbësorë për të shmangur keqkuptimet dhe problematikat që e kanë dëmtuar dhe vazhdojnë ta dëmtojnë albanologjinë në kushtet e globalizimit.

Studiuesi Muhaj u ndal në veçoritë e shkencave identitare shqiptare, të cilat kanë aspektet e tyre të veçanta që duhen njohur, pranuar dhe zbatuar në hartimin e politikave mbi dijen. Ligjet e hartuara në vitet e fundit nuk e pasqyrojnë sa duhet këtë veçanti të shkencave identitare.

Më pas profesori Ardian Muaj shtjelloi disa kufizime: Fakti që objekti i këtyre shkencave është i kufizuar në caqet dhe aspektet e shtrirjes së kulturës shqiptare e bën të domosdoshme që edhepolitikatat përkatëse të kenë këtë përmasë. Kërkesat e parashtruarandaj kërkuesve shkencorë dhe pedagogëve të këtyre disiplinavegjithnjë e marrin parasysh këtë përmasë shqiptare të këtyre shkencave.

Së fundmi, studiuesi Muhaj preku edhe disa keqkuptime. Sipas tij, keqkuptimet janë rrjedhojë e mosmarrjes parasysh nga ana e politikëbërësve e veçorive dhe kufizimeve që shkencat identitare shqiptare kanë. Kjo ka sjellë një numër problematikash që në vend që të trajtohen si duhet, lihen pas dore, shtohen dhe si përfundim dëmtojnë identitetin shqiptar përmes dëmtimit të shkencave të identitetit shqiptar.

Kumtesa e profesorit Aleksand Rusakov tregon për traditën e mësimdhënies së

letërsisë shqipe në Universitetin e Shën Peterburgut. Dega e gjuhës shqipe në këtë Universitet ishte themeluar më 1957 nga Agnia Desnitskaja. Që nga fillimi kursi i letërsisë shqipe ka qenë një pjesë e rëndësishme në kurrikulën e kësaj dege. Në vitet të ndryshme ky kurs ishte dhënë nga Agnia Desnitskaja, Gertruda Eintrej, Alekdsandr Rusakov dhe (tani) Maria Morozova. Kursi vazhdon katër semestra dhe përfshin letërsinë e vjetër (letërsia katolike, letërsia e aljamiados shqiptare, letërsia arbreshre) dhe atë moderne. Letërsia shqipe kuptohet si letërsia e popullit shqiptar dhe shqyrtohet në kontekst të zhvillimit të letërsisë botërore, nga njera anë, dhe të historisë dhe kulturës shqiptare, nga ana tjetër. Një pjesë kryesore e mesimdhënies së letërsisë shqipe është leximi në klasë i teksteve të autorëve shqiptare. Një fakt tejet interesant i dhënë prej tij është se në Universitetin e Shen Peterburgut Ernest Koliqi me novelën *Gjaku* ka qenë pjesë e programit universitar në ish BRSS, madje dhe në kohën kur ishte i ndaluar në Shqipëri.

Një nga qasjet shumë të veçanta ishte ajo e profesorit Tomorr Plangarica e cila lidhej me studimin e pranisë/papranisë së koncepteve dhe qasjeve teorike të shkencave të ligjërimit në programet universitare të studimit të diskursit letrar në gjuhën shqipe.

Ai e sheh objektin e kësaj konference si një profil të rëndësishëm që ka të bëjë me *natyrën* e dijeve në programet universitare e, ndërsa metodologjitë e studimeve letrare evoluojnë me ritme gjithnjë e më të përshkallëzuara, sipas qasjes së profesor Plangaricës, duhet të përllogarisim në këtë korpus dijeje edhe prurjet e rëndësishme që vijnë ndërkohë nga një tjetër hapësirë studimi: siç është ajo e *shkencave të ligjërimit*.

Është një hapësirë studimi me disiplinë dhe kahe studimesh ku *vepra letrare, teksti a diskursi letrar* është vendosur në qendër të shqyrtimeve, ku janë përpunuar metoda e koncepte po ashtu tejet funksionale që shqyrtojnë në mënyrë të suksesshme veçantitë e diskursit letrar, duke i dhënë këtyre dijeve tashmë statusin e dijeve të dorës së parë në shqyrtimin e shumë prej treguesve të diskursit letrar, larg së qeni thjesht dije ndihmëse a plotësuese në studimet letrare, duke e kapërcyer paragjykimin a përvojën tradicionale që prej gjuhësisë mund të marrim si të vlershme thjesht statistika përdorimi të mjeteve gjuhësore, që shërbejnë më tej për analizat gramatikore a leksikore-vijoi profesor Plangarica.

Problemin e pranisë/papranisë së këtyre koncepteve e shohim përtej përdorimit të tyre nga studiues të caktuar të mirinformuar për ato fusha, që gjenden, padyshim mes nesh, në Shqipëri, Kosovë, Maqedoninë e Veriut dhe te akademikët e studiuesit arbëreshë në Itali. Por praninë/papraninë e gjykojmë në lidhje me një *dije të institucionalizuar* në aspektin kognitiv e social, që parakupton përvijim të plotë e të ngulitur të disiplinave përkatëse në shkencat e ligjërimit me tërë “infrastrukturën” që kërkon ai institucionalizim. Studiuesi i shkencave të ligjërimit, profesor Plangarica mendon që ky status duhet përvijuar.

Kjo hapësirë e re dijeje në shkencat e ligjërimit, në funksion të shqyrtimit të letërsisë u mundëson studiuesve të letërsisë e diskursit letrar të kalojnë më natyrshëm nga dhënia e një panorame të trashëgimisë sonë letrare, me vepra e autorë, në shqyrtime më të drejtpërdrejta për dukuritë letrare, proceset krijuese, marrëdhëniet me kohën dhe hapësirën sociale e institucionale, fushën letrare dhe institucionin letrar, vlerën që përfaqëson letërsia si një ndër monumentet më të rëndësishme të aftësisë krijuese në gjuhën shqipe.

Rusana Hristova-Bejleri: Universiteti i Sofjes “St. Kliment Ohridski” në: *Letërsia në tekstet e shqipes për të huaj*, në abstraktin e saj parashtron disa tekste të njohura të shqipes për të huaj nga pikëpamja e veprave të përfshira letrare dhe funksionit të tyre - gjuhësor, identitar-kulturor, kombëtar, ideologjik, lokal, etj.



Profesor Bashkim Kuçuku nga Universiteti i Tiranës trajtoi temën *Letërsia në sistemin shkollor bashkëkohor –si problem të mprehtë dhe vlerësoi qasjen e konferencës si qasje thelbësore, tradicionale dhe bashkëkohore*. Thelbësore, sepse qenia dhe qenësia, vetjake dhe kolektive, kanë pasë qenë dhe vazhdojnë të jenë përbërës gjallues të kombit e të identitetit.

Leterësia dhe gjuha, me të cilën është shkruar letërsia, i mishërojnë ato, në mënyrën më të plotë të mundshme, të larmishme e kontretizuese-argumentoi ai.

Tradicionale, sepse, të parët, që kanë shkruar letërsinë, si dhe ata që e kanë përcjellë në shekuj, nëpërmjet kësaj qasjeje në programet, tekstet dhe auditorët, kanë pasë pasur vetëdijen, qëllimin dhe misionin ta ruanin dhe ta zhvillonin identitetin e vet, ose, ndryshe, të ruanin e të zhvillonin qenien dhe qeniesinë e vet.

Së treti, është qasje bashkëkohore, sepse, edhe sot, qenia e qeniesia e bashkëkohësve janë të përcaktuara dhe i përkasin atij identiteti kombëtar, jetojnë, përjetojnë dhe zhvillohen në membranën e tij, nëse nuk janë duke u tjetërsuar, ose, tjetërsuar.

Tema e konferencës rrjedh dhe është e lidhur drejtpërdrejt me një nga problemet më të mprehta të qenies dhe të qeniesisë kulturore të kombeve dhe të identiteteve, në epokën e sotme të ndërkomunikimit të pakufizuar, të bashkëjetesës e të integritimeve të tyre, në fqinjësi dhe përzierje. Procesi historik progresiv bashkëkohor ka në vetvete edhe kahun e kundërt, konfliktet, turrjen, rreziqet e zhbërjes, pse jo edhe të zhdukjes së identiteteve kombëtare e kulturore, në kontekstin globalizimit gllabërues e të uniformizmit të frikshëm.

Në rrethana të bashkëjetesës konkurruese, identitet kombëtar me popullsi të vogla, kanë mundësi të zhvillohen mbarshëm, mirëpo, në rrethana të supremacisë eliminuese/ përjashtuese, ato janë të rrezikuara të zhduken.

Profesor Kuçuku ka parashtrori dy programe të maturës (BAC) së liceut të përgjithshëm francez.

Veprat, që analizohen, janë të caktuara në programin kombëtar, madje, më saktësisht, të fiksuara, sikurse përdoret fjala në frëngjisht. Në hyrje/introduction, nga *Buletini zyrtar i Edukimit Kombëtar*, citohet nyja, si të thuhet neni, përkatës (datë 30 prill 2020).

Të gjithë autorët dhe veprat janë vetëm prej letërsisë frënge. Ky është dhe përfundimi më i rëndësishëm, që del prej gjedhes së shkollës bashkëkohore franceze.

Andrea di Giuseppe parashtrori se mësimi i gjuhës dhe letërsisë italiane në një kontekst akademik në Itali përbën bazën e përbashkët për sistemet e universiteteve publike në shkallë të ndryshme specializimi sipas misionit te vet institucional.

Ai tregoi sesi Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Bashkëpunimit Ndërkombëtar (MAECI) ofron kontribute për shkollat, katedrat, mësuesit që ofrojnë programe specifike dedikuar përmirësimit të sistemit italian të trajnimit në botë, një burim i rëndësishëm në kuadrin ministror të promovimit kulturor.

Në trajtimin e saj, dr. Olimbi Velaj i perqëndrua në vendin qe zë folklori shqiptar në kurrikulat universitare dhe në mënyrën si studiohet ai. Velaj trajtoi evolucionin e objektit të studimit të folklorit, raportin e tij me etnologjinë e antropologjinë si dhe faktin se folklori përqendrohet tërësisht ne studimin e kultures lokale, vendase. Ajo solli shembuj se si studiohet folklori ne shkollë dhe ne universitet, referuar vendeve te tilla repupublikat baltike dhe vendet skandinave. Studiuesja argumentoi pse tek ne folkllori duhet mesuar dhe trajtuar ne te njejten menyre. Ajo u ndal ne faktin e mesimit te folklorit si performance dhe jo vetem si tekst. Ne perfundim Velaj theksoi se ne sistemin universitar duhet studiuar patjeter nje semester folklor shqiptar dhe se kjo lëndë duhet te marrë një semester edhe në sistemin parauniversitar.

Veli Karahoda

FUNDI I PALAVDISHËM I IGOR BAGRICKIT

Fragment nga romani



Bagricki, Andante

Po e nis këtë shkrim për vetveten dhe për të tjerët pa ma kërkuar apo detyruar njeri, mbase i nxitur nga bindja se me t'i hedhur në letër disa gjëra që i kam mbajtur për vete për një kohë të gjatë, do të gjej, më në fund, njëfarë ngushë llimi e ndoshta edhe një grimë rehati për këtë shpirtin tim që — nëse më pyetni mua — ka zënë të rrënohet si një shtëpi e vjetër. Po ju them: diçka po thyhet brenda meje me ngadalë e me një rrapëllimë të mezidëgjueshme. Mos është kjo rrapëllimë vetë tingulli i shembjes së shpirtit? Këtë nuk e di.

Ndërsa shkruaj — e siç e keni kuptuar tashmë, Damen und Herren, po mundohem t'ju shkruaj në gjermanisht sepse, ç'është e vërteta, unë edhe jam njëfarë gjysmë-gjermani — dora ime, e pashkathët nga mungesa e rutinës, dridhet lehtas mbi letrën e bardhë duke provuar të paevitueshmen: se çdo fillim shoqërohet nga ajo që ju e quani Ehrfurcht, nderim e frikë, një shprehje që, në këtë rast, mund të mos jetë një gjetje fatlume. Ju nderoj, sepse s'ju njoh, por s'mund të them se kam frikë prej jush. Frika nga e panjohura është bestytini, do të thoshte Herr Feuerbach, të cilin e ftoj në ndihmë në çastet e dyshimit dhe ligështisë, sa herë që mendimet e mia luhaten mes besimit dhe mosbesimit, mes zotit dhe asgjësë.

Gjithçka nisi, të them kështu, në nëntorin e vitit 1968. E në marginën e këtij shkrimi unë sapo shënova datën e sodit: 23 shkurt 1999. Vallë, a mund të shkruaj për tërë ato që kanë ndo dhur brenda tridhjetë e një vjetësh pa ju shkakuar një mërzi të

padurueshme?

S'mundem. Dhe as ju, Damen und Herren, s'do ta dëshironit një gjë të tillë. Do të qe një lexim i lodhshëm dhe mbase do t'ju ndillte krupën e do të pështiroseshit si asnjëherë tjetër në jetën tuaj. Por, veç në fillim, sepse ka të ngjarë që, më pas, ju do të mësoheshit edhe me gjërat më të neveritshme, më makabre që mund të imagjinoni. Larg qoftë: nuk është synimi im që të ndez impulse të lashta tek ju, as të zgjoj prirjet tuaja të fjetura për dhunë; unë do të doja të besoja se ju s'keni shkelur kurrë me këmbë as edhe një buburrec, ndaj nuk dua që syri juaj të mësohet me tmerre e me dhunë, sepse me t'u mësuar me këto — e kjo është gjithsesi e mundur — ju do jeni në gjendje të vështroni me ftohtësinë më të madhe edhe kasaphanën më të tmerrshme pa e lëvizur as qerpikun tuaj. Andaj, them, më mirë është të jetoni me iluzionin e pafajësisë. S'keni shkelur as buburrecin me këmbë, por kur e kur — mos e mohoni — keni ndier ndonjë urrejtje të vogël për dikë, keni bërë ndonjë dredhi, keni mashtruar e gënjyer, e mbase edhe ia keni vënë syrin gruas së mikut tuaj ose burrit të mikeshtës suaj gjatë një darke. Vogëlima, do të thoni ju, por gjithçka nis me vogëlima. Atëherë, pa humbur kohë, t'ia nisim.

Nëntor, 1968. Vjeshtë e vonë. Isha në Stockholm me një grup studentësh në një eskursion dyjavor. Në ditët e para ne vizituam muzetë Vasa dhe Nobelmuseet, pallatin mbretëror dhe Riksdagen. Një ditë hipëm edhe në një pirg të lartë prej nga mund të shihnim, si në pëllëmbë të dorës, pothuajse gjithë Stockholmin: urat

dhe grykat gjarpëruese mes ishujve dhe gadishujve, pirgjet e arta e të argjendta mbi çatitë e bukura të godinave me rëndësi historike, rrugët dhe rruginat, lundrat dhe anijet që davariteshin butësisht në mjegullën e rimitë vjeshtore si në ndonjë ëndërr. Gjithë këto ne i vështronim përmes trumave të reve që lëviznin prajshëm mu përpara syve tanë. Më pas hëngrëm salsiçe dhe akullore në qytetin e vjetër, në *Gamla Stan*.

Një mbrëmje me t'u kthyer në dhomën tonë në hotelin ku po qëndronim unë dhe miqtë e mi, Vaso e Pilgrimi, sapo u bëmë gati për të dalë në qytet e ndoshta edhe për të shtënë në dorë ndonjë nga ato suedeskat si sheqere, Vasoja shfaqti befas njëfarë pakënaqësie femënore duke thënë se ekskursioni, me gjithë ato vizita të kota muzeve e godinave historike, e kishte mërëzitur tej mase, kështu që ai preferonte diçka më interesante, diçka që do ta mbanim mend për një kohë të gjatë. Ç'është e vërteta, ne nuk i vumë veshin dhe veç qeshëm me të. Pilgrimi mbështolli një *joint* dhe fjalët e Vasos humbën në mjegullën e tymit të hashashit prej Marokut.

Me Vason dhe Pilgrimin qeshë njohur nja gjashtë vjet më parë në burgun për deli kuentë adoleshentë. Asokohe Vasoja mbajti një dënim prej dy vitesh për një bastisje me armë zjarri, Pilgrimi një vit për rrahjen brutale të një polici në kinemanë *Proleter*, kurse mua më mbajtën për plot nëntë muaj për një sulm në afekt ndaj fshatarit Miodrag Saviç me profesion ruajtës bagëtie dhe dreser qensh.

Vaso dhe Pilgrimi vinin nga familje të privileguara oficerësh të Armatës Jugosllave, kështu që mbas mbajtjes së dënimit, përmes ndërhyrjeve nga anë të ndryshme dhe prej njerëzve të pushtetshëm, këtyre iu dha edhe një shans, gjithsesi i fundit, për të shmangur rrugën e krimit. Kështu, nga burgu për delikuentë, këta përfunduan në universitet. Si mjeshtër për thyerjen e kasafortave të blinduara, Vasoja nisi studimet për inxhinier makinerie ndërsa Pilgrimi, sa për sy e faqe do të thosha, u regjistrua në fakultetin e bujqësisë.

Me të dalë prej burgut, sesi m'u duk edhe mua se bota e krimit kishte zënë të intelektualizohej dhe s'më mbeti veçse të regjistroja edhe unë një fakultet. Kështu, me ndihmën e gjeneral-majorit Pavle Dundriç, babait të Vasos, u regjistrova në fakultetin filozofik ku kishte shumë femra të bukura dhe mendje hapura të cilat, me aq sa mundnin, po bënin përpjekje mjaft serioze për të ndryshuar normat ekzistuese të shoqërisë sonë patriarkale dhe sidomos për të thyer tabutë seksuale ashtu siç bënin kombet më të zhvi lluara si danezët, holandezët, suedezët e të tjerët.

Të kthehemi në Stockholm ku mbrëmjet zakonisht i kalonim në një bar nate në *Gullmarsplan* duke pirë vodkë me limon e duke dëgjuar *cool jazz*. Një mbrëmje, një suedez i pashëm, i bëshëm si një viking, iu vardis Pilgrimit, por, kur ky i fundit e zuri në një qoshe dhe i pëshpëriti diçka në vesh, suedezi u largua me çehre të prishur. Ne u bëmë kureshtarë dhe pothuajse njëzëri e pyetëm Pilgrimin se çfarë i pat thënë në vesh suedezit dhe ai, duke bërë një gjest me dorë sikur po largonte një mizë prej zverkut, tha:

— I tregova çfarë mendojmë ne malazezët për dylberët.

— Unë jam serb — tha me djallëzi Vasoja — dhe s'mund ta di se çfarë mendon një malazez. Ç'është e vërteta, unë mendoja se malazezi nuk mendon fare, sepse përton. Atëherë, na thuaj, çfarë mendon një malazez për çështjen në fjalë?

Pilgrimi heshti për pak kohë sikur po sajonte një përgjigje përfundimtare për diçka me shumë rëndësi dhe tha:

— Malazezi mendon se çdo gjë ka një çmim. Me suedezin nuk u pajtuam për çmimin. Asgjë më shumë.

(Vijon në faqen 9)



ETËHEM HAXHIADEMI DHE GABRIELE D'ANNUNZIO: Fate të skajshme

Nga Shpend Sollaku Noë

Ia kisha borxh një sarkofagu bosh këto rreshta. Ia kisha premtuar një mermeri të nxehtë si tehu i thikës. Fjalët që do të vija në tezgjahun e mendjes ia kisha thënë vetes qindra herë. Nëse nuk do t'i hidhja mbi letër edhe kësaj here, rrezikoja të më mbeteshin në grykë, të më linin pa oksigjen, të më përplasnin përtokë.

Epilepsia akute e ndjenjave më errësoi shikimin edhe njëherë këto ditë, ndërsa përhumbesha nëpër tronditjet që mund të shkaktojë vetëm një madhështi si ajo në Gardone Riviera, e quajtur “Il Vittoriale degli Italiani”; e ideuar më shumë për vetveten prej një poeti të madh: Gabriele d'Annunzio. Mauzoleu është realizuar pas vdekjes së poetit prej arkitektit Maroni. Është një mauzoleu atipik, i frymëzuar prej traditës etrusko-romake. Tre rrathët në mermer Botticino vënë në pah fitoret e të të përlurve, të artizanëve – maja e diamantë i të cilëve janë poetët - dhe të heronjve. Në qendër të tij është vendosur qivuri i poetit të madh.

Gjithkush, edhe ai që nuk është vizitor i ri, mbetet gojëhapur duke filluar që nga Hyrja Monumentale në Vittoriale. Pastaj nuk ka sesi të mos admirojë Amfiteatrin veror, të frymëzuar prej atij antik të Pompeit. Po ajo e quajtura Prioria, shtëpia e preferuar në të cilën d'Annunzio kishte studion dhe ku dha frymën e fundit? Si mund ta lerë indiferent brendësia e saj me bibliotekën prej 30 mije vëllimesh, me vizatime të Mikelanxhelos, me sende që i përkisnin Napoloeon Bonapartit, pëfshirë edhe maskën që iu vu mbi fytyrë pas vdekjes perandorit francez? Harrohet anija luftarake “Puglia”, ngjitur e betonizuar në shpat të kodrës? Po avioni gjuajtës S.V.A. me të cilin d'Annunzio fluturoi mbi Vjenë për të sfiduar Austro-Hungarinë? Po kopshtet, frutorja dhe limonishtja? Po muzeu d'Annunzio Hero? Po ai d'Annunzio Sekret?

Ia kam zili poetit të madh gjithë këtë qytezë metafizike parajsore, por jo për vete. Me sa duket unë, Shpend Sollaku Noë, i lindur në Lushnje, as që kam për të pasur një varr në atdhe. Por prania ime mes kësaj mrekullie më shtyn së pari të mendoj fate të tjerë, edhe më tragjikë se i imi. Risqe në dukje të largët, qindra e qindra kilometra që këtej.

Sarkofagu i parë që bën të më zënë ngërçet e shpirtit është diku andej, në viset e Shqipërisë së mesme, në një qytet që ka lidhje edhe me historinë e jetës time, por sidomos me poetin e vyer që së fundi jam duke njohur më shumë. Mbi pllakën vertikale të mermerit të errët, nën foton eliptike lexohet: Etëhem Haxhiademi, 8 – 3 – 1902; 16 – 3 – 1965. Mbi rrasën horizontale – vargjet e tij prej vëllimit “Lyra”: Qëndro

gjersa të marrësh frymë i lirë... Mbi mermer mungon vendlindja: Elbasan. Por këtë janë të shumtë tashmë ata që e dinë. Mungon edhe vendvdekja: Burgu i Burrelit. Por këtë ndoshta janë të pakët ata që e dinë.

Nuk është shkruar as edhe që sarkofagu është bosh, pasi eshtrat nuk i janë kthyer kurrë familjes.

Edhe këtë hidhësi historike janë shumë të pakët ata që e dinë. Apo të shumtë ata që e kanë harruar. Pasi përdhosja e vdekjes së tij nuk mund të ketë patur një autor të vetëm.

Eh Gabriele d'Annunzio, ç'më bëre, duke më shpuar shpirtin me njëmijë gjilpëra, ndërsa padashur më sjell ndërmend bashkëkombësin tim, atë të kthyerin në ajër, në copëzë qielli, të paktën derisa t'i gjenden eshtrat, nëse është shkruar që ajo ditë të na vijë.

Edhe ti, poet i Vittoriale-s, ke lindur dhe je shuar në mars, ashtu si kolegu yt i Elbasanit. Kur ti botoje “Libri sekret i Gabriele D'annunzio-s”, Et'hem sillte në dritë vëllimin “Lyra”. Atbotë kishte hedhur mbi letër edhe pjesën dërmuese të tragjeditë. Ti ishe ndërkaq një korifë, ai imponohej edhe me perlën e tij poetike. Që të dy ishit të brezit të “poetëve të mallkuar”, siç do t'ju kishte klasifikuar P. Verlaine.

Ashtu si ty, edhe Et'emi ynë mund ta kish lidhur krijimtarinë me atë brez të mëdhenjsh që quheshin J. Joyce, L.

Pirandello, R. Musil, G. Ungaretti, E. Montale, A. Moravia. Nëse nuk do të kish menduar t'i shërbente Shqipërisë, por do të kish zgjedhur jetën në Berlin apo Vjenë, edhe Haxhiademi ynë sipas mjaft gjasave do të ish studiuar si avanguardistët futuristë, dadaistë, surrealistë, ekspresionistë. Këta të fundit vuanin plagët e shoqërisë dhe vetpërfshiheshin tek të mallkuarit. I mallkuari i vërtetë historikisht mbeti vetëm ai që e pagoi shtrenjtë nacionalizmin e tij dhe dashurinë për artin: punëtori i pendës Et'hem Haxhiademi.

Ti, Gabriele, jetoje në Itali; Et'hem atje ku horizonti verbohet, jo fort përballë Peskarës tënde. Midis jush – një det rënkimesh. Kishe dëgjuar ndonjëherë nga bashkëluftëtarët e tu për Lushnjen, Gabriele ? Mes atyre baltrave e njohu jetën e drejtpërdrejtë poeti ynë. Ndërkaq ti, i zhgënjyer nga përvoja e Rjekës, ishe tërhequr në vilën e vetmuar princërore të Cargnacco-s.

Ty, pas vdekjes, nuk t'u kërkua ndonjëherë llogari pse kishe qenë ekstremist i djathtë, pse pastaj u ktheve në ekstremist të majtë; pse kishe qenë nacionalist, pse irredentist, pse interventist. Poetit tonë të urtë i kushtoi shtrenjtë përkushtimi në shërbimin ndaj shtetit amë. Ndërsa për ty, carissimo d'Annunzio, filluan të zhvendosin mermeret nga Botticino për të të lartësuar përjetë përballë Liqenit të Gardës, Et'hem ynë i kishte shkruar tashmë të gjashtë

tragjeditë e tija të mëdha. Ty, i dashur Gabriele, ato vepra do të të kishin siguruar lavdinë, edhe sikur të mos kishe shkruar diçka tjetër. Haxhiademit, për fatin e tij dhe tonë të keq si edhe për krim kombëtar, nuk arritën as t'i anulonin fletën e arrestimit.

Të kujtohet, Gabriele, kur i shkruaje autoriteteve më të larta për të t'i falur borxhet? Sepse shteti, sipas teje, duhej t'i paguante borxhet private të poetit, që mjeshtrit të pamort të mos i prishej niveli i asaj jetese që i mbante gjallë talentin. Edhe mbretit i dërgove njoftim, pasi ti ishe poet. Dhe mbretërit lindin prej nënës njerëzore, poetët e vërtetë prej perëndive. Ata vijnë aq rrallë në këtë botë, sa duhej të ishte detyrë e shtetit dhe e shoqërisë që jo vetëm t'i mbante me bukë, por edhe t'u krijonte kushtet për të shkruar. Humbja e një poeti është më e pazëvendësueshme për një popull sesa humbja e një mbreti.

Ej, Gabriele, sipas këtij këndvështrimi ngjani shumë me Et'hemin, e di? Shih se çfarë shkruante poeti ynë: “...Artisti apo shkrimtari shqiptar, qi ti banjë ballë nevojave të jetës, duhet më përpara të merret me ndonji punë qi ep bukë si ç'flitet këtu në Shqipni, dhe për mjeshtërin qi i flet zemra të punojë nëpër orë pushimi ose të lanjë mangut gjumin e natës”.


E sheh or mik, sa pak kërkonte i shkreti poet shqiptar? E dhimbshme deri në asgjësim dëshira e tij.

Ndërkaq ti jo vetëm punove i lirë përgjatë gjithë kohës për pasionet e tua më të mëdha, por nuk i le gjë mangut edhe dëfrimeve të shfrenuara. Me sa zero duhet t'i numëroj dashnoret e tua? Ti, për t'u ushqyer me luks, thonë se u bëre edhe aktor porno. Tani kritika sugjeron si të vërtetë faktin se ke qenë ti që luaje “Frate foco”. Ndërkaq poetit nga Elbasani as që i shkonte ndërmend të tradhëtonte gruan Burbuqe, as edhe më pas, në ëndrrat që e shpinin përtej zgarës së hekurt.

T'i nuk kurseje kurrë as edhe per kokainën, që e quaje “pluhuri i çmendur”.

Et'hem Haxhiademi, pas shufrave fatale të burgut, i kërkonte familjes vetëm pak tokla sheqeri, sepse i forconin kujtesën. Priste ditën të flakte prangat, prandaj edhe kërkonte të fiksonte në raftet e kujtesës gjithçka që ia ndalonin të shkruante brenda mureve me diell të vdekur.

Siç e vërteton tek poema jote “Maia”, jeta jote, caro d'Annunzio, u jetua sa për dhjetëmijë jetë. Ajo e elbasanllit tonë nuk arriti të jetë as edhe një e tërë, por u shua pas 18 vjetësh në qelitë e terrorit kuqalash. Zyrtarisht zemra e tij nuk i rezistoi më



errësirës. Në qelitë - pronë edhe të helmit tinëzar.

Dëgjomë mua, vëlla Gabriele, ti ke qenë me fat qëkur kishe lindur në Itali, ti ke qenë me fat edhe pas vdekjes, kur Italia jote, me dashjen e të mëdhenjve, hyri nën sqtullën amerikane. Haxhiademi nuk e pati atë rrësk. Vendi i tij ra nën thundrën mesozoike të Stalinit. Sikur të kish ndodhur edhe me popullin tënd ajo gjëmë, “Vittoriali” yt do të ish kthyer së paku në një repart ushtarak; eshtrat e tua – sot krenare në majë të mauzoleut – do të ishin bërë kërruarëse dhembësh për peshqit luccio të liqenit të Gardës.

Përpara teje edhe unë them se, ashtu si ty, jam krenar që i përkas vendit tim. Por Haxhiademi, që ti nuk mund ta shohësh, më zë prej mënge: Çfarë? Si mund të jesh krenar? Sipas cilës mënyre, asaj të Konicës, apo asaj të Çajupit? Mua aresyeja më shtyn drejt Konicës, por shpirti im, përdreq, është i dobët: ai citon edhe në gjumë Çajupin. Pastaj, Etëhem, ja, sapo të zesh vendin e merituar me vepra në Panteonin Kombëtar, atëherë edhe ti do ta besoh se ata që të zhvatën lirinë dhe jetën, janë hequr vërtet qafesh, që më në fund as unë nuk gjendem më në qelinë tënde, duke qëmtuar një gjurmë të helmit, një copëz vegle të harruar të torturave, apo të paktën ca faqe të shpëtuara të veprave që shkrove apo përktheve në atë burg mesjetar.

Eh, Gabriele i dashur. Gurët e tu të çmuar, që i fale kulturës italiane, tashmë bota mund edhe t’i ketë në shtëpi, edhe mund t’i prekë duke vizituar “Vittoriale”-n. Mund edhe t’i kunsultojë on line. Bashkëkohësi yt Haxhiademi mbeti qysh atëhere – në ditën e akullt të 25 janarit, në vitin e egër ‘47 – si një minierë diamantesh që sapo kish filluar të shrytëzohej, mbi të cilën, ata që i trëmbeshin verbimit prej tij, hodhën dinamit për t’ia mbyllur hyrjen. Akoma presim ta hapim atë xehe të çmuar. Por ne jemi Shqipëri, ku këmbët kanë akoma të lidhura tek kyçet gjylet e rënda të luftës së klasave. Ne hiqemi zvarrë, nuk ecim, aq më pak nuk fluturojmë, ashtu si të pëlqente ty të bëje, mbi qiejt e Vjenës, Gabriele . E dije që edhe Et’hemi ynë e ka pasur në zemër Vjenën? Eh, atje kish studiuar, për drejtësi, por si shumë të tjerë që vunë atdheun në plan të parë, preferoi baltën e ëmbël si mjalta. Kishte shumë të meta të tjera, Haxhiademi ynë; njihte rrjedhshëm italishten, gjermanishten, latinishten, anglishten, frëngjishten, greqishten e vjetër e të re. Pse jo edhe turqishten. Kish lexuar në origjinal Homerin, Shakespeare-in, Goethe-n. Virgilio-n, Corneille-n e sa të tjerë. Pastaj kish pas qenë shumë i dhënë në respektimin e rregullave të punës dhe shoqërisë, besnik i familjes, vetmohues në artin e të shkruarit. Tamam për të punuar në Lushnjen e vitit 1928, nuk thua? I padenjë për të vazhduar të japë letërsi në Normalen e Elbasanit, sidomos kur në pushtet erdhën anormalët. I papërshtatshëm edhe për t’u bërë element i qendrueshëm i tabelës së acideve titisto-staliniste.

Nuk kam më forca për ta vazhduar këtë shkrim, i dashur Gabriele. Të më falësh edhe ti, i përkryeri portret i dhimbjes – Etëhem Haxhiademi. Po ndihem sikur të jem epileptik në këto çaste. Kam humbur ekulibrin dhe nuk mund të qëndroj as edhe ulur. Bota po më rrotullohet. Alektrokardiograma po më çmendet. Kush e di sesa është ngjitur presioni i gjakut në damarë. Zhiva po shpërthen termometrin nën sqtull. Sytë, sidoqoftë, nuk i kam të lagur. Loti i fundit nuk më kujtohet qëkur është derdhur dhe gjendrat e mia tashmë janë shterpa. Lotin e shpirtit nuk mund të ma shihni. Mbërthejeni shikimin me kujdes mbi pikat, presjet, pikëpyetjet, pikëçuditëset, dy pikat, pikëpresjet... Janë të gjitha njollëza gjaku, të rrjedhura në qelinë e zezë të Burrelit, në vitin tragjik 1965, kur rruazat e kuqe reshtën së renduri në venat e Etëhem Haxhiademit të madh.

(*Vijon nga faqja 7*)

Qeshëm me malazezin tuhaf dhe u dehëm shumë.

Të nesërmen ndërsa drekonim në restorantin e hotelit, Vasoja së rishti na mbushi me kureshtje duke folur me admirim për një emigrant jugosllav me emrin Milan me të cilin kishte shkëmbyer ndonjë fjalë në barin e hotelit tonë. Vasoja e përshkroi Milanin në mënyrë të kursyer, veç me një fjalë: kryemadh.

— Mos qeshni! — gërthiti Vasoja. — Vetë ai m’u afrua e m’u prezantua. Në fillim deshi të më shiste xhinsa e këpucë të vjedhura, por mandej nuk di si erdhëm deri te armët. Kryemadhi më tregoi se kishte disa pistoleta dhe një revolver me mulli *Smith & Wesson*. Unë e këqyrja sikur s’po kuptoja asgjë, por më pas, fjalë pas fjale, ramë në ujdj për të... domethënë... jo ai, veç ne... a jam i qartë, a jo? Kryemadhi tha: kam edhe maska e dorëza...

Unë e Pilgrimi pothuajse në akord ia ngulëm sytë Vasos me njëfarë mosbesimi. Dhe jo pa arsye. Ne tashmë e njihnim mirë Vason, impulsivitetin e tij, manitë e tij të kohpaskohshme për të bërë gjëra të mëdha — dhe pikërisht kjo — ndjenja e grandiozitetit, që kur e kur e mbërthente Vason, na hapte telashe mjaft shpesh.

— Mos paragjykoni, o njerëz! — ia bëri Vaso sikur t’m’i kishte lexuar mendimet. — Është një punë që bëhet... e pse të mos jetë? E tha edhe Milani, kryemadhi.

— E çka tha Milani? — e pyeta. — Milani tha: A ju mjafton *Smithi*? Unë i thashë po.

— E pse të na huazojë Milani *Smithin*? — ia bëri Pilgrimi. — Ç’dobi ka ai nga kjo gjë?

— Mos je idiot? — ia ktheu me nerva Vasoja. — Shumë e thjeshtë: Milani e do pjesën e tij pasi ta kemi bërë punën! Kaq! Ç’të them? Vasoja na futi në mendime të

thella. Por, a ishte kaq i krisur miku ynë Vaso Dundriç, i biri i lazduar i gjeneral-majorit me nam Pavle Dundriç, sa të mendonte se ia vlente të plaçkitnim ndonjë bankë apo ndonjë dyqan stolish të çmuara veç për hir të argëtimit? Natyrisht që jo. Asokohe, në rrethet e belaxhinjve nuk i merrnin seriozisht njerëzit që “ende nuk e kishin parë botën” dhe që s’mund të krenoheshin të paktën me ndonjë krim të lehtë të bërë në botën perëndimore. Vasoja vetëm këtë donte: të krijonte ndonjë legjendë urbane për vetveten në nëntokën kryeqytetase, të bënte emër dhe name ndoshta edhe pare. Nuk di me sa palë mend e kishte bindur veten Vasoja se për këto “benefite” ia vlente të kaloje një pjesë të jetës edhe në burg, sepse — dhe ky ishte argumenti — me të dalë prej burgut do të fitoje respektin e gangsterëve, hajnave, xheparoshëve, kontrabanduesve dhe fundërrinave të tjera njerëzore të nëntokës. Tashti, Damen und Herren, unë mendoj kështu sot, tridhjetë vjet më pas, por në atë kohë ishin të rrallë ata që merrnin guximin për të ecur kundër rrymës. Pra, asokohe edhe unë e Pilgrimi i kishim ambiciet e Vasos, përveçse Vasoja, duke qenë se vuate nga manio depresioni dhe tërë kohën humori i ndryshonte varësisht nga baticat dhe zbaticat, herë donte të ndryshonte botën siç e njihnim, herë sharronte në një melankoli të thellë që e bënte të mbyllej me javë të tëra në shtëpi duke pritur fundin e botës. Sidoqoftë, mos kujtoni se ne ishim budallenj dhe nuk e dinim se, në qoftë se e bënim atë që mendonim se s’kishim çare pa e bërë, jeta jonë do të kthehej përmbys. Po, këtë e dinim, por e dinim po ashtu se asgjë në botë nuk jepej falas, lëre më fama, legjenda urbane apo respekti i fituar me shumë mund e sakrificë. Fundja, edhe në qoftë se e dreqosnim fare, atëherë kurrgjë kurrkujt: do të bënim ndonjë vjet burg, por jo në një

burg dosido, po në një burg suedez.

Të kthehemi në hotel. Atë mbrëmje Vasoja shkoi më tej: nxori nga çanta e tij revolverin me mulli *Smith & Wesson* dhe na mbajti një leksion sesi duhej për dorur, montuar e çmontuar një revolver kaq i sofistikuar. Eksitimi i parakohshëm na çoi buzën në gaz. Më pas, Vasoja na e shpjegoi edhe planin dhe ne... asgjë. Veç e këqyrnim Vason dhe çele gur gojën.

— Më pëlqen fort — tha Pilgrimi pa u menduar dy herë, e ndoshta as edhe njëherë. — Lehtë dhe thjesht, si në një film.

Mbase s’është nevoja t’ju them se jeta s’është film, kështu që as Milan kryemadhi dhe as ne të tjerët nuk morëm “ndonjë pjesë” nga puna që e bëmë ose, më mirë, nga puna që s’e bëmë. Me maska e me dorëza dhe natyrisht me revolverin me mulli të kryemadhit u futëm në një bankë të vogël që ndodhej në një rrugicë të qetë me shtëpiza të lyera me ngjyra të ndezura si në përralla, me oborre të rrethuara me taraba të bardha e me lule të bukura vjeshtore te parvazet e dritareve, dhe atëherë ndodhi diçka e çuditshme, shumë e çudit shme: Vasoja e nxori armën nga xhaketa dhe në vend që ta kthente në drejtim të nëpunësve të llahtarisur mbas xhamave të sportelit, ai e lëshoi armën përtokë dhe u shtri edhe vetë, përmbys, mbi dysheme, me duart të lidhura mbas zverkut, gati për t’ia vënë prangat. Unë e Pilgrimi vështruam njëri-tjetrin dhe nuk di tamam se çfarë ndjenjash shkëmbyem mes veti në atë çast. Mua m’u bë se edhe ai mendonte si unë. S’mund të mos mendonte si unë. Atëherë, dy punëtorët e sigurimit që bënë roje në bankë, e që njëra — gati-gati më vjen marre ta them — ishte një grua në të pesëdhjetat, e ashpër dhe fort e ngrysur në fytyrë, kërkuan nga ne, urtë e butë, duke na drejtuar tytat këmbëngulëse të *Glockut*, të shtrihe shim përmbys ashtu si Vasoja, me duart mbas zverkut. Një pamje bukur tragjikomike, do të mendoni ju me të drejtë.

Ashtu të shtrirë me duart pleksur mbas zverkut, në qoftë se donim, me pak mund e me një ndonjë buzagaz ironik, ne mund të çonim sytë një grimë për të parë kasafortën e blinduar ku me gjasë i mbanin dengat e parave me portretin e Gustav Adolfit, paratë që ne sdo t’i shihnim kurrë.

Njëfarë komisari i policisë që mbante syze me xhama të trashë i quajtur Yngwie Åkesson, pasi na mori në pyetje dhe na i kontrolloi pasaportat, na shpuri nëpër qelira që s’dallonin me asgjë nga dhomat e hotelit ku kishim qëndruar gjer atëherë. S’kishim, pra, asnjë arsye për t’u ankuar. Po krijonim famë e nam pothuajse pa u munduar fare dhe skandinavët po na hynin në hatër: ishin njerëz të butë dhe as që u shkonte mendja të na zhdëpnin dajak veç për hir të argëtimit ashtu siç ishte zakon në burgjet e shtetit tonë socialist. Për mëngjes servirin vezë të skuqura, harenga të marinuara, bukë thekre, kafe e çaj, kurse për drekë — biftek me salcë e me patate të rreshkura e të karamelizuara me sheqer dhe një pjatë me djathëra mbas së cilës vinte edhe deserti, zakonisht një mollë ose një dardhë. Për darkë hanim sanduiçë me kaçakavall e me proshutë. Bash si në një hotel me tre yje, po ju them, dhe më e mira e të gjithave: gjithçka jepej falas. Kështu, ne luanim biliard, shfletonim revista të ilustruara me femra nudo dhe shpresonim se edhe prokurorët dhe gjykatësit suedezë, ashtu si policët, gardianët e burgut dhe kuzhinierët, do të ishin po kaq zemërgjerë e të sjellshëm.

Mirëpo, puna nuk vajti aq larg. Na ftoi një ditë në zyrën e tij drejtori i burgut, një burrë i gjatë leshkuq me një fytyrë të ngrirë në të cilën vetëm do sy të vegjël, të qetë por njëherazi edhe hulumtues, lëviznin sa andej këndej. Këta sy kaq të qetë e të padepërtueshëm më fusnin fajin në bërthamën e shpirtit dhe unë mezi përmbahesha që të mos brohorisja: Jam fajtor, Herr Drejtor! Më ndëshkoni!

Libri i Hapur

Disa besojnë se ka qenë Adura, drejtori i bibliotekës së qytetit, i cili më pas u kërkoi katër njerëzve të letrave t'i shkruanin mbresat e tyre mbi atë periudhën gjithë tronditje që kaloi vendlindja e përbashkët, Pilisama. Me gjithë zënkat e pashqitshme mes tyre, qyteti i mbante të katër për intelektualë të sprovuar.

I pari, Andrea Metani, drejtor gjimnazi dhe autor dramash urbane, tha se nuk e merrte përsipër, pasi po t'i shkruante rrëfimet, patjetër do t'ia nxirrte bojën atij egoistit Terenc Mikelini. I dyti, pikërisht Mikelini, publicist dhe analist aktiv, e priti ftesën gjithë turinj ngaqë, para se zotërisë së tij, kërkesa i qe bërë mediokrit Metani. I treti, historiani i moshuar Hasan Alla, u tregua më gjakftohtë. Ai tha se nuk mund t'i hynte kësaj barre duke u yshtur nga tjetërkush, por ndoshta një ditë rrëfimet do t'i nxirrte në dritë prej inspirimit të vet, çka nuk e bëri asnjëherë. Drejtori i bibliotekës nuk mundi t'ia kthente mendjen as të katërtit, i cili kishte arsye për kundërshtimin. Dhe vërtet, ndonëse me spikamë më të vogël midis kolegëve, shi në vlimet e asaj periudhe Ylber Dauti s'i kishte lidhur duart, por ishte hedhur në aksion me *Poemën* e tij, duke e bërë edhe më lëmsh vendlindjen.

Sipas Agjencisë Botërore të Kohës, e cila kishte filialin e saj në Pilisamë, në dy vjet e njëmbëdhjetë muaj sa u shtrinë ngjarjet, diagrami i kohës së dobishme kishte qenë fort i pakënaqshëm. Ndërsa pilisamët, me zakonet e përhershëm të mëdysheve (Ishte apo është? Ku ishte dhe ku është? E mundshme apo e pritshme? Kokë apo pilë?), vetëm pak më parë kishin dalë nga ankthi i Diskut të Akullit, një imazh saturnian. Atij që thoshte se, nëse hëna goditej nga një trup i madh qiellor e kthehej së prapthi, rruzullin do ta qarkonte një qerthull akulli, këtu do të krijoheshin oqeani global dhe asgjëkund s'do të mbetej zonë toke, sepse do të binte shi për treqind vjet.

Deshi Zoti e përmbytje të përbotshme nuk pati, madje në Pilisamë nuk ra shi as tri ditë rresht. Kështu që sindromi posttraumatik i Diskut kaloi si kaloi. Por në periudhën pasuese, përgjatë atyre tridhjetë e pesë muajve, prapëseprapë në sytë e Terenc Mikelinit pilisamët sikur u përmbytën kolektivisht. "A thua nga balta që jemi mësuar të krijojmë vetë?" - do të ironizonte me cinizëm në një emision televiziv.

Për të gjithë banorët e qytetit ngjarjet qenë po ato, por historinë e përgjithshme, ngjashëm me ndodhitë e përditshme, lindjet, dasmat e vdekjet, secili e tregonte ndryshe. I ndodhur para këtij mishmashi dhe kundërshtimeve të pakthyeshme, Pandush Adura u detyrua t'i hynte punës vetë. Ai takoi shumë njerëz, mblodhi shumë dëshmi, zbardhi intervista të ekraneve e të radiove, fotokopjoi artikuj gazetash dhe përveç raporteve me shkrim që kishte hartuar personalisht për kreun e bashkisë, hodhi gjithashtu shënime të bollshme.

Megjithatë, as ky nuk është rrëfimi i drejtorit të bibliotekës, por i mbështetur në atë lëndë. Veçse është për t'u çuditur që, bash si në dosjen e tij, ngjarjet fillojnë me një lajm të gëzueshëm, i cili u synua të kthehej në festë për qytetin.

1

Sapo Gerhard Hirson u pa duke iu afruar ndërtesës së bashkisë, teksa kryepari i Pilisamës (siç i thonë këtu kryebashkiakut) po i dilte përpara krahëhapur, vetëm pak minuta u deshën që fjala të përhapej gjithandej. Gjer atëherë pilisamët kishin pritur me veshët ngrehur se cilën rrugë do të merrte komisioneri i lartë i Brukselit, nga Martiza do të shkonte në Algur apo, bashkë me shpurën që e shoqëronte, do të vinte drejt e në qytetin e tyre. Nëse vinte drejt, do të thoshte se vendimi në favor të Pilisamës ishte marrë dhe Hirsoni po sillte sihariqin.

Zija Çela

PILISAMA SELFIE

Fragment nga romani

Në romanin "Pilisama Selfie" shkrimtari Zija Çela ndërton një qytet gjysmë provincial, të mbushur deri në grykë me vanitete njerëzore autentike, të cilat marrin jetë nga përballja me marrëzitë dhe lajthitjet kolektive, ku gjedhja letrare parodiakë pleksat me prirjen tashmë të sprovuar të autorit për të përqeshur pa mbarim bashkëkohësit e vet.


Një depërtim i hollë, alegorik, pak cinik dhe më shumë i parodizuar, në realitetin politik dhe mentalitetin e korruptuar të ditëve të sotme. Një realitet onomastik dhe topografik tërësisht i sendërgjuar, por me lidhje të forta me përditshmërinë shqiptare në të gjitha nivelet, deri edhe më i fundit, "patronazhistët" që kërkojnë diktatin e tyre mbi jetën e njerëzve. Një botë e mbyllur në iluzionet e veta, iluzione tashmë të komprometuara nga shpërputhja e madhe e ëndrrave të perealizuara dhe një jete mesquine, ku çdo gjë merr pamje grotesku, veçmas projeksioni i gënjeshtërt i së ardhmes.

Me një lehtësi të jashtëzakonshme, autori sjell një galeri personazhesh metaforike, të cilat barten nëpër situata të ndryshme, gjithnjë duke manifestuar cilësi dhe karaktere njerëzore, që përfshihen në prirjen kolektive të kotësisë dhe shpresave të rreme. Një rrjet hekurudhor që duhet të kalojë pa ndërprerje në disa komunitete, pra edhe në atë pilisam, bëhet sinonim i zhgënjimit, i ëndrrave të perealizuara, mbi të gjitha sinonim i pamundësisë për të arritur hapin e prosperitetit dhe civilizimit. Duke qenë kuptim universal i shpresës dhe dështimit për Pilisamat e ngjashme të botës, ajo bëhet gjithashtu garë stigmatizuese për pushtet, prestigj e rang shoqëror, madje edhe për të arritur kuptimet e pamundura të universit.

Mehmet Kraja

Të shumtë qenë ata që lanë çdo punë për të vërshuar drejt sheshit kryesor. Kaq popull u mblodh atje, sa edhe pa qenë miting, çdo slogan që hidhte ndokush pritej në kor me brohorima. Ndonëse mbrëmja, kur trajtat e shkëlqimeve do të ishin më të forta, sikur po vononte të binte, prej padurimit fishekzjarrët e kërcaskat nuk munguan. Ato hidheshin nga sheshi, nga tarracat dhe sidomos nga ballkonet, ku valëviteshin

flamuj. Nuk mbahej mend qyshkur të ishin parë pilisamët kaq të bashkuar, kaq shpirtërisht solidarë e të kënaqur me njëri-tjetrin. Madje, ata po ndienin edhe një mallëngjim të panjohur, njëfarë përmallimi distancash të largëta, që ndoshta u vinte njëherësh nga empatia për tërë njerëzimin. Diçka e tillë u shpreh edhe në fjalët që Ylber Dauti po i thoshte mikut të tij, drejtorit të bibliotekës. "Kështu ndodh kur e mira të



troket vetë te dera. Sa e bukur është bota, bujare ngahera!" - bëri dhe një rimë poeti. Tashmë, çfarë më parë ishte gjykuar si lajm i gëzueshëm, po cilësohej Lajmi i Madh, sepse kishte të bënte përfundimisht me një vendim të tillë.

Po ç'ishte ky vendim?


Prej shumë e shumë kohësh, njerëzimi ndoshta ka ruajtur vagullt një synim, dëshirën për ta përmirësuar jetesën në provincat e pamatshme të botës. Njëra nga mënyrat vlerësohej lidhja hekurudhore e qyteteve që, duke qenë të papërfillshme nga përmasat, nuk e kishin pasur këtë fat. Mirëpo ideja nuk mund të fantazohej pa fund. Prandaj, siç e donte nderi i tij, kontinenti i vjetër e nisi i pari jetësimin. Pasi kishin fjetur gjatë nëpër sirtarë (projektet ishin bërë dikur në terren pa e shpallur qëllimin), Bashkimi Europian do ta financonte hekurudhën në disa lote. Por financimi vinte kushte. Çdo qytet, ku do të kalonte treni, duhej t'i siguronte vetë shpenzimet për ndërtesën e stacionit, platformën e mbuluar, si dhe dy kilometra hekurudhë në hyrje, dy në dalje. Ky kushtëzim ishte i panegociueshëm, ashtu si detyrimi për të përmbushur në afat të gjithë paragrafët e marrëveshjes.

Deri në orën kur kryepari Viktor Frankurti shtroi darkë për mysafirin e lartë, Pilisama u mbush me gjithfarë të vërtetash (të konfirmuara, shtonin pohuesit) dhe gjithfarë pandehmash që i vinin në dyshim të vërtetat (por dyshimi shprehej me rezerva). Sidoqoftë, tashmë po zotëronte versionin kryesor.

Thuhej se të gjitha qyteteve europiane, ku ndërkombëtarët u kishin çuar lajmin deri atëherë, për t'i dhënë projektit sa më shumë tërheqje, u kishin përmendur një veçori të trenit që do të qarkullonte i pari në ato vise. Sipas disa pilisamëve, thënë shkurt, e kishin quajtur "treni magjik". Sipas disa të tjerëve, kjo fjalë vërtet ishte përdorur nga të huajt, veçse në formën gramatikore "i magjishëm". Ata kishin thënë se, në udhëtimin e përrurimit, treni do të hynte në qytetin e tyre me tre vagonë, të tre do të kishin plot zbukurime, por "veçanërisht lokomotivës do t'i jepej një imazh i magjishëm".

Kur të nisej ky tren, mbështetur në një mesazh telefonik, që mëtohej se sapo kishte dalë nga darka me komisionerin, secili vagon do të kishte nga jashtë kutinë e tij postare. Në çdo stacion ku do të ndalonte treni, pasi të zgjidhte vagonin, një përfaqësues i qytetit do të votonte, duke hedhur në atë kuti Kartën e Qytetit. Se cili do të ishte përfaqësuesi nuk thuhej, por thuhej se cilët nuk mund të ishin. Postet e përjashtuara i përkisnin kryetarit të bashkisë dhe prefektit të qarkut.

Enigma se cili do të ishte përfaqësuesi i Pilisamës ngjalli kërkshëri të menjëhershme. Por misteriturbullues mbetej edhe qëndrimi që do të mbante ai, domethënë, cilin nga vagonët do të zgjidhte?



Teksti i romanit “Terror e dashuri”, i prozatorit Shkëlzen Maraveci, qysh në titull e prezanton dhe zbulon fatin e mbrapshtë të qenies, në këtë kohë të ngarkuar me përplasje, ekstremizma, vrasje të njerëzve të pafajshëm. Jemi në gjendjen e jashtëzakonshme, të rrezikut të shtuar dhe të përhershëm, që tanimë i kanoset qenies njerëzore. Terrori, ose hallka e pare e tekstit, që e ka në fokus autori në këtë libër, jo rastësisht, është vetëmse murtaja e radhës, e cila e ka vënë në zgrip, individin dhe shoqërinë, me gjasë ekzistencën e qenies. Njeriu prej terrorizmit të shfrenuar, për çudinë e çudivë, është kthyer në armë të sofistikuar që vret, madje që asgjeson në masë, sidomos qenie të pafajshme njerëzore. Terrorizmi, me egërsi të paimagjinueshme, qëllon në turmë, godet me qetësi të frikshme, aty ku ka sa më shumë njerëz, duke u kthyer në një makth për jetët njerëzore. Romani “Terror e dashuri”, projektin rrethanat e zgripin ekzistencial, ku secili prej nesh, mundet të jetë vrasës apo viktimë. Teksa lexon romanin, vetiu të vjen në mend sugjerimi i Harold Bloom, kur shkruante: “Për të kuptuar më mirë obsesionin tonë me armët dhe dhunën, nevojën tonë fanatike për tu dashur nga Zoti, rrënjët tona gnostike (që i mohojmë haptazi, që na mësojnë shpëtimin nëpërmjet mëkateve...”¹, si një rrethanë me hy në natyrën komplekse të këtij libri. Përballë katrahurë së shterimit të mendjeve njerëzore, pushtuar më në fund nga marrëzia e shkatërrimit, streha e parë dhe e mbrame, që e ruan jetën, është dashuria.

Në kontekstin e leximit, të atmosferës së plotë të tekstit, vlen të silltet për lexuesin, pohimi: “Dhe për deri sa mungesa e humanizmit është pasojë e të mbajturit anë kështu që njerëzit u duken njerëzve të tjerë jo krijesa njerëzore, po pengesa për t’u kaluar dhe forca për t’u mposhtur, dhe nuk shihet tragjedia e përbashkët po është vetëm lufta e tanishme e disave kundër disa të tjerëve...”². Kjo ndjenjë e bukur, pra dashuria, që na sjellë në jetë, na ruan nga e keqja, nga kriminelët e gjithë ngjyrave, është ilaçi shpëtimtar, njëherit është ekulibër për të ruajtur jetën, vijimësinë ekezikistenciale të qenies. Dashuria e shumëfishtë, e nënës për birin, e gruas për burrin, e njeriut që e mbron njeriun, është limani që do ta ndal terrorizmin, e mbi të gjitha, dashuria pa kufi mbron jetën, është mesazhi thelbësor që shqipton teksti i këtij romani.

Terrorizmi si rrezik

Akti i vrasjes makabër, i të pafajshmëve, burra, gra dhe fëmijë, në mes të ditës, ka si aleat kryesor verbërinë, e individëve të ndryshëm, që kanë zgjedhur të vrasin në mes turmës, e pastaj të hedhin në erë veten, pra duke qenë kështu, dy herë vrasës të jetës. Situata e ndërlikuar, paraqitur në hapësirën tekstologjike të romanit “Terror e dashuri”, përmes përthyerjeve reale dhe imagjinare, tregon hapur, se njerëzimi në këtë kohë, ka përballë terrorizmin, pra një doktrinë vrasëse të qenies njerëzore. Terrorizmi i sotëm, mjerisht ka dalë në skenë, me gjasë si terrorizëm fetar islam, kur dihet që terrorizmi nuk ka ngjyrë as krahinë, është një çiban që herë pas herë e kaplon qenien njerëzore, qenie e kredhur në verbëri. Në fakt terrori i të çmendurëve, më shumë i atyre që kanë shkarë nga mendja, vetëmsa fshihet prapa fesë, me siguri është një lojë hipokrite me njeriun, me të ardhmen e tij. Besimi islam, ashtu si besimet e tjera, e ndalon vrasjen e të pafajshmëve, sidomos të grave dhe fëmijëve. Prandaj, terrori që e prekim përditëzaj, në rrugë, në supermakete, më së shumti yshtet, nga doktrina e terrorizmit, e vrasjes së tjetrit, duke u maskuar prapa besimit, prapa fesë.

¹ Harold Bloom: *Si dhe përse lexojmë*, Tiranë, Botimet Dudaj, 2008, f. 273.

² Benedetto Croce: *Poezia antike dhe moderne*, Tiranë, sh. b. elite, 1998, f. 35.

Shënime për romanin “Terror e dashuri” të autorit Shkëlzen Maraveci, botuar nga “Buzuku”, Prishtinë

MIDIS TERRIT DHE DASHURISË

Nga Behar Gjoka

Pamëdyshje, që jemi në një pikë të likshit të ekzistencës së njerëzimit, ky politika e mbrapshtë, me pafytyrësinë e vetë, ka vënë përballë, qytetërimet e ndryshme të botës. Shkrimtarët, simbas Hippolyte Taine: “... janë psikologë, dhe arrijnë të tregojnë jo vetëm të gjitha variacionet, por edhe të gjitha pasojat...”³Qytetërimi, pavarësisht se nga cila anë e horizontit shfaqet, është dritë bashkimi, është ura e komunikimit dhe lartësimit të vlerave humane. Pa qenë të lirë, nuk jemi të barabartë dhe anasjelltas, pa qenë të barabartë, nuk ka mundësi të jemi të lirë. Ajo që është e shenjtë për mua, nuk ka pse të jetë e tillë edhe për ty, porse e shenjta e secilit, do të duhet trajtuar me shenjtëri, me humanizëm, nga secili prej nesh.

Dialog i hapur me lexuesin


Teksti i romanit hapet me episodin befasues, “Përjetim i parrëfyer”, ku autori luan me rrëfimin, si akt ekzistencial i prozës, por nga ana tjetër, shënon një çast kulmor,

³ Hippolyte Taine: *Filozofia e artit*, Tiranë, Ideart, 2004, f. 155.

ku ka ndodhur batërdia, tmerrri dhe vdekja, ka pushtuar qendrën e madhe tregtare. Vdekja e zezë, ka pushtuar hapësirën, e nuk ka gjasë që të rrëfëhet, sepse nuk ka kush ta tregojë. Pamja fatale, me të vdekur të pafajshëm, të plagosur gjer në copëtim, që ndërkohë shërben si paratekst i episodeve të tjera, ku shtjellohen dy linjat kryesore, e terrorit dhe dashurisë, më solli ndërmend një sugjerim: “Romani nuk ekzaminon realitetin, por qenien. Dhe qenia nuk është ajo që ka ndodhur, ajo është hapësira e mundësisë njerëzore...”⁴ Ngjarje që flet dhe uluret, në të gjithë përmasat e veta, për tmerrin e shkaktuar, madje që nuk ka kurrëfarë nevojë që të rrëfëhet dhe, përsëri në fund të episodit, sugjeron dialogim me lexuesin, si shenjë e qartë e zhanrit të hapur, pra e romanit që vijon mbijetesën dhe formësim të pandërprerë të tipologjisë së prozës së gjatë.

Procedeu i dialogut të hapur, me lexuesin, një gjetje autoriale, rimerret edhe

⁴ Milan Kundera, *Arti i romanit*, Tiranë, Toena, 2001, f. 52.



në fund të romanit, te episodi përmbyllës, që madje në këtë rast përkon me zgjidhjen, pra me zbulimin e enigmës, se Abeli ishte pjesë e terroristëve, që mbi të gjitha me aktin tij, kishte gjymtuar të birin dhe gruan e tij. Në fund të tekstit të këtij romani, ka disa lutje të pazakonta, që i adresohen lexuesit, njeriut: “Zot i Madhërishtë, bëje që rasti i Abelit të jetë rasti i fundit terrorist në botë! I dashur lexues, thuaj edhe ti: AMIN a AMEN! S’ka rëndësi se si. Lutu për një botë më të mirë!”⁵, që pa doreza lëshon thirrje për njeriun, për vetëdijen e qenies, për ta zgjuar atë nga përgjumja e terrorizmit. Dialogu i hapur me lexuesin, i vendosur qysh në hapje të librit, si dhe e rimarrë në fund të romanit, në formën e lutjes, e klithmës, për të dalë nga ferri i shkatërrimit të vlerave humane. Dialogimi, krejt i hapur me lexuesin, shenjë se romani modern dhe postmodern, vetëmsa e ridimensionon romanin si zhanër i hapur, tregon se ky tekst, në tiparet formësuese, ecën në binarët e sendërgjimit postmodern. Po kaq, dialogjet hapës dhe përmbyllës, që vë pranë e pranë, ku të tre faktorët e gjallimit të letërsisë, autori-teksti-lexuesi, një trinitet ekzistencial i letërsisë, veçse tanimë lexuesi do të duhet gjurmuar, se gati po ikën në “drejtim të paditur”, bëjnë lidhjen organike të letërsisë.


Roman i grimcuar

Është fjala këtu për ndarjet strukturore, që përcillen në hapësirën e tekstit të romanit që ka vënë ballë përballë, dashurinë dhe terrorizmin. Romani “Terror e dashuri”, nis me pjesën parake, “Përjetim i parrëfyer”, në kuptimin që makabritetit i ngjarjes, mbytur në zyrtësi, e kredh në heshtje, fjalën dhe rrëfimtarin. Formalisht episodit paraprirës, mundet të kundrohet, me gjasë si një paratekst hipotetik, që ma tepër si nëntekst, lajmëron ngjarjet, që do të shtjellohen në faqet e romanit. Ndarja e madhe në pjesë, duket se bart esencën e thënies dhe të shenjë estetike, ku secila ka peshën e vetë:

Pjesa e parë, përbëhet nga pesë kapituj, të cilat janë shënuar me numra, dhe përbëjnë boshtin e parashtrimit romanor. Në këtë pjesë ngjet kthimi mbrapa në kohë, gjer te njohja me Abelin dhe konvertimi në myslimane e Zhaklinës, vajzës franceze, dy protagonistët e librit. Në tre kapituj, vihen përballë pasojat e aktit terrorist, me qindra të vrarë dhe të plagosur, me Amin e vogël, që qan me lot gjaku, e Zhaklina me trupin dhe shpirtin e copëtuar, që shpalon se si terrozrim e vret dashurinë. Kapitulli tjetër, rikthen kohën tjetër, kur jetonin dashurinë e madhe me Abelin.

Pjesa e dytë, ku janë përfshirë dhjetë kapituj, po ashtu të emërtuar me numra, një ngjarje tjetër, e cila dëshmon vatrat e frymëzimit të terrorizmit, e ndërfutur për të zgjeruar format e pranisë së vrasësve të jetës, që mbetet ngjarje më vete, me pikësynimin autorial, për të hetuar shpëtimin edhe në vatrat e krimit, e të dy ngjarjet lidhen nga ngjyresat e terrorizmit. Në këtë pjesë autori e fton lexuesin që të futet pilërisht në bastionet e terrorizmit, ku protagonist është Ahmadi, që ndërkaj ka një kurbë të habitshme, po edhe dinamike, si personazh,

⁵ Shkëlzen Maraveci, *Terror dhe dashuri*, Prishtinë, Buzuku, 2021, f. 161.



Ka vite e dekada që në diskursin tonë kritik, madje jo vetëm në shkrime në shtyp e periodik, por edhe në studime e libra me karakter monografik, haset një dysi në emërtimin e letërsisë sonë kombëtare: letërsi shqipe dhe letërsi shqiptare.

“Letërsi shqipe”, shkruan njëra palë, që konsideron se gjuha është përcaktuesi kryesor i letërsisë si art; “letërsi shqiptare”, thotë pala tjetër, që mëton se ky term e mbulon më mirë korpusin letrar shqiptar, përfshirë edhe veprat e shkruara në gjuhë të tjera, por nga autorë shqiptarë.

Si të mos na mjaftonin problemet reale që kemi në studimin e letërsisë sonë, në trajtimin e saj si një e tërë, pra në mënyrë integrale, posaçërisht të letërsisë bashkëkohore, ne i kemi krijuar vetes, me a pa dashje, një problem të paqenë: atë të emërtimit të dyfishtë: të saj (letërsi shqipe - letërsi shqiptare), me të cilin ndeshemi që në start.

Fjala është për një problem, në dukje të vogël, që meriton vëmendje dhe që kërkon, pse jo, edhe një zgjidhje.

Mirëpo, para se të merremi konkretisht me këtë problem, duke shfaqur, natyrisht, edhe qëndrimin tonë, le të shohim, shkurtimisht, si paraqitet ai në historiografinë letrare shqiptare.

Në të kaluarën manuale të letërsisë shqipe kanë botuar kryesisht të huajt ose edhe ndonjë autor arbëresh që për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare ka shkruar në italisht.¹

At Justin Rrota botoi në vitin 1925 studimin me titull *Letratyra shqype*, që konsiderohet si prova e parë e një historie të letërsisë shqipe. Në vitet dyzet, doli në Tiranë libri në formë krestomacie *Shkrimtarët shqiptarë I, II*,² me autorë Namik Resulin, Ernest Koliqin dhe Karl Gurakuqin, të cilët në titull e shmangin përcaktorin “letërsi shqipe”, duke e zëvendësuar me “shkrimtarë shqiptarë”, por në brendi edhe ata, sikurse Rrota, përdornin trajtën “letratyra shqipe”.

Edhe Xhuvani, Cipo e Çabej përdorin këtë trajtë, me një ndryshim të vogël fonetik: literaturë.³ (Termi “letërsi” ka hyrë në përdorim kryesisht pas Luftës së Dytë Botërore; më përpara përdorej trajta “letratyrë/ literaturë”).

Edhe në dy tekstet shkollore të Shuteriqit: *Histori e letërsisë shqipe* dhe *Antologji e letërsisë shqipe* për shkollat e mesme, të botuara në vitin 1955, përdoret termi “letërsi shqipe” e jo “letërsi shqiptare”.

Por vepra kryesore, që krijoi për herë të parë një pamje më të plotë të zhvillimit historik të letërsisë shqipe nga dokumentet e para të gjuhës shqipe deri në prag të Luftës së Dytë Botërore është libri në dy vëllime *Historia e letërsisë shqipe I-II*, i botuar në Tiranë në vitet 1959-1960 si tekst universitar.⁴ Me pak ndryshime, kryesisht të natyrës politike, ky libër u ribotua edhe në Prishtinë (1969), duke shërbyer deri vonë si tekst bazë për studimin e letërsisë shqipe të traditës nga nxënësit e shkollave të larta dhe të fakulteteve, sikurse edhe nga mësimdhënësit e tyre.

Siç mund të shihet qartë qysh në titull, në këtë vepër, të krijuar kryesisht nën mbikëqyrjen e studiuesit të njohur të trashëgimisë sonë letrare e shpirtërore, prof. Dhimitër S. Shuteriqit, letërsisa jonë kombëtare cilësohet me përcaktorin “letërsi shqipe”.

Nga kjo kohë e deri në fillim të viteve ’80 të shekullit të kaluar, në ligjërimin kritik shqip, me gojë dhe me shkrim, është përdorur termi “letërsi shqipe”, që nuk

¹ Gaetano Pettrrota, *Popolo, lingua e letteratura albanese*, Palermo 1931. Ky libër në shqip është botuar nën titullin *Populli, gjuha dhe letërsia shqiptare* (përktheu Qemal Velija), Tiranë 2008.

² Vëllimi i parë i këtij libri doli në vitin 1941, kurse i dyti më 1942.

³ Eqrem Çabej, *Elemente të gjuhësisë e të literaturës shqipe* (1936) dhe *Për gjenezën e literaturës shqipe* (1939).

⁴ Si bashkautorë të këtij libri shfaqen, pos Shuteriqit, edhe Koço Bihiku, Mahir Domi, Vehbi Bala, Ziaudin Kodra dhe Zihni Sako.

“LETËRSI SHOQIPE” APO “LETËRSI SHOQIPTARE”?

Nga Agim Vinca



kontestohej nga askush.

Kalimi nga “letërsi shqipe” në “letërsi shqiptare” ndodh në vitin 1983, në kohën e ideologjizimit të theksuar të shoqërisë shqiptare dhe, rrjedhimisht, edhe të mendimit shkencor. Atë vit doli nga shtypi, si botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe i Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, vepra *Histori e letërsisë shqiptare* (që nga fillimet e deri te Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare), e bazuar, si thuhet në parathënie, “në mendimin shkencor të PPSH-së” dhe në “metodologjinë marksiste-leniniste”, hartimi i së cilës kishte filluar vite më parë dhe kishte qarkulluar “në formë maketi nga viti 1976”.⁵ Vepra në fjalë, ç’është e vërteta, sillte “disa fakte të reja letrare” dhe saktësonte disa gjëra në krahasim me pararendësen e saj, por interpretimi që i bëhej procesit letrar dhe vetë krijimtarisë ishte tejet i ngushtë, restriktiv dhe dogmatik.

Qasja e tillë vërehet edhe në trajtimin e shkrimtarëve të pakontestuar si De Rada, Dara i Ri, Serembe, Naim e Sami Frashëri, Çajupi, Mjeda, Asdreni, Noli, Migjeni e të tjerë, por merr përmasa groteske kundruall autorëve “të anatemuar” për shkaqe politike.

Për ta konkretizuar këtë pohim, po përmendim disa të dhëna. Fishtës në këtë vepër i kushtohen gjithsej 21 rreshta; Konicës 17 e gjysmë. Aspak më mirë nuk kalon as autori i madh arbëresh Zef Skiroi; Koliqi vetëm sa përmendet dy herë në kontekst negativ; Lumo Skendo gjithashtu. Lasgushit nuk i kushtohet kapitull më vete, por trajtohet bashkë me poetë të tjerë të viteve ’20-’30, sikurse edhe Kuteli, të cilit i jepet shumë më pak vend se Foqion Postolit e Haki Stërmillit, kurse asnjëri nga dy autorët pogradecarë nuk jepet me fotografi; Konicës i shënohet gabimisht viti i vdekjes (1941 në vend se 1942), kurse Migjeni dërgohet në shkollim jo në Manastir, por “në Bitolje”(!) dhe, për më keq, flitet edhe për “popullsinë shqiptare të Bitoljes”.⁶

Por, t’i kthehemi temës.

Në parathënieën e kësaj vepre nuk thuhej asnjë fjalë për përdorimin e togfjalëshit “letërsi shqiptare” në vend të atij të mëparshmit “letërsi shqipe” dhe për arsyeshmërinë e këtij veprimi. Autorët e tekstit në fjalë nuk marrin mundimin të thonë as edhe një fjalë të vetme për këtë “risi”. Ndoshta ngaqë pak vjet më parë ky term qe përdorur edhe në tekstin po ashtu akademik *Historia e letërsisë shqiptare* të

realizmit socialist (1978), duke u bërë kështu term “zyrtar”.

As pas ndryshimeve politike të viteve nëntëdhjetë, kur ra censura, për çudi, nuk do të flitet për këtë çështje, ndërkohë që emërtimi i periudhës socrealiste “letërsi shqiptare” do të bëhej pothuajse i zakonshëm jo vetëm në Tiranë, por, aty-këtu, edhe në Prishtinë.

I pari dhe, madje, edhe i vetmi që do ta trajtojë këtë problem, shumë vjet më vonë, është pedagogu i Universitetit të Tiranës dhe njëri nga autorët e tekstit të ’83-shit, Ali Xhiku. Në artikullin e tij *Histori e letërsisë shqipe apo histori e letërsisë shqiptare*, të botuar në revistën “Perla” të fondacionit iranien “Shirazi” në vitin 2009,⁷ duke mbrojtur pikëpamjen e përdorimit të termit “letërsi shqiptare”, ky autor pohon se “autorët dhe redaktorët e tekstit të vitit 1983 (mes tyre edhe hartuesi i këtyre radhëve), parapëlqyen këtë të fundit (përcaktorin shqiptare), ngaqë menduan se ç’kishin botuar shkrimtarët shqiptarë në gjuhë të huaja nuk duhej lënë jashtë historisë së kombit të tyre”.⁸ Si shembuj, profesor Xhiku përmend romanin *Bardha e Temalit* të Pashko Vasës, dramën *Besa* të Sami Frashërit, përmbledhjen *Ëndërrimet* të Naimit dhe ndonjë vepër tjetër të shkruar në frëngjisht, turqisht, persisht, greqisht dhe italisht. Ky është argumenti kryesor. Argument tjetër janë humanistët shqiptarë (Barleti me shokë), të cilët shkruan, në latinisht e italisht, vepra që nuk mund të quhen beletristikë e mirëfilltë.

Ndër të tjera, autori i artikullit në fjalë, Ali Xhiku, pohon se historianët iranienë kanë të drejtë të interesohen për *Tehajjulat* e Naimit, kurse ata turq për *Besën* e Samiut dhe për ta mbështetur këtë konstatim shkruan: “Askush nuk mund të qortojë historinë e letërsisë frënge se mban për shkrimtarë të vetët romancierin Anri Truaja, që ishte rus për nga kombësia dhe dramaturgun Ezhen Jonesko, që ishte rumun. Ata i shkruan veprat e tyre në frëngjisht dhe kjo mjafton për t’i përfshirë në historinë e letërsisë frënge dhe jo gjetkë”.⁹

Mirëpo, analogjia nuk është e plotë dhe as e qëndrueshme. Emri i të parit, “romancierit Anri Truaja” (Henry Troyat), mezi përmendet në historinë e letërsisë frënge, ku konkurrenca është shumë e madhe,¹⁰ kurse “dramaturgu Jonesko”,

⁷ Shih artikullin *Histori e letërsisë shqipe apo histori e letërsisë shqiptare*, botuar te revista “Perla” (Tiranë), nr. 2, 2009, f. 39.

⁸ Po aty.

⁹ Po aty, f. 40.

¹⁰ Në veprën *Histoire descriptive de la littérature contemporaine française* me autor Maurice Bruzière-

sikurse edhe shumë shkrimtarë të tjerë të shquar (nga Apolineri e Beketi e deri te Emil Siorani e Romen Gari), që, pavarësisht nga origjina, kanë krijuar në gjuhën frënge (shumica syresh edhe kanë jetuar në Francë, kryesisht në Paris), zë vend nderi në letërsinë dhe kulturën franceze. Fundja, Franca është shtet hegjemon letrar, që asimilon talente nga mbarë bota, sikundër edhe letërsitë e tjera të mëdha (angleze, amerikane, ruse, gjermane etj.), deri edhe letërsia serbe ka jo pak shkrimtarë me origjinë joserbe: hebreje (Oskar Daviço, Danillo Kishi, Filip Davidi), rumune (poeti i shquar Vasko Popa) etj. Shqiptarët, për shkak të kushteve historike në të cilat kanë jetuar, nuk kanë pasur mundësi të përvetësojnë krijues të përkatësive të tjera, por i kanë dhënë botës jo pak figura të shquara në fusha të ndryshme të artit dhe të shkencës.

Përfashtimi i shkrimtarëve që kanë shkruar në gjuhë të tjera nga historia e letërsisë kombëtare, do ta varfëronte traditën e saj,¹¹ nënvizon autori i artikullit *Letërsi shqipe apo letërsia shqiptare*, zoti Ali Xhiku, mirëpo në librin e tij *Sprovë për një histori tjetër të letërsisë shqipe* (vini re: shqipe! – A. V.),¹² nuk e përfshin atë, çka do të thotë se ndërkohë ka reflektuar dhe ka hequr dorë nga termi që e kishte miratuar dikur (më 1983), bashkë me të tjerë, dhe e kish mbrojtur më 2009-tën.

Libri *Histori e letërsisë shqiptare* (që nga fillimet e deri te Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare, 1983), është hartuar nga (emrat e autorëve po i japim ashtu siç janë dhënë në libër): Prof. Vehbi Bala, Doc. Razi Brahimi, Kand. i shk. fil. Klara Kodra, Doc. Ali Xhiku, Shaban Çollaku, nën drejtimin e Prof. Dhimitër S. Shuteriqit, redaktuar nga: Prof. Dh. S. Shuteriqi (Kryeredaktor), Prof. Mahir Domi, Dr. Jorgo Bullo, Prof. V. Bala, Doc. R. Brahimi. (Kjo listë e gjatë emrash ta kujton shprehjen: “Shumë kuzhinierë, gjella pa shije!”).

Edhe pse në titull përdor përcaktorin “shqiptare”, shqiptarësia e kësaj vepre lë shumë për të dëshiruar. Se është kështu, mjafton të rikujtojmë gafën kur për Migjenin flitet se u dërgua për shkollim “në Bitolje” (në vend se në Manastir - ndërhyrja ime, A. V.) dhe sidomos kapitullin për Sami Frashërin, që mbyllet me fjalinë: “*Figura dhe vepra e Sami Frashërit* gëzojnë nderim të lartë në atdheun socialist”.¹³ Po tani që atdheu nuk është më “socialist”, po “kapitalist”, ç’ndodh me figurën dhe veprën e Sami Frashërit?! (Ka edhe shembuj të tjerë, por edhe këta që përmendëm besoj se mjaftojnë).

Afërsisht në të njëjtën kohë me *Historinë e letërsisë shqiptare* të Akademisë së Shkencave të RPS të Shqipërisë (1983), në Prishtinë botohet vepra *Historia e letërsisë shqipe, Romantizmi I-III* e akademik Rexhep Qosjes, dy vëllimet e para të së cilës dolën në vitin 1984, kurse i treti dy vjet më vonë (1986). Ndërkaq, në vitin 1995, në Nju-Jork, botohet libri *History of Albanian Literature* i Robert Elsie-t, i cili në gjuhën shqipe do të dalë nën titullin *Histori e letërsisë shqiptare*.¹⁴ Përkthyesi i kësaj vepre, Abdurrahim Myftiu (bashkautor i *Historisë së letërsisë shqiptare të realizmit socialist*), është përcaktuar për trajtën “letërsi shqiptare” e jo “letërsi shqipe” konform praktikës institucionale të ndjekur në Shqipëri, edhe pse vetë autori i librit, Robert Elsi, kur shkruan shqip ose i përkthen vetë shkrimet e tij nga anglishtja, përdor trajtën “letërsi shqipe”.

Kjo tregon se dualizmi: “letërsi shqipe-letërsi shqiptare” vazhdon edhe pas vitit

in, një libër i gjerë në dy vëllime me rreth një mijë faqe, botuar në Paris në vitin 1975-1976, emri i këtij shkrimtari përmendet vetëm një herë (vëllimi II, f. 309), por nuk thuhet asnjë fjalë për të dhe veprën e tij.

¹¹ Vepra si *Ëndërrime, Bardha e Temalit, Besa* etj., falë përkthimit në gjuhën shqipe dhe receptimit nga lexuesit e kritika letrare, por edhe tematikës së tyre (dy të fundit) janë bërë pjesë e sistemit letrar shqiptar.

¹² Ali Xhiku, *Sprovë për një histori tjetër të letërsisë shqipe 1555-1944*, Albas, Tiranë 2014.

¹³ *Histori e letërsisë shqiptare* (që nga fillimet e deri te Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare), f. 175.

¹⁴ Robert Elsie, *Histori e letërsisë shqiptare*. Përktheu nga anglishtja: Abdurrahim Myftiu. “Dukagjini”, Tiranë – Pejë, 1997.

1990 dhe nuk ka marrë fund as sot, duke krijuar kështu pa nevojë një konfuzion në studimet tona letare.

Përfundim

Duam s’duam, dualizmi “letërsi shqipe -letërsi shqiptare” paraqet një problem për shkencën tonë të letërsisë, problem që, me sa di, nuk shfaqet në letërsitë e tjera ballkanike dhe evropiane.¹⁵

Letërsi shqipe apo letërsi shqiptare? Histori e letërsisë shqipe apo histori e letërsisë shqiptare?

Përdorimi paralel i këtyre dy trajtave jo vetëm në vepra autoriale, por edhe në ato prapa të cilave qëndrojnë institucione shkencore të rangut më të lartë, nuk u bën nder studimeve tona letrare dhe as albanologjisë në përgjithësi.

Meqenëse gjuha është faktori kryesor i përcaktimit të përkatësisë së një letërsie, termi “letërsi shqipe” më duket më i drejtë dhe më i natyrshëm. (Letërsi shqipe është ajo që shkruhet në gjuhën shqipe, nga vetë shqiptarët, por edhe nga të tjerët, nëse ka të tillë. Ky është rregulli, të tjerat janë përjashtime). Ashtu siç duket e panatyrshme shprehja “gjuhë shqiptare” (e përdorur ndonjëherë në poezi për shkak të rimës),¹⁶ po aq e panatyrshme, në të vërtetë e sforcuar, tingëllon edhe shprehja “letërsi shqiptare”.

Ata që insistojnë për përdorimin e kësaj trajte, janë viktimë e një lloj “paranoje” dhe e ndikimit të ndonjë autoriteti, ndër të cilët nga kolegët e mi në Fakultet kam dëgjuar të përmendet shpesh emri i Çabejt.¹⁷ Shuteriqi, Qosja, Arshi Pipa, tre autoritete të studimeve tona historiko-letrare, të tri punkteve kryesore (Shqipëri, Kosovë, Diasporë) dhe, pak a shumë, edhe të proveniencave të ndryshme kulturore, përdorin termin “letërsi shqipe” (Shuteriqi në shkrimet autoriale). Njësoj veprojnë, me ndonjë përjashtim, edhe studiuesit që mund të quhen vazhdues të përvojës së tyre në këtë fushë.

Edhe nga pikëpamja e traditës ky term është më pranë së vërtetës.¹⁸ Teksti i parë i historisë së letërsisë shqipe i hartuar nga vetë shqiptarët, *Historia e letërsisë shqipe I-II*, i ‘59-‘60-s, i hartuar në një klimë pak më liberale se ajo që do të pasonte më vonë, mund të na shërbejë si pikë referimi, por jo edhe *Historia e letërsisë shqiptare* (që nga fillimet e deri te Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare) e ’83-shit, hartimi i së cilës filloi në kohën (pas Plenumit IV të KQ të PPSH), kur çdo gjë bëhej me diktat dhe imponim.

Natyrshëm shtrohet pyetja: a kemi ne shqiptarët si komb, a ka kultura jonë kombëtare, një paradigmë të studimeve historiko-letrare? Pa dashur të mohojmë kurrsesi kontributin e të tjerëve, të një plejade të tërë studiuesish, në Tiranë e Prishtinë, por edhe në qendrat e tjera albanologjike, brenda dhe jashtë, që me punën e tyre e kanë pasuruar mendimin tonë kritik, nuk mund të mos përmendim në këtë rast, emrin e doajenit të studimeve historiko-letrare ndër ne, Rexhep Qosjes. Letërsia shqipe ka qenë me fat që ka pasur një studiues me vizion të qartë historik

¹⁵ Është vendi të theksohet këtu se studiuesit e huaj, ndryshe nga ne studiuesit shqiptarë, nuk e kanë këtë problem, sepse në gjuhët e tjera nocionet letërsi *shqipe* dhe *shqiptare*, nuk kanë asnjë dallim: Albanian Literature (në anglisht), La littérature albanaise (në frëngjisht), Letteratura albanese (në italisht), albanska književnost (në serbokroatisht), albanskata literatura (në maqedonisht) etj. E konsideroj fatlume këtë rrethanë dhe mirë që është kështu, sepse e kundërta do të ishte komprometuese për studimet shqiptare dhe bartësit e tyre.

¹⁶ Kjo trajtë haset te vjersha *Gjuha shqype* e Fishtës, jo në titull, siç mund të shihet, por në njërin nga vargjet, për shkak të rimës: “*Porsi vala e bregut t’detit,/ Porsi gjâma e rrËfës zgjetare,/ Porsi ushlima e njëj tërmetit,/ Njashtë â’ gjuha e jonë shqyptare*”. (Mrizi i Zânavet, Tiranë 1924, f. 5).

¹⁷ Teza e doktoratës e Çabejt, e mbrojtur në Grac të Austrisë më 1933 dhe e botuar më vonë në Shqipëri, titullohet *Për gjenezën e literaturës shqipe* (1939).

¹⁸ Konica shkruante: *Kohëtore Letrave Shqipe*, “Albania” nr. 5, 1906. Kuteli gjithashtu te *Shënime letrare* (1944).

dhe me mundësi të mëdha krijuese, i cili, duke përfituar nga përvoja e parendësve të tij, por edhe nga përvoja e të tjerëve në Ballkan dhe më gjerë, e ngriti në një nivel më të lartë mendimin kritik shqiptar. Vepra si *Kontinuitete* (1972), *Shkrimtarë dhe periudha* (1975), *Prej tipologjisë deri te periodizimi* (1979), *Nocione të reja albanologjike* (1983), monografitë për Asdrenin (*Asdreni, jeta dhe vepra e tij*) dhe Naimin (*Porosia e madhe*),vepra *Tri mënyra të shkrimit shqip* (2004) dhe në mënyrë të veçantë *Historia e letërsisë shqipe, Romantizmi I-III*, janë gurë themeli në godinën e historisë së letërsisë shqipe. E bazuar në parimet e shkencës moderne të letërsisë, kjo vepër është, siç është thënë, një “sintezë e madhe historiko-letrare”¹⁹ e njëjërës nga periudhat më të rëndësishme të letërsisë shqipe - Romantizmit.

Edhe pse situata e krijuar në Kosovë në gjysmën e dytë të viteve ‘80 të shekullit të kaluar dhe sidomos në dekadën vijuese, por edhe riorientimi i autorit kah krijimtaria imagjinative (romani), e penguan realizimin e projektit të madh të një Historie të plotë të Letërsisë Shqipe nga fillimet e saj e deri më sot, të paralajmëruar në parathënien e *Historisë së letërsisë shqipe të Romantizmit*, kjo vepër mund të shërbejë si një gjedhe e sintezave të ngjashme edhe për periudhat e tjera të letërsisë shqipe. Në vëllimin e parë të kësaj vepre (*Poetika*), shpjegohet edhe çështja e, si thuhet, “shumëgjuhësisë romantike” dhe arsyet që i shtynë romantikët tanë t’i shkruanin disa nga veprat e veta në gjuhë të tjera, kurse në dy vëllimet e tjera trajtohet në formë monografike krijimtaria e shkrimtarëve romantikë, përfshirë edhe veprat e tyre të shkruara në gjuhë të tjera (italisht, greqisht, turqisht, persisht dhe frëngjisht), të cilat autori i quan “fakte historiko-letrare” të letërsisë shqipe.²⁰

Ç’mund të themi në fund të kësaj kumtese? Cili është qëllimi im? Duke u përcaktuar për këtë temë, autori i kësaj kumtese synon jo vetëm ta riaktualizojë edhe një herë çështjen e praktikës dyshe: “letërsi shqipe” - “letërsi shqiptare”,²¹ por edhe t’u bëjë thirrje kolegëve të mi studiues të letërsisë, kudo që janë, për të arritur një pajtueshmëri në emërtimin e njësuar (unik) të letërsisë sonë kombëtare, nëse jo edhe një zgjidhje përfundimtare. Konsideroj se shanset për ta jetësuar këtë synim janë më të mëdha sot (sa janë ende në jetë disa nga etërit themelvënës të historisë së letërsisë shqipe) se ç’mund të jenë nesër.

Meqenëse gjuha është shenja kryesore që dallon përkatësinë e çdo letërsie, atëherë besoj se pajtohemi që letërsinë e krijuar në gjuhën shqipe ta quajmë “letërsi shqipe”, por pa i përjashtuar prej saj as ato pak vepra të krijuara në gjuhë të tjera, të cilat, falë përkhimit në gjuhën shqipe dhe receptimit nga lexuesit dhe kritika letrare, janë bërë pjesë e sistemit letrar shqiptar.²² Përveç kësaj, këto vepra janë pak (relativisht pak) dhe përfaqësojnë një përqindje të vogël në kuadër të korpusit letrar, prandaj nuk mund ta cenojnë kurrsesi kriterin themelor të artit letrar, atë gjuhësor.

(Tekst i paraqitur si kumtesë në konferencën shkencore të mbajtur me rastin e 70-vjetorit të themelimit të Institutit Albanologjik të Prishtinës, Prishtinë, Qershor 2023)

¹⁹ Bajram Krasniqi, *Sinteza historike letrare e romantizmit*, në librin *Kode të ligjëritimit letrar*, Rilindja, Prishtinë 1988, f. 174-175.

²⁰ Po aty, f. 81.

²¹ Në Programin e Konferecës pashë titullin e kumtesës së kolegut Kristaq Jorgo: *E shkuara në të ardhmen e studimeve mbi letërsinë shqip(tar)e*, ku përdorimi i kllapave ka funksionin e leximit alternativ të termit: *shqipe / shqiptare*.

²² *Tehajlat*, fjala vjen, falë shqipërimit të orientalistit të njohur dhe njohësit të shkëlqyer të stilit dhe botëkuptimit të Naimit, Vexhi Buharasë, tingëllon si të ishte shkruar shqip. (Një shembull tjetër i këtij lloji është edhe poema *Zotit* e Serembes, e shkruar italisht dhe e përkthyer në mënyrë të shkëlqyer në shqip nga poeti Xhevahir Spahiu).

(Vijon nga faqja 9)

nga kriminel, në njeri normal, që në një kuptim duket si kapërcim ylberi, pra linja e ndryshimit, në syrin dhe shijen time, vjen paksa i sforcuar. Në kapitullin katër, kemi një ndryshim, sepse në këto episode ka edhe emërtime (Gjashtë muaj me vonë), te pesa (Një vit e gjysmë me vonë), te shtata (Dy vjet e gjysmë më vonë), që realisht dinamizon rrafshet kohore dhe ligjërimore.

Pjesa e tretë e librit, në të cilën janë vendosur dhjetë kapituj, ku tanimë ngjet rikthimin te ngjarja kryesore, pasojat e shkaktuara nga akti terrorist, si dhe përpjekjet e Zhaklinës-Hatixhes, për ta gjetur me çdo kusht Abelin, për të zbuluar enigmën e paimagjinueshme, se ai ishte njëri nga tre terroristët, që bënë gjëmën e tmerrshme në supermarket. Në kapitullin dhjetë, përveç numrit, ka edhe përcaktimin (Dy muaj më vonë).

Pra, nga ana strukturore, ky roman është i ndarë në tri pjesë, njëzet e pesë kapituj, plus teksti parapritës, duke parashtruar gjendjen e pazakontë. Ndarjet e mëdha, e sidomos ndarjet më të vogla, në kapituj, të japin dorë, që në pikëpamje strukturore, ky roman është koncpetuar si i grimcuar, pavarësisht densitetit të pranishëm. Ndërkaq, në këtë roman kapitujt janë relativisht të shkurtër, madje lexohen dhe receptohen më tepër si tregimthe, në kuptimin që episodet, kanë edhe një jetë më vete. Ndërlidhjen e tyre, pra episode koncize, janë pjesë unike e romanit, e mundësojnë ngjarjet, si dhe rruga evolutive e personazheve.

Narrativa e personazheve

Episodi paraprirës “Përjetim i parrëfyer”, ka si narrator Abelin, që në gjendje sonambuli, tregon tmerrin që ndjeu, kur niset për te qendra tregtare, duke portretizuar vetvenen si natyrë komplekse, deri pak çaste se sa hodhi veten në erë. Përcjellja e kësaj atmosfere, tepër të ngjeshur: “Ishin çastet e fundit të jetës sime, trupi më dridhej e më kërcente, rrahjet e shpejta e të fuqishme të zemrës po ma shqyenin gjoksin.”⁶, si një shpalosje e pazakontë e gjendjes ku ka rënë personazhi, një analizë e hollë psikologjike, e një terroristi, para aktit të hedhjes në erë, të supermarketit, të mbushur me njerëz dhe vetën.

Në pesë kapitujt e Pjesës së parë, si narrator është Zhaklina, që tregon e llahtarisur për tmerrin e përjetuar, nga shpërthimi i frikshëm, që solli pasoja te djali dhe vetë ajo. Shqetësimi i parë, padyshim që është Amin, vogëlushi disamujor, si dhe fati i mikes Fatimas. Me ankh dhe sqimë të papame, rrëfehen prej saj, çastet kur është shtruar në spital. Dëshmimi i saj tronditës: “Unë besimtare e konvertuar nga e krishterë në myslimane, Abeli, mysliman me prejardhje nga Maroku, por lindur e rritur në Francë”⁷, që zbulon epokën, ku hapja e shoqërisë, është shoqëruar me ngritjen e mureve për tjetrin, të ndryshimit, edhe mundet që të banojë te dera përballë. Është tregues i situatës së e jetës, ku tanimë janë ndërthurur kombet, besimet, racat, gjë që është e prekshme në Francë dhe në kontinentin europian.

Pjesa e dytë, e cila përbëhet nga dhjetë kapituj, kemi të plasuar një ngjarje tjetër, me gjasë një kthim prapa, si retrospektivë e rrokshme, të futur në hapësirën tekstologjike, ka tanimë si narrator Ahmadin. Vetërrëfimi i bëmave, kur sillej si kriminel, kur vidhte dhe dhunonte njerëzit, kur vriste pa iu dridhur qerpiku, ndërrimi i vendbanimit, nga Marseja në rrethinat e Parisit, të bën përshtypje kurba evoluese si karakter, që për më tepër e prezanton si një personazh i ndërlikuar. Komplexiteti i kalimit nga pjesa e botës së krimit, në një njeri krejt normal dhe, madje me vlera humane të dëshmuara, pavarësisht gjurmëve të ndryshme që barten te kjo figurë, diçka mbetet në zgrip, që lëviz nga njëri skaj në tjetrin, varësisht qëllimeve të autorit, ndërkohë që është thelluar në botën e brendshme, në fatin e hidhur të familjes. Sugjerimi domethënës: “...na mbyll në kufijtë e një bote dhe na udhëheq, në një farë mënyre, kah imponim që këtë ta marrim seriozisht...”⁸, një sugjerim për të hyrë në marrëdhënie me realitetin e trilluar, që bart letërsia, sidomos në aspektin strukturor dhe komponues. Spektri i figurimit të personazhit, që rrëfen vetë, nga një kriminel i rrezikshëm, në njeri të rregulltë, e shtrirë në dhjetë kapituj, ku dashuria e nënës, dhimbja e madhe për fatin e të jatit, gjithsesi kanë ndikuar, sadopak për ta zbutur bishën, një mundësi reale, që edhe ligësia mund të frenohet, nga rrethanat dhe forca e karakterit. Shprehja e personazhit: “Kurrë nuk më kishte pëlqyer mjekroshi që ndikonte në radikalizimin e të rinjëve.”⁹, ku autori rreket që të depërtojë në botën e brendshme të personazhit.

Pjesa e tretë e roman, në të dhjetë kapitujtë, ka si narrator Zhakinën, e cila me fjalët e veta, realizon portretizimin, veçmas thellon dhe përplotëson analizën psikologjike, si dhe është pushtuar nga makthi për të gjetur Abelin. Peripecitë e kaluara, duke e kërkuar në Marok, vegimet e përjetuara rrugëve të Parisit, në kërkim të tij, marrin përgjigje të papritur, kur policia i tregoi pjesët e copëtuara të trupit të Abelit, dhe sidomos letra e tij, e cila paraqitet në faqen e fundit të romanit. Narrativa e personazhit, me fillimin prej Abelit, me peshën kryesore të zbulimit të botës romanore, nga ana e Zhaklinës, me praninë e përfillshme të Ahmadit, si narrator, autori ka krijuar distance e nevojshme, sikur ka hyrë në hije, kur në fakt vetja e tij, shenja autoriale, është e mishëruar, nga pak në secilin prej narratorëve, ndonëse formalisht, pothuajse është i munguar.

Rileximi i tekstit

Prej një rrethane rastësore, romanin “Terror dhe dashuri”, të Shkëlzen Maravecit, përveç leximit të parë, i “detyruar”, kaloi edhe në procesin e rileximit. Nëse leximi i parë, një lexim gati matematikor, për të realizuar përveçimin, ka mbetur pas. Rileximi, tashmë në distancë kohore, është një akt i leximit real të një teksti, një shans tjetër, gjithnjë me hetu vlerat dhe mungesat, e pashmangshme gati në secilin libër. Rileximi, tekefundit, është prova e “Zjarrit”, nëpër të cilën kalon letërsia, krijimtaria e një autori, si dhe secili tekst letrar. Në spektrin e dy leximeve, sidomos të rileximit të thelluar, romani “Terror dhe dashuri”, e leximit të parë, gati rufe, dhe rileximit më të distancuar, gjurmues të shenjave estetike, në jo pak tregues shkrimor, në syrin tim, e ka “kaluar Rubikonin”. Trajtimi i temës së terrorizmit, majft aktuale dhe tepër e rëndësishme, e përballëvënë me dashurinë, shqipton shestimet autoriale, si shqetësimet i kohës së ngarkuar me luftë, përplasje dhe terrorizëm. Larmia e narrativës, me disa narratorë, pamëdyshje narrativa përmban tharmin e prozës, ka ngjyrosur tekstin me kolor tronditës,e po kaq konkret. Po ashtu, struktura e romanit, marrëdhënie ma fjalën, që kërkon mendjen dhe zemrën, pra të njeriut dhe lexuesit, janë tregues të profilit të një prozatori, që anësohet nga vetëdija e shkrimit, e cila lëshohet në kërkim të vetëdijës së leximit, si një akt që dëshmon praninë e shenjave letrare.

⁶ Shkëlzen Maraveci: *Terror dhe dashuri*, Prishtinë, Buzuku, 2021, f. 161.

⁷ Po aty, f. 13.

⁸ Umberto Eco, *Gjashtë udhëtime narrative*, Shkup, Asdreni, 1997, f. 149.

⁹ Shkëlzen Maraveci: *Terror dhe dashuri*, Prishtinë, Buzuku, 2021, f. 87.

Një i vdekur shpallet në kërkim

Pasi e qanë ditën e parë në Mireshe, Baltazar Ketën e përcollën me të gjitha shartet e mortit atje, ku “venë e s’kthehen”. Krejt tjetër punë, mandej, ajo, çudia e çudivë, se si pas gjashtë ditësh Baltazari la bosh arkëmortin e vet në varrezë dhe u arratis “në drejtim të paditur”, siç shpalli njoftimi zyrtar i Drejtorisë Rajonale të Policisë së Afratit. Brenda të njëjtit njoftim, policia e shpallte të arratisurin “në kërkim”, por pa sqaruar për çfarë veprë penale kërkohet.

Buja e këtij lajmi u shua brenda dytri ditësh, mbase edhe për shkak të protestave politike, të cilat sapo kishin përfshirë kryeqytetin, fill pas masakrës së zgjedhjeve të përgjithshme. “Duhet të ketë qenë ndonjë ‘i skeduar’ herët nga organet e drejtësisë për ‘rekorde kriminale’”, - thuhej nëpër kafenetë e kryeqytetit, që zienin si zgjoje me gazetarë ato ditë, sidomos në pikat e grumbullimit të tyre që e përbënin asokohe një grusht kioskas të parkut “Rinia”. Gazetarët e vjetër, kryeredaktorë e shefa redaksish, shtjellonin nëpër tavolina versionet e veta para vajzave e djemve, shumica rishtarë në gazetari. Mandej këto versione tavolinash mbushnin studiot televizive dhe faqet e kronikave të gazetave të përditshme.

Mbrëmjen e asaj dite që u shpall në kërkim Baltazari ndoqa emisionin special “Rebus” në “Antena Top”, të cilin dikur e kisha drejtuar vetë. Kishte disa opinionistë në studio dhe si gjithmonë, të gjithëdijshtë siç janë, ndonëse në fillim shpallnin me modesti “nuk jam ekspert i kësaj fushe...”, nuk ngurronin, mandej, ta shtjellonin ngjarjen me detaje aq të imëta, a thua kishin qenë të vetmit dëshmitarë të saj. Madje Fili, njëri nga ish-kolegët e mi, u ndal gjatë në përshkrimin e njëfarë pusulle të koduar, të cilën, sipas tij, kryebanditi i Afratit ia kishte lënë Policisë, bash në vendin ku qe pandehur se vdiq.

- Pusulla, - po thoshte ai, - ende nuk është deshifruar plotësisht, por nga burimet e mia të brendshme “konfidenciale”, di që ekspertët e kriminalistikës ia kanë dalë të hetojnë në tekst njëfarë “parimi palindromik”.

- Që do të thotë...? - e mbajti pyetjen pezull drejtuesja e emisionit.

- Palindromia është një mënyrë e kriptuar shkrimi, e cila lexohet njëllë si nga e djathta në të majtë dhe anasjelltas, para dhe mbrapsht. Kuptimi nuk ndryshon.

- E pastaj? Ç’ka këtu për t’u “dekriptuar”, nëse kuptimi u lexuaka njëllë si para dhe mbrapsht? - pyeti një nga të ftuarit.

- Ka, ka, sepse... - u mendua një hop ish-kolegu im, - sepse, parimit të palindromisë i shtohet dhe *akrostich*-i.

- Ja ku na doli tani edhe një fjalë tjetër e panjohur, - u hodh drejtuesja, - po kjo, çgjë na qenka?

- Akrostich-i? Ah, po kaq duhet ta kishit mësuar që në gjimnaz, zonja Sindi, - buzëqeshi kinse i zhgënjyer ish-kolegu im, mandej shpjegoi me një zë të ëmbël e të ngadaltë, si t’u drejtohej fëmijëve të një kopshti: - Mjafton të lexoni vertikalisht shkronjat nistore të çdo rreshti dhe ja ku e keni dhe akrostich-in. Shpesh ky lloj

Agron Tufa

ARRATIA E FUNDIT E BALTAZAR KETËS

Fragment nga romani

Romani i fundit i shkrimtarit Agron Tufa, “Arratia e fundit e Baltazar Ketës”, është një roman-baladë, një roman-mit, me heronj plot ëndrra të bukura e të sëmura, që rravgojnë drejt së pamundurës, midis një realiteti dhe sfondi shoqëror depresiv.

Romani ngërthen një rrëfim dinamik në rrafshin e së tashmes, që është i determinuar nga e shkuara dhe e ardhmja. Shtjella e pasioneve njerëzore me misterin e vazhdueshëm, deri në fjalën e fundit, përplas dy prirje të kundërta: njëri, sipas një vektori fizik, synon idealin e lumturisë tokësore dhe tjetri, një vektor i qartë metafizik, synon lartësitë, dehjen dhe ngazëllimin qiellor.

Diskurset e shumta filozofike, etike dhe shoqërore, që përvijohen natyrshëm përgjatë fabulës së magjishme të rrëfimit dhe stilit të zhdërvjellët, e bëjnë këtë roman një tekst sugjestionues, që lexohet me një frymë.

leximi nxjerr në pah një emër njeriu, një vend apo një koncept.

Në studio kishte edhe një palë tjetër gazetarësh disi më realistë; ndonjëri kishte dëshmuar, herë pas here, njëfarë shkalle të pamohueshme pavarësie. Ata po ngulnin këmbë se “arratisja” e një

të vdekuri s’ishte gjë tjetër, përpos se një nga ato truket dhe sajatat e trasha, marrëzisht të paskrupullta, që bënë çdo pushtet qeveritar në krizë për të shpërqendruar vëmendjen e protestave publike. Por shtjellimin e këtij versioni Sindi e ndërpreu disi vrazhdë, me

përligjen e një hapësire publicitare.

Kur emisioni rifilloi, Sindi tashmë kishte shtruar për diskutim një çështje tjetër: “A ka qenë i vdekuri i arratisur një ‘i vdekur’ dhe nëse po, a është e drejtë të shpallet në kërkim?” Ajo ia kaloi fjalën Andreas, një tjetër kolegu të vjetër, me të cilin kisha punuar disa vite. Andrea ka pasur gjithmonë një nuhatje të habitshme për t’ua qëlluar gjërave në kokë, mjafton t’i jepje qoftë dhe një detaj.

- A e dini, zonjë, përse e bënë këtë Policia jonë e nderuar?

Heshtje në studio. Në pritje që t’i përgjigjej vetë pyetjes, Andrea, tok me harkun e ngritur të vetullës kaleshe, ia kishte ngulur sytë e picërruar ekranit të dekoltesë së Sindit, të hapur aq fort, sa vetëm thimthat e gjinjve mbeteshin ende të mbuluar. Bashkë me harkun e vetullës kaleshe, ai mbante të ngritur me dy gishta në nivelin e mjekrës një stilolaps të hollë, elegant, gjithë vezullime të florinjta.

- Atëherë, çprisni, pse s’na e thoni? - i tha drejtuesja me një buzëqeshje cytëse.

Andrea e lëshoi papritmas traun vezullues të stilolapsit dhe dha përgjigjen që kishte mbllaçitur gjatë:

- Sepse Policia, zonja ime e dashur, ka dështuar disa herë në kapjen e shumëkërkuar të këtij kryebanditi, emrin e të cilit po e mësojmë vetëm tani, falë këtyre rrethanave, që për shumëkënd janë sa të çuditshme, aq dhe të pabesueshme. Dhe për t’iu përgjigjur pyetjes suaj “A është e drejtë të shpallet në kërkim një i vdekur?” po, them unë, është e drejtë! Meqë arrestimin e tij për së gjalli e ndërpreu vdekja, tani, me të braktisur statusin e të vdekurit, ai, ligjërisht, duhet të ndiqet, si çdo i gjallë tjetër, për t’iu dorëzuar drejtësisë.

Me këto arsytetime qenë mbushur edhe komentet kilometrike që shoqëronin lajmin e arratisjes së Baltazar Ketës në versionet *online* të gazetave të përditshme, linqet e të cilave sot, në pjesën dërrmuese, nuk hapen, për shkak të falimentimit të tyre.

Arsytetime të tjera të ngjashme mund të jenë shtuar edhe më vonë, por unë nuk u mora më me lajmet mbi Baltazarin.

Gjahu im, i gjallë apo i vdekur

Jam munduar të kuptoj diçka, përtej përligjes së protestave politike që eklipsuan krejt lajmin e pazakontë mbi ngjalljen dhe arratisjen e Baltazar Ketës. Por, nëse e reduktoj vlerën time në skajin e vet të modestisë, atëherë nuk ngurroj të them se nuk isha aq i papërvogë, as dhe aq i panjohur si gazetar, sa të kënaqesha me shpjegime të përcipta, shpesh edhe të porositura, me atë lloj pluhuri, pra, që të verbon reflekset dhe të pudros intuitën. Me fjalë të tjera, jo aq sa të mbeteshia i kënaqur me çka na servirin studiot televizive apo Policia jonë.

Pyetja që i pata shtruar vetes asokohe kishte të bënte me dyshimin tim tronditës: mos vallë shoqëria jonë, e bombarduar vazhdimisht me lajme të bujshme nga mëngjesi në darkë, rrallëherë të vërteta e, madje, shpesh të sajara me porosi nga lart, ka pushuar tashmë së na besuari? Mos vallë membrana e ndjeshme dhe drithëruese e besimit të kësaj shoqërie është mpirë, është drunuar dhe se kjo mpirje do të priste, tash e tutje, me



të njëjtën shpërfillje, si arratinë e një të vdekuri, po aq dhe përmbytjen e përbotshme? Në qoftë kështu, atëherë zbehja e shpejtë dhe shpërfillja e lajmit mbi arratisjen e Baltazar Ketës nga varri i vet shënon fillimin e një epoke tjetër, ku të vërtetat që ne gazetarët ofrojmë janë të dënuara me shpërfillje. Besimi im te misioni fisnik i ndërmjetësimit të shoqërisë përmes informimit me faktet dhe të vërtetat do të lëkundej, derisa të rrënohej krejt.

Po kush ma ka fajin, përderisa edhe vetë isha një nga protagonistët e përbindshëm të fshehjes, manipulimit dhe zhdukjes së fakteve?

Mes trazirave të protestave dhe acarimit publik, lajmi mbi të vdekurin e arratisur u pagëzua që të nesërmen një “pordhë syfyri”. Analisti, një burrë në moshë, strabik e kokëshogë, duke u shprehur me këtë epitët, shënoi (falë reputacionit të madh në publik) zbehjen dhe frasjen përfundimtare të lajmeve mbi Baltazarin. Me sytë gapërr e çatrafilas kah teleshikuesi, analisti u shpreh prerë e qartë se “kjo ‘komedi e zezë’ që po na vihet në skenë, pikërisht tani ka vetëm e vetëm një qëllimin: që unë dhe kolegët e mi t’i shmangemi përballjes me të keqen e madhe të manipulimit të votës së lirë dhe të degradojmë në atë nivel vulgar e qesharak, sa të molloisim si plakut gjernjare për histori me fantazma. E kuptoni tani se çfarë u pjell truri këtyre?”

Vdekja përfundimtare e lajmeve mbi arratinë e Baltazarit qe dita e tretë, kur në të gjitha ekranet u shfaq para gazetarëve shefi i Drejtorisë së Policisë Rajonale të Afratit. Ai nuk e mohoi lajmin, por pastroi amullinë që pati shoqëruar atë gjatë atyre ditëve. Riosh, buçko faqequq, disi i druajtur në fillim, ai e përballoi këtë pikë të publicitetit në ekrane duke pozuar vetëm në profilin majtas (siç u mor vesh më vonë, për shkak të faqes së tij të djathtë të djegur me vaj të nxehtë gjatë një sherri në kuzhinë me vëllezërit e tij që nga vitet e fëmijërisë).

Kameramanët ia respektuan këtë kërkesë, andaj e filmonin vetëm majtas, në profil. Thelbi i deklaratave të tij ka gjasë t’i kujtohet lexuesit. Ndonjë kureshtar i veçantë mund ta gjejë zgjedhimin e kësaj vakie në koleksionin vjetor të gazetave të përditshme (tashmë të falimentuara të gjitha), në secilën bibliotekë lokale të qyteteve tona, me përjashtim të Bibliotekës Kombëtare e cila, siç e dimë, pësoi njëherë zjarrin, mandej përmbytjen, duke lënë të padëmtuar vetëm fondin e botimeve të diktaturës. “Ç’zjarr i zgjuar! Pale ç’përmbytje e mençur na paska qenë!” - ironizonin asokohe në redaksinë tonë.

Gjithsesi, thelbi i deklaratës së shefit të policisë para gazetarëve më ka mbetur ende i freskët në kujtesë. Kam përshtypjen se e quanin se Metush Topuzi, se Metish Tonuzi, por jam i sigurt për ato pak fjalë që tha, siç më janë gdhendur pikë për pikë në kujtesë:

“Ne përgatitëm një operacion urgjent të koduar ‘Hija’. Pistat e dyshimit janë tre: e para, grabitje kufome (për shkak të njëfarë vlere që kishin veshjet e të ndjerit); e dyta, hakmarrje (e hamendësuar) përmes grabitjes së kufomës, për ta dhunuar, me gjasë, dikund tjetër, ose për ta varrosur në ndonjë vend sekret; në fund fare, e treta,



që, për mendimin tim, përbën një pistë më të përmbajtur, sipas së cilës i ndjeri mund të ketë kaluar të ashtuquajturën “vdekje fiktive”. Ka fort gjasa që ai të ketë kaluar një komë të përkohshme (siç po hamendësojnë tash për tash ekspertët e komisionit mjekoligjor), për njëfarë kome të tipit të veçantë, prej së cilës i pandehuri është përmendur. Sipas ekspertëve mjekoligjorë, statistikat nuk e përjashtojnë këtë gjasë. E nëse qëndron ky version, atëherë na duhet të nxitojmë, madje shfrytëzoj rastin t’i kërkojmë ndihmë popullatës së Mireshit dhe zonës përreth, sepse gjendja psiko-fiziologjike e të ndjerit në kërkim nuk mund ta ketë shtyrë atë fort larg varrezës, çdo minutë që kalon përbën rrezik për shëndetin e tij të dobët. Siç e dini, kërkimi ynë paraprak në terren me operacionin ‘Hija’ nuk na dha rezultat. Çështjen tani e ka marrë në dorë vetë Prokuroria e Qarkut dhe së shpejti një grup hetimor, në bashkëpunim të ngushtë me Policinë Rajonale, do të nisë operacionin ‘Krehri’, tashmë me ndihmën e qenve specialë që i presim të na vijnë nga Shkolla e Qenve të kryeqytetit. Kaq kisha dhe ju lutem njerëzisht zonjave dhe zotërinjve gazetarë: lërinin policinë dhe prokurorinë të bëjnë hetimet e tyre.”

Qarkullonin fjalë midis kolegësh se vetë ministri i Rendit e kishte marrë në telefon këtë Metushin apo Metishin dhe i kishte bërë titull: “Nëse nuk jeni në gjendje të kapni një të arratisur të vdekur, më mirë dorëzoni kapelat dhe merruni me një zanat tjetër. Si do të përligjeni para qytetarëve, kur s’jeni në gjendje të kapni një të vdekur? Atëherë, si do t’i kapim të gjallët?”

Por ditët e para kaluan. Metush Topuzi apo Metish Tonuzi nuk e kapi të arratisurin e varrezës së Mireshit. Në raportimet zyrtare që kam parë më vonë, ai njoftonte rregullisht për “rënien në gjurmë” të të arratisurit dhe madje, për “lokalizimin” e vendit të tij të strehimit. Kjo mund të shpjegojë arsyen se pse ministri i Rendit nuk e detyroi shefin e Policisë së Afratit të dorëzonte kapelën.

Kështu, pak nga pak (madje më shpejt

nga ç’pritej), lajmi u përpëliti këndeve të ndonjë gazete lokale, derisa dha shpirt. U shua, u harrua, siç shuhen e harrohen kësoane edhe çuditë me të mëdha në botën e vdekatarëve. Kur edhe jehona e shkurtër e lajmit mbi arratisjen e Baltazarit nga varri qe zhdavartur për fare, atëherë pata unë tërë kohën dhe qetësinë e duhur për t’i shkuar ngjarjes, siç i shkova, deri ku munda.

Sepse Baltazar Keta, i gjallë apo i vdekur, ishte gjahu im.

Liria s’ka pasur e s’ka pikë vlere për ju!

Brenda Kafes së Madhe, buzë shëtitores kryesore të Shehrit, kryeqendrës së Afratit, ushtonte zëri monoton i Palokë Pishës, ish-mësuesit tonë të letërsisë në gjimnaz. Ishte një monolog me zë të lartë, që sa vinte e ngrihej, mbase për shkak se askush nuk i përgjigjej. Nuk e di në kishte pirë mësues Paloka, por fjalët e qarta, ecja e tij e sigurt midis tavolinave të kafenesë, të mbushura atë ditë plot me sheherlinj të dëshpëruar opozitarë, nuk të jepte kurrfarë shkaku ta quaje të dehur.

E mbaja mend shtatlartë, të thantë, me pak flokë si kashtë gruri mbi një kafkë paksa të tërhequr nga mbrapa, mu si ca ekrane kompjuterash të vjetër. Ishte pothuaj ashtu, veçse tash qe ligur, qe kërrusur, kurrizi i qe kukëzuar disi, flokët i kishte po ata, por të zbardhur borë, ndërsa fytyra e eshtërt me mollëza të kërcyera i nxirrte më në pah gollet e errëta të syve. Sa kisha zënë vend në një tavolinë nga fundi dhe e pata vështirë jo vetëm ta kuptoja prej sa kohësh po fliste, por, kryesorja, kujt i drejtohej në veçanti. Me sa duket, askujt. Të gjithë e dëgjonin, por i shmangeshin kryqëzimit të vështrimeve me të. Unë, përkundrazi, u mundova t’i ndesh sytë e tij të hirtë brenda zgavrave, por ai as që ma vari; spicat i kishte, me ç’dukej, me të vetët, me ndonjë të partisë së opozitës aty në kafene:

“...Na bëjnë namin, pale. Na kanë vjedhur, thonë. Ju kanë vjedhur? Ja ku po jua them, pra, mirë jua kanë bërë!

Unë detyrën time si qytetar i lirë e kam bërë, zotëri, nuk arriti të më korruptojë kush. Kam dalë, kam votuar, përkundër kërcënimeve, dhe çfarë pastaj? Unë dola, votova, bëra detyrën time, por ti, ti pse s’ma garanton aktin tim të vullnetit të lirë? Ç’kuptim ka të dal prapë, kur nuk je në gjendje ta mbrosh votën time? Ti, atëherë, as që e meriton atë. Se është njësoj, more zotërinj, është njësoj sikur unë të të jap vajzën për grua. Vajzën, po them, që e kam si sytë e ballit. Por ja që ti s’je i zoti t’i mbrosh nderin! Vjen halabaku, harbuti, skuthi i skuthave dhe ta përdhunon. Kështu, zotërinj, është vota! Pse s’më shihni në sy? Epo, ngrije, pra, kokën, ti, që na frymëzoje të votojmë kundër kësaj diktature oligarkike! Ja, votuam. E çfarë? Ç’presh opozite na qenke ti? Pse nuk jep dorëheqje? Pse nuk hap krahun? Le të vijë një më i zoti, një mishngrënës zotëri, jo barngrënës si puna jote. Na qaheni te qeveria! Hëm, qeveria atë do, të ta fusë. Blerje na thoni! Me para droge shtëpi më shtëpi. Po, more, po, kush nuk e di këtë. Me furgonë kanë qarkulluar anembanë Afratit shpërndarësit e parave të drogës. Kush ka dashur të shitet, ka shkuar vetë, vullnetarisht. Është ngutur, madje, të mos ia kalojë shoku e komshiu, se, kushedi, mos mbarohen paret e nuk mbetet më gjë për të. Atëherë? Keni ndonjë ide ju, kryeshinikët e opozitës? Pse të votojmë prapë për ju? Hë, more, fol, ngrije kokën, më shih një herë në sy, se ma ke borxh, të kam dhënë votën! Ç’bëre ti me të? Pse kaloi ajo te kundërshtari?”

Askush nuk e ngriti kokën, përpos nënqeshjeve e ndonjë zgërdheshjeje.

Në fund, mësuesi stërhell hodhi një vështrim të trishtë e të neveritur mbi gjindjen e Kafes së Madhe, mblodhi buzët shuk dhe tha: “Hani e pini, lepuj e buçe! Liria s’ka pasur e s’ka pikë vlere për ju!”

Kur figura e tij hollake doli e shihej përmes qelqnajës, si po largohej shëtitores, tek ecte fillikat, kafeneja, deri atëherë e heshtur, zhurmoi papritur me një luzmë zërash, tingujsh e cijatjesh, a thua se dikush kishte ngritur papritur deri në fund zërin e një radioje të prishur.

DITA E KADRI CAKRANIT NË SHTETIN ILLINOIS NË SHBA

Në Shtetin e Illinois-it në SHBA, guvernori i tij JB Pritzker me anë të një proklamate shpalli për komandantin shqiptar në Luftën e Dytë Botërore “Ditën e Kadri Cakranit”, ku renditen bëmat e tij sa heroike dhe humane si shpëtimi i qendra hebrejve në Shqipëri nga përndjekja e pushtuesve nazistë, shpëtimi i infermiereve të ushtrisë amerikane, etj, emri i të cilit është tani që nga muzeumi “Solomon” i qytetit të Beratit, ne muzeume në botë të holokaustit në Aushvic, në memoriale të mëdha në SHBA, Izrael, etj.

Dita e Kadri Cakranit, 11 nëntori, do të shoqërohej me veprimtari universitare, duke kujtuar se 35 pasardhës të tij punojnë, jetojnë apo shkollohen në Shtetin e Illinosit.

Në Tiranë është avokati I njohur Kujtim Cakrani.

Komandand i Ballit Kombëtar, Kadri Cakrani, mbi të gjitha komandant shqiptar, ushtarak karriere, patriot dhe humanist në kohë të vështira, diti të vështrojë edhe në kaosin e luftës nga ana e duhur e historisë, nga Perëndimi, ai erdhi emigrant politik në SHBA jo vetëm për t'i shpëtuar përndjekjes së diktaturës komuniste, por dhe për ta vazhduar misionin atdhetar. Ndërkaq ai la memoriet e tij, një libër të shkëlqyer, “Të vërtetat e jetës time”, dëshmi dhe shkoqitje të historisë, një monument, akademi dhe katedër, me rëndësi për të njohur dhe kuptuar konfliktin e të vërtetave, kohën si të shkuar, pasuri e të ardhmes.

Libri është botim i “Onufrit”, doli në 2020 nën kujdesin e avokat Kujtim Cakranit, ndërsa një nga parathëniet është e shkrimtarit Visar Zhiti, që po e sjellim të plotë.

Besojmë dhe themi që Atdheu është si një familje e madhe, po kështu ka dhe familje të mëdha që janë si atdheu. Që mbartin fatin e tij, nga drama e përjetësisë së tij, që marrin dhe japin nga identiteti i përbashkët nëpër kohëra, nga himni dhe ajo hijeshi ideale, e patjetërsueshme. Familja dhe Atdheu bëhen njësh me jetët e tyre dhe punën, me përkjekjet dhe pagën dhe më shumë me luftën dhe vdekjet, me fitoret e vështira dhe ato humbje që farkëtuan bashkë me qëndresën dhe ndërgjegjen kolektive, gjithë antropologjinë, ngjarjet, karakteret, vetë lavdinë e kombit duke paraprirë ardhmërinë, e cila bëhet e tashme, duke shtuar përvojën dhe pasi ikën e shumta si çdo e shkuar, lë dhe histori dhe mbetet si truall. Por dhe si frymë. Si legjendë. Antike dhe moderne.

Familja e madhe Cakrani është një histori e gjallë e Shqipërisë së pavarur, tashmë dhe e shkruar mrekullisht, që përfshin dy shekujt e fundit, kapërcimin e shekullit XIX bashkë me robërinë e gjatë dhe të rëndë otomane dhe zë të gjithë shekullin XX, me pavarësinë dhe konfliktet ballkanike me armë, Luftën e Parë Botërore, Kongresin e Lushnjës si pavarësi e dytë e Shqipërisë, pushtimin fashist dhe Luftën e Dytë Botërore, fitimtarët dhe vendosjen e diktaturës së tyre, më të egrën në vendin më të vogël në të gjithë perandorinë komuniste dhe ikjet prej saj.

Familja Cakrani është kështu dhe një rrënjë e futur thellë, që përshkon nëpër Perandorinë Otomane dhe përhumb në atë Bizantine. Si e tillë, kjo familje e njohur feudale ka patur dhe fatin e rrënjës, e mbetur nëntokë, ushqimdhënëse, por dhe me trugje të prera përsipër, në harresën e re vrasare. Por siç arriti ta parashikonte dhe njëri nga personazhet e shumtë të këtij libri memoaristik, politikani dhe shkrimtari i ikur Ernest Koliqi në dramën e tij “Rrajët lëvizin”, do të vinte dhe koha e një kujtese tjetër, e një ringjalljeje shpirtërore, ku bashkë me vlerat dhe virtytet do të çrroposeshin dhe emrat e atyre që punuan “për Shqipëri”, duke shkruar jo vetëm pasuritë, por edhe jetët, duke vënë në shërbim nnderin dhe fatin.

LIBRI I KIJTESËS

Pas librit befasues dhe i një rëndësie të shumfishtë, “Kujtimet e një firmëtarit”, nga Hajredin Bej Cakrani, ndërkaq dhe dokumet historik, që mungonte për kohën e shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, madje dhe i vlerave gjuhësore në rrëfimin shqip në toskërisht dhe pa mbaruar habia mbi këtë zbulim, ja, tani del dhe libri i të birit, Kadri Cakrani, “Të vërtetat e luftës sime”, që përfshin vazhdimin, jetën e tij e të familjes dhe të Atdheut, të ndërthurura bashkë si një e tërë. Ashtu siç i mori detyrat



dhe përgjegjësitë atje ku e la i ati, me ndjesitë e një misioni të lartë, me përkushtimin e birit, pasi bëri luftëtarin e atdheut, me karakterin dhe mendësitë tipike ballkanike, por sidomos ato shqiptare, ku përzihen virtyti dhe veset, pasi iku në mërgimin e detyruar, në Perëndimin e kulturuar, në fund bëri dhe një akt, nga ato prej europiani, perëndimori, la kujtimet, që i quan të vërtetat e tij, por që po aq, janë të vërtetat e shqiptarëve dhe të vetë Shqipërisë. “Shqiptarët bëjnë shumë, por shkruajnë pak”, - thoshte Dora D’Istria, shkrimtarja me origjinë shqiptare, ndër gratë më të kulturura në Europë në kohën e saj. Por ja, që pas saj Cakranët e paskëshin thyer këtë çkujdesje atavike, konservatorizëm i padobishëm, jo një, por dy herë, nga ati dhe biri.

Edhe dalja e kujtimeve të Kadri Cakranit i ngjan një arkeologjie, që nuk zbulon, si të thuash veç vende, - ngjarjet nisin në vendlindjen e autorit, në Mallakastër, ku kishin domenin, “Republikën Cakrani”, vazhdojnë në Berat, ku kishin dhe aty shtëpi të madhe dhe autori shërbeu si Kryekomandant i Ballit Kombëtar, por dhe në Austri më parë, ku ai u shkollua në Akademinë

Ushtarake Tereziane, vazhdimet, lufta dhe ikja e detyruar më në fund, në Itali, ende më larg, në Siri, dhe përtej oqeanit në SHBA, sikur i largohej një të keqeje, por jo kacafytjes me të. Por në këto kujtime zbulohet më e rëndëshimja, zbulohet kohë, sa vetanake, po aq dhe e përbashkët, kohë familjare dhe mbretërore, kohë për të bërë kohën, dhe vjen koha e pushtimit nazi-fashist, e luftës civile, siç e quan autori atë midis partizanëve nën udhëheqjen e Partisë Komuniste dhe Ballit Kombëtar nën udhëheqjen e pinjollëve të familjeve të mëdha, ku ai bën pjesë si themelues dhe prijëtar, mundja e atyre që duhej të fitonin dhe fitorja e atyre që duhej të humbnin, etj, por duhej kohë tjetër që të përmbysjej përmbysja, goftë dhe si një realitet tjetër, dhe autori i këtij libri e shpalos si një realitet moral. Libri është i të vërtetave të Kadri Cakranit, rrëfim dhe qortime, për të tjerët dhe i asaj që i përkiste, por dhe ndaj vetes, që duhej të kishin bërë më shumë, por dhe ndryshe, i bindur në rrugën e tij dhe në drejtësinë e saj, me një sinqeritet të ashpër, ushtarak siç dhe ishte, që ndërsa zbatonte parimet e Organizatës së tij për një luftë kundër pushtuesit me sa më



pak gjakderdhje, vetë shpërthente si hero, me moton dhe dalldinë që vrasësit duhen vrarë dhe s’e lëshoi armën kurrë nga dora, që natyrisht e përdori me pasion. E rëndësishme është që të vërtetat e Kadri Cakranit, më themeloret, shtyjnë disa të vërteta të tjera, që kishin zënë vend me dhunë dhe ishin zyrtarizuar, sipas atij ligjit që historinë e shkruajnë fitimtarët. Diktatura me historianët e saj ribëri një të kaluar ashtu siç do të donte ajo të kishte qenë, mbivendosi një realitet tjetër, por krimi gjithsesi mbeti në thelb... Nga Kadri Cakrani tani na vjen një tjetër realitet i po asaj kohe, i besueshëm mes pabesive, por dhe i natyrshëm, në natyrën e tij, kur po denatyroheshin koha dhe shqiptarët.

“Të vërtetat e jetës time” kthehet në të vërtetat e jetës së atdheut. Libri të tërheq dhe si një “roman”, ku çdo ngjashmëri me ngjarje dhe njerëz realë nuk është e rastësishme, por qëllim. Nis me fëmëninë në atë familje të madhe, sarajet, lojrat, futbollit, pastaj lojrat e mëdha të njerëzimit, lufta, Ballkani, Europa, bota, kthehet prapë në atdhe, ndarjet, konfliktet, takimet politike në oda burrash dhe sheshet me njerëz, jeta aristokratike, hipodromi, fushat e tenisit që ata kishin dhe ku, në Mallakstrën e atëhershme, shëtitjet me kuaj, me djem dhe vajza, të ardhur dhe nga jashtë vendit, shokët dhe miqtë e tyre. Hajredin Bej Cakrani me të vëllanë, Bekash bej Cakrani, ishin bashkëpunëtorë të Ismail Qemalit, shpallësit të Pavarësisë, e kishin mbajtur në sarajet e tyre në ato ditë dhe kishin ikur bashkë me qerre nëpër baltën e kohës të themelonin shtetin e ri shqiptar në Vlorë, kur njëri vëlla do të ishte firmëtar dhe tjetri ministër, i cili jo vetëm nuk merrte pagë për punën, por paguante administratën nga arka e shtëpisë së tij.

Në vitet e Kongresit historik të Lushnjës, ku ishin pjesëmarrës, krahas halleve, ra nëpër Europë dhe ajo që u quajt “Gripi Spanjoll” dhe “Vëllezërit Cakrani” krijuan fondacionin e parë shqiptar, duke iu gjendur popullit me ndihma dhe mbështetje, veshmbathje dhe barna, duke e kthyer konakun e tyre në spital. Bijtë e familjes Cakrani i ishin përkushtuar dhe dijes, duhet të bëheshin për atdheun ashtu siç ai priste: mbrojtës të tij, ekonomistë, agronomë, mjekë, juristë, diplomatë, politikanë, etj, dhe ishin shpërndarë nëpër universitete të famshme, në Vjenë e Paris, Romë, e Berlin, por dhe në Rumani e Poloni e Hungari, etj. dhe, nëse do të duhej, të merrnin armët në dorë sërisht, ishin dhe luftëtarë.

Motra e autorit të këtij libri, Suhade Cakrani, vajza e vetme e Hajredin Beut, që na përshfaqet paksa si një përndritje vetëtime. studionte në Firencen mahnitëse të Dantes, të Mikelandhelos e Makiavelit, etj, të atyre që udhëhoqën Rilindjes Europiane. Po për çfarë studionte ajo? Për mjekësi, financë, shkencë? Jo, për Artet e Bukura, ashtu siç ishte dhe vetë. Se atdheut do t’i duhej dhe art, kulturë, që të bëhej sa më i bukur. Por dhe rebelimi. Kadriu do të burgosej si kundërshtar i Mbretit Zog, por dhe në burg ai do të ishte aq i hijshëm, me shokët, me borsalina e kravata e këpucët që i shkëlqenin.

Duke ndjekur rrjedhën e kujtimeve të “Princit”, siç i pëlqente ta quanin Kadri Cakranin, zbulojmë më shumë Ballkan, absurd, ku fitorja është dhe humbje dhe i munduri mund te jete firimtari, dhe, “kur monarkitë ktheheshin në republikë, Republika e Shqipërisë bëhet monarki, - thotë autori me një buzagaz të hidhur dhe përshkruan një Shqipëri kaotike, “ku atentatet u bënë si moda sot”. Mes saj është dhe ai. Protagonist. Jeta bashkohet me historinë. Konfliktet botërore mbërrijnë dhe në Mallakastër. Njësitet partizane, - tregon autori,- shpesh bënin punën e bandave dhe merrnin po përgjigje të tilla. Me armë. I biri i Shehut - partizan, i biri i Hajredin beut - ballist. Ndarje që u thellua gjithnjë e më tepër në fshat, në krahinë, në qytete, në Shqipëri. Dhe në botë. Berlini ishte ndarë më dysh, me mur në mes. Marrëveshja e shqiptarëve në Mukje u tradhtua nga komunistët. Nacionalistët nuk donin vëllavrasjen, siç e quanin hapur autori. Po ajo erdhi dhe e deshi udhëheqja e komunistëve, me saktë Enveri që ishte nën tutelën e jugosllavëve, dy misionarë të së cilës ishin në shtabin e lartë si mbështetës a këshilltarë, por në fakt ata drejtonin dhe qëllim ishte marrja e pushtetit nga ana e tyre në një Shqipëri pa Kosovën, të cilat pushtuesi i kishte bashkuar. Pas lufte plani ishte që dhe Shqipëria e gjithë të bëhej një nga republikat e Federatës Jugosllave, ndërsa nacionalistët, Balli Kombëtar, në organizatën plulariste të cilëve lider ishin bijtë e Frashërlinjve dhe të familjeve të tjera të mëdha, pra dhe të Cakrajve, dhe profesorë - patriotë të sprovuar, qëllim ishte Shqipëria, mëvetësia e saj

e humbur, prosperiteti demokratik si në botën Perëndimore, duke u shtuar kështu dhe çështja tjetër, aq shumë kritike dhe shqetësuese, jo Shqipëri komuniste. Lufta midis dy të vërtetave ashtu si mes dy të drejtave bëhet gjithnjë e më e ashpër ashtu siç dhe janë lufrat civile.

PATJETËR DHE LETËRSI

“Të vërtetat e luftës sime” në arritjet më të mira është shkruar dhe si letërsi dhe patjetër nëpër faqet e tij do të gjenim dhe biseda tërheqëse për letërsinë dhe artet. Duke qenë kohë lufte, ato ndjehen dhe janë pjesë e qëndresës dhe e mbrojtjes. Në fillim ndeshim se ç’thonë mes tyre etërit Cakrani, kur njëri vëlla mbështeste filozofinë e Samiut dhe tjetri poezinë e Naimit, por nuk bëhet shteti me poezi, ia kthente njëri, po bëhet ndërgjegjia, ngulmonte tjetri. Pra duket sikur po kërkohet një strategji veprimi si strategjitë në luftë. Ndërsa bijtë, Kadri Cakrani, ushtarak profesionist, do të debatonte për letërsinë europiane me profesor Abaz Ermenjin, i pari liste për superioritetin e letërsisë gjermane e i dyti për atë franceze, jo pa tension. etj, etj. Edhe tek biseda e tyre duket sikur po kërkohet aleati më i fortë dhe kjo nis nga kultura. Por atë që s’e prishi dot lufta, do ta shkatërronte diktatura e fitimtarëve pas luftës. Dhe në mërgimin e autorit në SHBA, ka përsëri përsiatje për letërsinë, aty nga faqet e fundit të librit, kujton Borhertin, Heminguejin, Remarkun dhe Bël-in që e ai i pëlqen, por letërsia shqipe sot nuk lexohet dot, thotë, e ka fjalën për Realizmin Socialist, por çuditërisht ka pikasur një libër ndryshe, që jep shpresë, “Gjeneralin e ushtrisë së vdekur”. Si ushtarak e ka tërhequr dhe tema dhe fundi, i ngjashëm me veprën e tyre. Si ideolog ai te letërsia sheh gjendjen shpirtërore të një populli dhe shpresën për të ardhmen, nëse do të ketë...

Kadri Cakrani
VAZHDIME ME VEPRA

Por le t’u kthehemi çështjeve të luftës, që zotërojnë librin. Me Kadri Cakranin bindim gjithnjë e më shumë se komunistët kërkonin të arrinin qëllimin me çdo çmim, idealin e tyre, qoftë dhe me terror, me vrasje, pabesi dhe ndaj të vetëve, deri dhe bashkëpunim me pushtuesin, gjë që dihej fare pak ose aspak dhe fshihej nga historiografia zyrtare, kur trumbetohej e kundërta. Ndërsa Ballit Kombëtar, na tregon Kadri Cakrani, duket se i interesonte njeriu, jeta dhe fati i çdo njeriu, qoftë dhe i huaj ky, të cilët së bashku përbëjnë Atdheun. Janë të shkëlqyera aktet e humanizmit dhe të guximit të madh që na tregon Kadri Cakrani. Hebrejnë të Beratit, rreth 450 familje, te vjetra dhe të reja, të sapo ardhura nga përndjekja në shtetet përreth, do të shpëtoheshin nën kujdesin e tij, duke u dhënë të gjithëve pasaporta shqiptare, nëpër Mallkastër, në tokat e tyre, tani nën kujdesin e xhaxhait, Bektashit. Letërkëmbimi midis tyre tashmë është në muzeumet e Holokaustit në Izrael. Akti human më i madh në Ballkan. Frika ishte se partizanët mund ta dekonspironin këtë aksion tek gjermanët, për të krijuar terror e panik e ta shfrytëzonin për fitoren e tyre. Me qeverinë e Mustafa Krujës u bë ajo që nuk ishte bërë dot në vende më të mëdha, më të fuqishme e më të kulturuar, mbrojtja e hebrenjve, duke mos dorëzuar asnjërin te nazi-fashistët dhe në fund të luftës në Shqipëri, “në atdheun e dytë të hebrenjve” kishte dyfishin e tyre. Kadri Cakranit, por sidomos të birit të Bektash beut, Kujtim Cakranit, ashtu si gjithë popullit iu hap dhe një punë tjetër e vështirë, shpëtimi i mijra ushtarëve italianë pas kapitullimit të Italisë Fashiste, se ata kërcënoheshin nga pushtuesi gjerman si dezertorë dhe nga partizanët si pushtues, pavarësisht se një pjesë e tyre më pas, me urdhër nga aleatët, u hodh të luftonte bashkë me partizanët. Shqipëria bëri atë që s’e kishte bërë kush në botë, ushtrisë që kishte ardhur si pushtuese, pasi u mund, ushtarëve të braktisur të saj u dha bukë dhe strehë, mbi 25 mijë bij dhe i përcolli si vëllezër. Është biblike që armiqtë t’i kthesh në vëllezër.

Përsëri Kadri Cakrani, nga Kryekomandant i Ballit Kombëtar, do ta gjejmë në aksione humanitare, në shpëtimin e infermiereve amerikane, aeroplani me të cilin fluturonin, gabimisht ra në Shqipëri në zonat e luftës, ku partizanët, duke mos pyetur për jetët e tyre, donin t’i përdornin si propagandë, si zbarkim të aletarëve, na thotë Kadri Cakrani. Tjetër, lirimi i disa ushtarëve gjermanë, të kapur rob nga

partizanët në Berat, kur ata, ushtarët gjermanë, nuk e dinin se partizanët do ta shkelnin marrëveshjen që kishin bërë me ta. Komanda gjermane menjëherë mori 140 pengje, shqiptarë të pafajshëm, që do t’i pushkatonte, nëse nuk ktheheshin në repart dy robërit gjermanë. Partizanët e donin masakrën, se kështu shtohet urrejtja kundër gjermanëve, por Kadri Cakrani shkoi në zonat e tyre dhe i liroi robërit gjermanë, që të shpëtonte jetët e 140 njerëzve, bashkëqytetarë të tij. Bashkë me tensionin rritet dhe mrekullia e librit. Fshehja e Kodikëve të Beratit, mijëvjeçarë, bizantinë, sidomos atë të purpurтин, që e kërkonin gjermanët dhe, po të mos ua dorëzonin, do të pushkatoheshin priftërinjtë tanë ortodoksë, sa të ishin aty. Përsëri Kadri Cakrani është në vorbull, për të gjetur zgjidhjen, teksa përkthen gjermanët e ardhur nga Tirana për këte çështje. Duheshin ruajtur priftërinjtë nga pushkatimi, por dhe kodikët patjetër dhe kush kallzonte, “do ta pushkatoj unë” – kërcënonte Kadri Cakrani si përherë. Dhe ai propozoi benë e rreme te gjermanët, pasi priftërinjtë i ishin lutur ikonës së Shën Mërisë që t’i falte për atë që do të bënin.

Libri është plot me ngjarje e kundërngjarje, zbulime dhe kundërzbulime, aleanca të fshehta e kritike, rreziqe dhe humnera, natë dhe luftë, vrasje dhe sherre kombëtare që do të zgjidheshin si do të mund të zgjidhej bota e të vendoste për Shqipërinë, etj, etj, teksa dhe çështje befas hapte të tjera e më të mëdha si rrathët e ujit, kur hidhet një gur mbi një pellg. Ato rrathë shkonin dhe më përtej vendit, në Beograd e Athinë, Londër e Moskë, e Uashington dhe s’ishin prej uji, por shpesh rrathë gjaku. Akuzat e kudërakuzat tashmë nuk kishin të sosur, krahui i partizanëve kishte mjeshtira të propagandës, gjithmonë në rritje, akuzohej Balli Kombëtar për bashkëpunim me pushtuesin, si organizatë tradhtarësh, teksa gjermanët po arrestonin dhe internonin nga radhët e Ballit, sipas Kadri Cakranit, psh, internohet poeti Kudret Kokoshi, më pas i burgosur i komunistëve etj.

Gjithsesi Balli Kombëtar, kur po dukej absurde në atë realitet të çmendur, po arrinte

fitore humane e morale, duke pranuar që t’i binin mbi shpinë dhe akuzat. Ndërkaq terrori po u jepte sukses partizanëve. Që ata po e përdornin më së miri, nuk e thotë vetëm Kadri Cakrani me dëshmitë e tij, por dhe të tjerë, madje dhe nga radhët e partizanëve, p.sh, i ikuri i tyre, Xhelal Staraveska, ushtarak i lartë, por dhe teoricieni po i tyre, që kishte studiuar në Moskë, poeti Sejfulla Malëshova, ua tha në një nga konferencat që Partia Komuniste, po shndërrohej në një bandë me terroristë. Kadri Cakrani i mëshon ngulmimit që vrasësit e Shqipërisë duheshin vrarë, qofshin këta dhe shqiptarë. Lufta ka ligjet e saj, ajo nuk fitohet me falje atyre që nuk të falin. Gjermanët po mundeshin si kundërshtarë dhe po fitonin kundërshtarët e tjerë, komunistët, sipas Kadri Cakranit, dhe ajo që po humbte vërtet, ishte Shqipëria. Kadri Cakrani me gjithë krerët e Ballit Kombëtar, Legalistëve, kolaboracionistëve, etj, ikin. Humbën betejën, por jo luftën, sipas Mit’hat Frashërit. Dhe do ta vazhdonin nga jashtë “Për Shqipërinë”.

Terrori i fitimtarëve do të ishte më i keq dhe më i madh se i pushtuesve. Xhaxhain e Kadri Cakranit, Bektash bej Cakrani, ai që e kishte rritur, ministri i parë i financave në shtetin e ri shqiptar, do ta pushkatonin. Skena është heroike nga ana e të pushkatuarve, kurse nga ana e atyre që pushkatonin, kishte grotesk. Ata bënin provat e pushkatimit se pritej një i madh që do të asistonte, do të vinte ai, tashmë i lartë në pozitë, që Kadri Cakrani donte ta vriste, por nuk e kishte lënë xhaxhai, që po pushkatohej tani prej tij.

Në Shqipëri, në mes të qytetit të Fierit, varin një vëlla të Kadri Cakranit, dy të tjerë i burgosin, ndërsa e motra e tyre, ajo e Arteve të Bukura, Suhadja e bukur, vdes në moshë të re, e tmerruar në çmendinë. Si një metaforë e rinisë së asaj kohe. Një metaforë tjetër e rëndë në libër është dhe ajo me kafkën e Gjergj Kastrioti-Skënderbeut, që mendohej se ishte në një varr të fshehtë në një Kishë të vogël në Lezhë, por duke mos treguar përkujdesjen e duhur shteti i ri, duke bërë të kundërtën, dukej se kështu do të humbte dhe ajo traditë e lashtë, zakonet, lavdia historike e shqiptarëve, etj, etj.

Edhe në SHBA, në një mledhje të OKB, ku vinte të merrte pjesë nga Tirana dhe ai, armiku i tyre, Kadri Cakrani po e priste në një rrugë të Nju Jorkut, përballë hotelit t’i bënte atentat me sanjper. Prandaj dhe në libër, në fund, gjejmë dhe skena si të filmave hollivudianë, kur Kadri Cakrani ndjek me çifte veturën e atyre që kishin qendruar dyshueshëm para restorantit së tij, që duhej të ishin vënë nga Sigurimi i Shtetit Shqiptar. Libri mbyllet ashtu siç fillon, si me një ironi, me ndeshje futbolli. A thua ashtu janë përpjekjet e gjithë kësaj jete, një lojë?

E rëndësishme në Kujtimet e Kadri Cakranit nuk janë ngjarjet, por lënda, koha që sjell dhe të vërtetat e tij përballë të vërtetave të të tjerëve, të vetë historisë zyrtare. Kjo përballje e re, dikur me armë dhe tani me libra, ndihmon kujtesën kombëtare, krijimin e një të vërtete të përbashkët, se asnjëra më vete nuk mund të jetë absolute, por nga këndvështrimet arrijmë në përfundimin se të gjithë u përpoqën për Shqipërinë, sipas asaj që besonin dhe interesave vetiake, me strategjinë dhe taktikat që njihnin apo iu imponuan. Cilët ishin në anën e duhur të historisë? Po ne ende nuk kemi një histori të përbashkët, me ngjarje dhe heronj të pranuar nga të gjithë. U dukën se ishin fitimtarët, por kur morën pushtet, ata u bënë antihistorikë të tmerrshëm. Të mundurit? Koha duket se u dha të drejtë tani që s’janë. Që nuk do të dihej si do të ishin po të kishin marrë pushtet. Por mjaftojnë idetë, vizioni, madje dhe humbja. Më mirë të humbësh në kohën që duhet, se sa të fitosh, kur nuk duhet. Janë më të rënda për një popull fitoret e dëmshme. E cilët ishin kolaboracionistë më të rrezikshëm për vendit, ata të kohës së luftës nën pushtim perëndimor apo ata të kohës së paqes me Bllokun e Lindjes? Cakrani, vetëkuptohet, është kundër të dytëve dhe i luftoi. Po jo vetëm ai. Ndërkaq po shtohen ata që mendojnë ashtu. Nëse nuk është arritur të përcaktohet se cila ishte më mira që do të duhej për atëhere, të jemi në gjendje të gjejmë se ç’ishte më e keqja, që nuk do të duhej. Të paktën të na bashkonte kjo.

Ndihmesa e librit të Kadri Cakranit në këtë çështje është e jashtazakonshme. Dhe e dashurisë pa kushte për atdheun.

NJË EPILOG I VOGËL
(jashtë këtij libri)

...tashmë, që nga viti 2000, është ringritur Fondacioni “Vëllezërit Cakrani” dhe dy librat me memoaristikë, “Kujtimet e një firmëtari” dhe “Të vërtetat e luftës time” të shkruara nga ati, Hajredin Cakrani dhe biri, Kadri Cakrani, të një rëndie të veçantë, thesar mes veprave të Kujtesës Kombëtare, na vijnë për herë të parë si zbulime falë pasardhësit të tyre, avokat Kujtim Cakranit. Puna e tij, pasioni, këmbëngulja, guximi i trashëguar janë si një ringjallje, jo vetëm e Familjes së tij të Madhe.

Ai është i angazhuar edhe profesionalisht në zbulimin dhe dënimin e krimeve të komunizmit, qoftë dhe moralisht, edhe pse ka munguar një Gjyq shqiptar i Nurenbergut. Së fundmi ai ka marrë një nismë të vaçantë, do të thosha të mrekullueshme, ka hedhur në gjyq institucione shtetërore, pra shtetin, që pse nuk është dhe nuk gjendet ku është Dokumenti autentik i Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë në vitin 1912, ku një nga firmëtarët është dhe stërgjyshi i tij. Shqetësimi i tij e tejkalon atë familjar, është shqetësim për gjithë Familjen e Atdheut. Sipas avokat Kujtim Cakranit ai dokumet është si dokumenti i pronësisë së shtëpisë, ne e kemi shtëpinë e përbashkët, Shqipërinë, por nuk kemi dokumentin. Ku është? Pse fshihet? Pse nuk gjendet? Ai ka zbuluar se deri në 1944 ai dokument themeltar ka qenë, i ruajtur në Kasafortën e Bankës Kombëtare të Shqipërisë dhe kur çelsat i morën fitimtarët, ai dokument u zhduk dhe përdorej një i falsifikuar, ku qenë fshirë mjaft firma, hedhësit e së cilës ishin vrarë apo burgosur nga regjimi dhe ishin shtuar firma të atyre që nuk kanë qenë në shpalljen e Pavarësisë, si p.sh, xhaxhai i diktatorit Enver Hoxha.

Avokati Kujtim Cakrani kërkon në emrin e gjithë shqiptarëve, për Shqipërinë, edhe pse e pa shpallur kështu, Dokumentin e Pavarësisë tonë. Akt i lartë, madhështor, vazhdim i udhës së të parëve të tij. Megjithëse ai dokument është në gjakun e shqiptarëve, në ajrin e atdheut, madje është dhe monument prej bronzi në kryeqytet me firmat si shtigje të ndërprera, por që i bashkon bëma e madhe, historike. Ne dhe shteti jemi të lirë dhe të të pavaruar aq sa është ky dokument vërtet brenda nesh.

Këtë kërkon të çertifikojë avokat ynë.



Teknologjia dhe interneti, gjithnjë në ‘ekspansion’, kanë ndryshuar dhe po e zhvillojnë botën me një shpejtësi pothuaj të frikshme. Megjithatë, ekspozimi i tepërt ndaj modeleve online të jetës e krijimtarisë, përfshi atë letrare, gjendet përballë performancave që ende shpresojnë të mbrojnë autenticitetin e qenies, atë çka e bën njerëzore pamjen. Në këtë përballje, lipset të themi që ende ka një ndryshim të madh ndërmjet asaj çfarë shpërndahet falas e pa asnjëlloj vëmendjeje në botën virtuale dhe asaj që mund ta quajmë ‘krijimtaria-letër’. E para vërtet ka pushtuar botën, brezat, po ribën bibliotekat, trashëgiminë, studimet korente, etj., por ndërkohë ka shpërndarë kaq shumë mjegull, ka devijuar vende-vende teknikën dhe parimet e të shkruarit, ka provokuar si kurrë ndonjëherë dëshirën e njerëzve për t’u shfaqur me çdo kusht, ka prodhuar pa fund poetë amatorë, prozatorë gjithaq, gjuhëtarë, historianë po të atij kallëpi, etj. Kurse e dyta, krijimtaria-letër, realisht në pozita që lënë për të dëshiruar, ende respekton disa parime e rregulla; fundja është ende më e besueshme për një shumicë krijuesish.

Po përpiqemi të themi diçka për dy nga problemet që ka sjellë aksioni i paprerë virtual: I pari, ai i nënshtimit ndaj formateve të robotit e sensorëve të tij; dhe i dyti presioni i mediokërve dhe krijuesve të rastësishëm, që falë mundësive virtuale, po hapen si vaji në lakra. Arritjet digjitale nuk mund të fshehin problemet e rënda të të shkruarit. Brenda një kohe relativisht të shkurtër, gjithçka e ka marrë në dorë kompjuteri dhe programuesit, roboti po dikton teknika dhe versione të çuditshme, rëndom të gabuara; natyrisht, ende jo atje ku njerëzit e kulturuar dinë të dallojnë ndryshimet funksionale nga teprimet dhe marrëzitë. Sot shohim se si, vend e pa vend, fjalët shkruhen me shkronjë të parë të madhe; sa për shkak të arrogancës së robotit, aq edhe falë ndikimeve të ndonjë gjuhe që gjithashtu dikton gjerësisht me rregullat e saj. Në shumicën e poezive që publikohen, sikur edhe dy fjalë të jetë vargu, ky fillon me shkronjë të parë të madhe (!) Po ashtu, në shumë shkrime publicistike, madje edhe në disa proza letrare, paragrafët ndahen e veçohen me hapësira të panevojshme; sikur të ish fjala për shkresa zyrtare apo për episode të reja e kapituj të rinj. Dhe ‘ë’-ja e shumëpërgojuar me çfarë nuk zëvendësohet, thua se jemi duke luajtur me shenja e jeroglfe.

Roboti, kompjuteri, nënshtimi digjital - kur mbyllen sytë dhe hidhet në tastierë çfarë të jetë - ofrojnë në publik gjithfarë marrëzish. Ato e sjellin fjalën në një version të habitshëm, edhe të shëmtuar pse jo; sidomos kur kujdesi për gjuhën dhe radhitjen, është gjëja e fundit që u shkon nëpër mend shkruarve. Më ndiqni: “Fundit i fundit pasardhësit e këtyre barinjve jane sot ne Parlamentin qe votoi per Hodgin. I cili te drejtoje dhe te shkruaje mbi historine e antikitetit te trojeve ku barinjte piqnin ndonje dele dhe e shkembenin me vazo plot piktura te prodhuara nga nje kulture superiore Helene qe kishte themeluar qytetin.”

Çfarë është kjo? Si mund t’i besojmë studjuesit apo hulumtuesit që vjen në publik me këtë shqipe? Veç nëse e kanë tjetërsuar në blog a në rrjet. Edhe kështu mund të ndodhë. Përtej modestisë, po ju tregoj çfarë i është bërë një shënimit tim për filmin në një media-tallava. U lutem lexuesve të nderuar të kenë pak durim:

“Ato krijuan edhe figura që i qëndruan kohës, zbutën disi vështirësitë dhe vrazhdësinë e dekadave - në një jetë pothuaj absurde - duke shkëlqyer në disa nga filmat e mirë të Kinostudios dhe RTSH.

Po ashtu falë edhe skenarëve gjithashtu të mirë të disa autorëve të spikatur si N. Lera, B. Hoxha, N. Tafa, B. Myftiu, etj.

Dhe kinoregjisorëve gjithaq Dh. Anagnosti, V. Gjika, K. Mitro e I. Muçaj, P. Milkani, E. Musliu, A. Xholi, etj. (Dua je emrin tënd, Apasionata, Telefoni i një mëngjesi, Në

TALLAVAJA VIRTUALE DHE “KRIJIMTARIA LETËR”

Dëshirojnë pavdekësinë dhe pastaj nuk dinë ç’të bëjnë një pasdite me shi.

Nga Vangjush Saro

çdo stinë, Të shoh në sy, Brazdat, Unë e dua Erën, Fillim i vështirë, etj.”

E gjithë kjo rrëmuje - e kam vënë në thonjëza për t’u dalluar që po e risjell siç e kanë sakatuar - tregon më së miri nivelin e pakët kulturor të botuesve në fjalë, si dhe faktin që ata tashmë janë nënshtruar nga roboti. S’po ankohe me që e kanë vjedhur shënimin; po e heqim këtë episod. Shkrimi është coptuar. Fjalitë janë shpërndarë. I kanë rinisur ato siç u thotë kapllloqja. Kur e kam lexuar rastësisht, jam skandalizuar. Duhet të shpëtojme nga kjo epidemi që po e trand lexuesin dhe tregun; por vërtet, nuk di si mund të vëmë pak rregull në shtëpinë tonë të fjalës.

Problemi tjetër më i ndeshur në këtë udhë (‘i dyti’ u quajt më lart) është përfshirja masive e njerëzve në ‘krijimtari’ apo duke u ‘ushtruar’ si të munden në disiplina të ndryshme: art, gazetari, gjuhësi, histori. Në dukje, nuk ka ndonjë të keqe, kanë dëshirë të shprehen. Ajo që nuk shkon, është dalja në këtë shesh me shpatë të madhe. Fundja, ja edhe këtë po e pranojmë. Por kur ‘shpata e madhe’ - që të mos them ndonjë fjalë tjetër, se nuk i duroj dot termat e forta - kur gjithë ky pretendim pra, vjen përmes një konfuzioni sintaksor, si dhe me shumë gabime drejtshkrimore e pikësimi, atëherë duhet të ndalemi. ‘Mëtonjësit’ e kësaj dalldie, siç thotë diku **Ç. Dikens**, “jo vetëm që s’kanë mbetur në zall, por tani kanë hyrë në ujërat më të thella dhe nuk po ia gjejnë dot fundin... mendjemprehtësisë së tyre.”

Sa për një ‘marrëveshje fjale’, doemos që edhe në kushte virtuale mund të ketë përsosmëri, përkujdesje për redaktim, korrektim letrar dhe faqosje të pranueshme. Por e vërteta është që këto kuota po merren nëpër këmbë në emër të... nuk di t’i gjej një ‘pronar’ kësaj dukurie. Pra, duke u bashkuar diktati apo thjesht modeli robotik me paditurinë dhe nivelin mediokër në disa tregues, përftohet një tallava letrare e publicistike që nuk dihet ç’pamje do të marrë më tej. Në këtë udhë, po publikohen shkrime e krijimtari pa asnjëlloj recensioni, pa redaktim, pa korrekturë letrare. (Tash edhe disa shtëpi botuese, për fat të keq - dhe e them me dhimbje - janë kaq pranë tallavasë; ato botojnë çfarë të duan ‘autorët’, mjaft që ata të paguajnë; dhe rëndom, nuk i hidhet një sy lëndës letrare, për të mos folur për procese të tjera parapërgatitore, të duhurat që libri të shkojë në publik sa më bindshëm.)

Sigurisht, edhe pse duke bashkëjetuar me teknologjinë, një shumicë (unë bëj pjesë ndër ta) ende anojnë nga ‘krijimtaria-letër’; me çka kuptoj një gazetë të shtypur, një TV a një shtëpi botuese me staf, që do të thotë se projekti (krijimi) që është në shqyrtim... lexohet, diskutohet e, nëse merr viston, redaktohet, korrektohet për të shkruar në publik në trajtën e duhur, për nga brendia, por edhe në pikëpamje gjuhësore e strukturore. Mbase kjo rrugë është pak e gjatë dhe e mërzitshme për shumë shkruar e botues të sotëm. Punë e tyre!

Ajo që po shfaqet gjithnjë dhe më imponuese, është ndërkaq ‘ujdia’ mes

mediokritetit dhe snobizmit; rrjetet e kanë favorizuar këtë aleancë. Gjithnjë e më shumë shihen letrarë që flasin për letërsinë e librin duke marrë poza prej njeriu të shumëditur, por (në fakt) duke u shprehur në një mënyrë që as ata vetë nuk e kuptojnë; dhe fundja, mbase nuk dinë çfarë kërkojnë nga ajo lloj e folure, ndërsa koka u mbetet vetëm në qiell. Është e frikshme që nuk përmenden termat e Teorisë së Letërsisë dhe të Tekstit, por flitet kuturu, pa përgjegjësi, sikur jemi në një disiplinë krejt tjetër, që s’ka asnjë lidhje me fjalën. Disa nga këto llojotitje, me gjasë ‘të veçanta’, nuk i gjen askund, qoftë edhe në njëllloj përafrimi. S’është fjala për t’i shenjuar fjalë për fjalë - ja u bë lëmshi - por me qenë të tilla që të kujtojnë diçka nga terminologjia letrare, nga estetika, nga çfarë kanë thënë ata që kanë përcjellë në publik vepra me jetë të gjatë.

Ndonjëherë snobizmi vishet edhe me ngjyra krahinarizmi, siç ndodh me ndonjë blog tek-tuk apo edhe me ndonjë revistë letrare, ku lançohen vetëm (ose kryesisht) autorë nga Veriu dhe Kosova (!) E keqja merr vërtet trajta të frikshme teksa animi nga të folmet e dialektet mplekset me mosnjohjen e parimeve të të shkruarit e, më tej, edhe me problemet e robotit, pra çfarë kompjuteri dikton ‘shqeto’ për atë që s’ia vë veshin. Ani. Pa u prishur punë ‘të dashuruarve’ me dialektet, prapë duhet thënë që ende nuk ka ndonjë qëndrim zyrtar, ndonjë vendim shtetëror që mediat të mos i qëndrojnë Gjuhës Letrare, thënë ndryshe Standardit; pa le që, edhe kështu, jemi mjaft të trallisur nga çfarë hyn e del nëpër të shkruara gjithfarë, pra nuk besoj se e kemi luksin të kthehemi pas e të shumëzohemi sërish në të folme e dialekte.

Përtej të gjitha marrëzive - sikur të ishte pak të shkruarit keq dhe me gabime e që, siç u tha, ndonjëherë bien në sy edhe më tepër për shkak të ‘rolit’ të robotit - ledhatimet me terma të tillë si ‘trendi’, ‘i papërsëritshëm’, ‘gjeni’, ‘princ’, ‘perandor’, ashtu e kështu, janë bërë më shumë se qesharake. Ndonjëherë, këto lojëra më kujtojnë episodin e parë të romanit “Komedianët” të G. Grin, ku autori sugjeron të ngrihet një përmendore a bust për një nga personazhet e tij, aventurierin dhe mashtruesin e trishtë Xhons... Unë nuk jam keqdashës, nuk paragjykoj. Por këto teprime, emfaza, dasi e përzgjedhje me hile dhe pa pikë profesionalizmi, edhe pse janë të përkohshme, trazojnë pamjen, krijojnë tablo të rreme. Qasja e verbër në një rreth të ngushtë të njohurish, kapardisja përtej domosdosës së redaktimit e korrektimit letrar, por dhe kërkesave të tjera më teknike, loja me terma bombastikë dhe aspak realistë, mosvëmendja ndaj parimeve kryesore të të shkruarit dhe publikimit, të gjitha këto vijnë si një fyerje për mediat dhe botuesit që bëjnë ndryshimin në këtë fushë, gjithaq për krijuesit që kanë gjetur në mënyrë bindëse mbështetjen e publikut dhe të mendimit letrar.

Po ndalem pak në këtë episod. Ja një fragment nga një ‘kritikë letrare’, shkëputur nga një media-tallava: “Autor i shume librave,ne



gjini e zhanre te ndryshme,per te gjitha moshat e per gjithë hapsirat shqipfolese,ai ka zene me merite nje vend te rendesishem ne letersine shqipe.” (Shikoni që përveç brendisë naive e bërtitëse, ka shumë gabime gjuhësore dhe mandej edhe probleme teknike, si spaciots (hapësirat nga fjala në fjalë,) etj. etj.) Një tjetër produkt i kokëshkrepjes internetike: “Teksa ke lexuar dy veprat e tij të mëparshme dhe me padurim pretë të tretin, ja ku erdhi romani befasues “X” (botuar nga Y) si pjesë përmbyllëse trilogjisë, “Z” të cilën, pas leximit, e fusim në atë që mund ta quajmë, “Tresor” i letërsisë shqipe dhe jo vetëm.” (Inicialet janë vendosur nga autori i këtyre radhëve, për të mos e afektuar më tej shkruar. Besoj, lexohet qartë emfaza e padurueshme dhe gabimet e shumta e të shumëllojta.) Ja edhe një tjetër ‘kritikë’, të cilën nuk di nga ta kapësh: “Është ky libër ku mpleksen shumë objektiva që ka poeti, sic janë pamjet qytetare ku orët e qytetit n+ mënyrë metaforike projektohet nga poeti në të gjashtë pamjet e mundëshme, para, mbrap, lart, poshtë, anash majtas dhe anash djathtas, pamje që të lejojnë për të kuptuar turbullirat e kohës.”

Ndokush mund të thotë që nuk kemi pse të merremi me përjashtime të tilla apo asish që u zunë gojë më lart; (në fakt, ato nuk janë më përjashtime). Rrjetet tash janë ‘me barrë’, libraritë gjithashtu. Marrëzia virtuale po depërton gjithandej. Janë të pakta entet (mbase dhe autorët) që arrijnë të krijojnë a të mbrojnë një staturë për të qenë. Kemi parë madje shkrimtarë deri diku të njohur që shënime si ato më sipër, apo aty afër, i risjellin në rrjet sikur çfarë do të fitojnë prej tyre, duke shfaqur kështu indiferencë ndaj dukurisë, sikurse edhe një padurim të dyshimtë në lidhje me cilësimin e treguesve të krijimtarisë së tyre.

Në këto e sipër, autorët ‘e shtuar’ të shkrimeve, kritikave dhe krijimeve të tjera në fjalë - version virtual i mjegullon edhe më shumë - shkojnë larg. Ata marrin guximin të përgojnë vlera reale, ata kërkojnë skeptër, mëtojnë të njëjtin vend e nder në librari, në panairë, nëpër TV, madje u bëjnë presion edhe lexuesve duke treguar kioskat ku mund të gjenden libra e tyre, por që rëndom i kanë në shtëpira dhe i shesin edhe vetë si të mundin... (“Janë miliona ata që dëshirojnë pavdekësinë dhe pastaj nuk dinë ç’të bëjnë një pasdite me shi.” S. Ertz)

Teprimi gjithnjë është bezdisës dhe i dëmshëm; në **çdo** lëmë, ca më tepër në art. Teknologjia po ngutet pareshtur; madje Inteligjenca Artificiale mund të zhbëjë shumë pamje të botës e të arritjeve njerëzore. Por le të shpjegohemi edhe njëherë: Nuk ishte fjala thjesht për librin-letër, gazetën-letër, por për përgatitjen e gjithanshme të një teksti a pune (pavarësisht versionit teknik) përpara se ai të shkojë në publik; me ç’rast, duhet të dimë nëse do t’i shërbejë zhgënjimit apo zhvillimit e pasurimit të arritjeve më të spikatura. Tallavaja virtuale s’e bën dot punën e vizatuar më sipër; përkundrazi, po sulmon vlerat më të qenësishme. Sigurisht - ajo si e tillë, jo teknologjia funksionale - nuk mund dhe sdo ta fitojë betejën me letrat dhe artin.


Është shumë ftohtë, më tha Ladi, kam hallin e vajzës së sapolindur. U bë dy ditë që kërkoj një reflektor si Diogjeni me fener që kërkonte njeriun. Kam unë, i thashë, ta sjell sonte! Njohja me Vladimir Priftin ishte e thjeshtë: ai ishte një orator i lindur, më shikonte riosh pa përvojë dhe më rrëfente për sekretet e filmit. Dramaturgjia, ajo është thembra e Akilit. Temporitmi. Më kupton? Një tregim i thjeshtë ishte ai i Dhimitër Shuteriqit, e kam fjalën për Buka dhe thika... Punoi me tregimin Peçi Dado, Naumi, unë vetë. Duhej dialog i fortë dhe mendoj se ia arritëm. Udha e shkronjave ende pëlqehet shumë.

Harronim të hipnim në autobusin e linjës Kinostudio - Kombinat, e merrnim në këmbë të tatëpjetën, shkolla e Bashkuar, Medreseja, aty përballë vilës *Gold* ndalonim, po s'ndaheshim, ngjitur ishte rrugica e vogël në fund të së cilës ndodhej shtëpia përdhese e Ladit. Unë në fillim gjej subjektin, lexoj shkrimtarët e tregimit, Teodorin, Naumin, Vathin, Dritëronë. Gjuaj gjetje. Bie fjala, ç'ka të veçantë: *Ajri i ftohtë i mesnatës*, i Teodorit. Vëllai i madh i fshatit ther kaun e vetëm për dasmën e vëllait të vogël, funksionar i lartë në Tiranë. Ç'merr si shpërblim? Mosmirënjohjen. (Dhe vjen një ditë). Po shoferi i kamionit që aksidenton mësuesen e fshatit dhe i çon asaj në spital një qeskë me qersh, të cilat, nga shtrëngimi, kanë kulluar dhe ia kanë bërë duart gjak? Sheh gjë film ti? E, më thuaj. Unë shoh. (Flutura në kabinën time). Kam vite që i bluaj. Pothuajse i kam hedhur si konstrukt dramaturgjike, tani më duhet dialogu. Kam fiksuar Naumin dhe Teodorin. Ata janë dialogistë të mirë. Përditë jetoj me imazhin. Si ai skulptori që nxjerr nga guri tiparet, përvijon linjat e vijat pastaj konturon njeriun e plotë, edhe unë punoj për personazhet, aktorët që do t'i interpretojnë, po ajo që më mundon është dramaturgjia, pikërisht në këtë drejtim duhet punë e vërtetë konstruktori, këtu çalojnë filmat tanë. Pastaj më fliste për elementin e dytë të rëndësishëm që s'i takonte më skenarit, po punës së tij tekniko - regjisoriale, kur shndërronte skenarin artistik në imazh filmik. Dhe ky element bazë ishin aktorët. Ekuivalenca ideale e personazhit me aktorin. Marrëdhënia gati dashurore e figurës artistike me interpretimin, mishërimi i fantazmës, ende i së padukshmes si një makth, karakterit dramaturgjik filmik, që ende ekziston si lëndë eterne vetëm për lexim, me aktorin e përshtatshëm. Kjo rezonancë delikate, kur gjen masën e vet, të kujton një çift të dashuruarish që e ngrysin jetën së bashku. Dhe pikërisht kjo është një nga provat e suksesit. Dhe Ladi më përmendi filmin *Udha e shkronjave*, aktorët Sandër Prosi, (Dhaskal Todhri) Bujar Lako (Tunxhi) Ndrek Luca (vrasësi). A të shkon mendja për aktorë të tjerë? Besoj se jo. Sepse po të shkoi mendja, e kësisoj të fillosh e të zëvendësosh aktorin që interpreton, me një tjetër, ti ke dështuar.

Ladi kishte një zakon: i bënte me qejf ripunimet, vërejtjet e Këshillit Artistik, madje provokonte dhe mbante shënime. Ishte krejt gjakftohtë, çuditërisht i prirë për vërejtje e sugjerime, ndonëse si rëndom duhet të ndodhte e kundërta, por jo, s'kishte kurrfarë nervozizmi e justifikimi, moskuptimi e kundërshtimi dhe kjo zgjaste deri në fund. Racionaliteti i tij, ngulmimi për t'i bërë sa më shumë vërejtje, debati që nxiste, më dukeshin disi të panatyrshme, më çudisnin së tepërmi, sepse më dukej sikur ai e vinte veten në një arenë gladiatorësh, aq lehtësisht, pa vramendje, pa i bërë përshypje humbja. Si një kampion që jepet dhe të krijon kështu përshtypjen e disfatës. Por ishte një lojë mençurie. I linte fushë të hapur «kundërshtarit» pa u mbrojtur. Mbaj mend njëherë Anagnostin kur i tha: Ladi, e ke zbuluar që në fillim filmin, të ka humbur befasia. Pra filmin e ke vetëm në dy tri faqet e para, ç' thua më pas janë marrë vesh me kohë. Ladi mbante shënime, i bëri një pyetje, dy, sërish mbante shënime, e krijonte vetë

VLADIMIR PRIFTI DHE FILMI I FUNDIT

Nga Roland Gjoza



debatin e në fund, kur s'e priste askush, ngaqë s'ndodhte asnjëherë me kërkesën e vetë regjisorit, lutej për një mbledhje të dytë. O, Ladi, ç'flet, pothuajse filmin e ke gati. Pse e bën qimen tra! Po atij vetë, shpirt i kritikës, më fort kundërshtues i vetes, i kërkitit të mundimshëm, i pakënaqësisë me masën e gjërave, nuk i mbushej mendja, logjikën dhe intuitën ende i kishte të ndezura, në një shtjellë dyshimi dhe brengje prej papërkryerjes. Priste të binin fashë që të thoshte, i lodhur, i rraskapitur: Jam gati! Asnjë s'e bënte këtë. Dhe unë e pyeta një ditë: Të gjithë druhen nga Këshilli Artistik, e kanë frikë, kurse ti e kërkon, madje edhe për herë të dytë. Ja, përgjigja e tij: Gjithmonë në skenar ka gjëra të pazgjidhura dhe unë shkoj me shpresën se duke provokuar debat, ndez fantazinë, mpreh logjikën e atij tjetrit, e vë në rrugën që dua, sepse pa dashje, kap kumte që hedhin dritë në skutat e mia ende në terr. Dhe për fat më ka ecur, kam gjetur nga një fjalë, nga një shkëndijë ideje, e shqiptuar prej dikujt, kam kapur atë që kërkoja prej shumë kohësh, po s'e gjeja. Përfitoj Roland, edhe të paguash me para në dorë, kurrresi nuk i mbledh dot këto koka të filmit, është një rast që të jepet, pse të mos e shfrytëzoj? Pastaj qeshte, bënte shaka: është si puna e atij «hajdutit», që e gjen shtëpinë hapur, pa zot!

Ladi fliste, po sdëgjonte, unë s'flisja, po dëgjoja. Ladi donte dëgjues dhe unë këtë veti e shfrytëzoja për të mësuar të fshehtat e skenarit. Roland, e ke lexuar *Dasmën e Sakos* të Vathit? Po. Dhe qeshi. E dija që do të më fliste gjerë e gjatë për novelën, por jo për atë që kishte lexuar, po për tjetrën, atë që kishte konturuar vetë. Na zuri mesnata te porta e shtëpisë së tij dhe më në fund u kujtua se kishte në xhep listën me ushqime që duhet t'i kish blerë, por që i kishte harruar ndërkaq. O, i ra ballit, s'ka qumësht për vajzën! Ç'bëra! Më ka lenë pa mend Sako që e martojnë me budallain e fshatit. Kjo është gjetje. Ah, ta bëja film! Po shiko... Kalonte dhe mesnata. Mund të na kishte gjetur dhe agu, po të mos këndonte një këndes aty ngjitur që e përmendi nga ajo furi pasioni. Hapej dera dhe ashtu gjysmë e hapur, ai vazhdonte: Le që ku ka para për film, s'e shikon ç'bëhet? Kishte të drejtë. Kinostudio i kishte dëbuar të gjithë, gati 900 punonjësit e dikurshëm, bashkë me artistët, ia kishin mbathur nga sytë këmbët në kërkim të kotheres dhe ndërkaq gjithë ato hektarë me ulla, kinofikimi, ateljetë, reparti i zërit, parku i automjeteve, prapavija, lulishtet, po ndaheshin si mall pa zot. Të merrte të qarët ta shikoje si i binin tjegullat dhe si i leskraroheshin muret nga suvaja që ronitej. Tërë ajo ndërtesë me arkitekturë

klasike po i ngjante një varreze madhështore mumjesh. Filmat flinin brenda dhe minjtë ishin spektatorët e vetëm. Jashtë rrëmujë, papunësi, ikje masive, vrasje, vjedhje dhe ishte e kotë, krejt absurde të flisje për filma. Po Ladi fliste me pasionin e një filantropi që s'i mbarohen asnjëherë paratë për bamirësi. Kineastët ndiznin zjarret e kujtimeve nëpër kioskat e bulevardit dhe aty ngrohnin duart që s'preknin më as laps, as kamera, as moviolë, as pelikulë. Kurrresi s'hiqnin dorë nga ideja e një filmi të fundit, i cili, edhe pse e dinin që ishte një iluzion i humbur, prapëseprapë e përmendnin me mall si diçka që do të ndodhte së shpejti.

I shkoja shpesh në shtëpi dhe e gjeja duke lexuar gazetatat kundruall bibliotekës plot me libra. Dhe batuta e tij: Blej libra, po lexoj gazeta. Aq shumë politikë kishte dita, sa të zihej fryma. Flisnim për situatën politike, për reformën në art që i kishte boshatisur institucionet dhe i kishte mbushur me fjalimet që buçitnin nga altoparantët nëpër sheshet rëngë me turma pafund. Flitej vetëm për politikë. Aq shumë politikë kishte sa edhe kokat e njerëzve dukeshin si altoparantë. Kokat buçitnin: vdekje komunistëve! Dhe ironia ishte se ata që na udhëhiqnin kishin qenë dikur komunistë. Sapo kishin lenë tesarat e kuqe. Politikë dhe në bukë, dhe në kafe dhe në dasmë dhe në vdekje. M'u kujtua një tregim i Hajnrih Bëlit, personazhi kryesor i të cilit, një reporter radioje, mbledhte shirita bosh dhe dëgjonte heshtjen. Këtë e bënte për t'i shpëtuar fjalimeve hysterike të Hitlerit. Ishte e trishtueshme të flisje për art kur s'bëhej art. Po kinse bëhej duke folur. Kjo na kishte mbetur, diskutime pa fund si studentët, siç thotë Çehovi në një nga dramat e tij. Ishim kthyer në harenë dhe gallatën e konvikteve. Ishte si një sfidë për eklipsin politik që kishte errësuar gjithçka.

Pastaj e linim shtëpinë dhe dilnim.

10 vjet pa bërë film, Roland, gati po ç'mësohem, s'kam as skenar.

Ishte një mbrëmje e mrekullueshme vjeshte dhe bulevardi i madh i ngjante një babilonie provizore me gjithë ato kioska pambarimisht dhe dëshpërimisht vulgare që kishin mbushur parkun *Rinia*. Atje luhej kumar, këmbeshin prostituta të huaja, shpërndahej drogë.

Pse nuk ke skenar, e ke harruar *Dasmën e Sakos*? Skenarin e Vath Koreshit? Dhe ishte hera e parë që Ladi më dëgjoi aq gjatë. Kur them aq gjatë, jo më shumë se dy tri minuta, gjersa i erdhi avazi i asaj gajdes së fshatit myzeqar dhe pas vellos, Sako zbuloi, në vend të nuses, budallain e fshatit dhe kësisoj ai dëgjoi të qeshurat e bujshme, talljet, por

edhe atë lotin e burrit të mashtruar që i theri në shpirt. Vërtet, tha, unë e kam një skenar, po si e kisha harruar. Veç kërkon një rishikim, ende ka punë, do t'ia çoj që nesër Vathit. Sa mirë që ma kujtove. Dhe unë rrija e vrisja mendjen për një skenar të ri. Ah, sa dua të bëj një film! Dhe filluan takimet e përditshme me Vathin, herë në shtëpi, herë nëpër kafene të ndryshme, gjersa e mbyllën me një përqafim e shtrëngim duarsh. Por... sërish do të binte telefoni, se Ladi kishte dyshime, diçka megjithatë nuk shkonte. Duhej ende punë. Tre muaj të mundimshëm, Ladi dhe Vathi u bënë si Coli me Lolin, i shikoje kudo, herë duke ngritur zërin, herë duke qeshur me batutat, aq sa një ditë Vathi u dorëzua; Ladi, i tha, nuk të përballoj dot... tani drejtoju Kinës, gjej atje ndonje filigranist kinez, që t'i japë dorën e fundit... ta lëmojë e ta lëmojë gjer në imtësinë më të padukshme. Dhe kur filmi u shfaq, e pyeta, në një nga takimet tona gati të përditshme; Je i kënaqur më në fund? Eh, psherëtiu, nja dy gjëra duheshin bërë ndryshe...

Ladi, je në vete, i thonin miqtë, a xhirohet në këtë kohë? Pse? Do të lësh kokën, do të marrësh më qafë dhe grupin e të huajve që s'kanë informacion për situatën kaotike në Shqipëri, sidomos ne jug ku do të xhirosh ti... Ky është filmi i fundit, përgjigjej Ladi, e ndiej që është i fundit, s'kam rast tjetër...

Dhe në kohën më të keqe, në 97-tën, ai realizoi bashkë me një studio filmike hungareze, *Dasma e Sakos*, pa pyetur për bandat e jugut, për kallashnikovët, rrugët e bllokuara. U ngujua me grupin e xhirimit në një hotel të Gjirokastrës dhe, ditën e tretë, operatori i shquar hungarez që xhironte dhe në Hollivud, humbi. Menduan se e kishin marrë peng bandat, dhanë para dhe ai u duk papritur, aspak i friksuar, por përkundrazi krejt i mahnitur. Më lini këtu, thoshte, s'ka gjë se bëhet luftë, nuk kam parë ndonjëherë një qytet si ky, një përrallë guri. Kam qenë kudo, më besoni, po s' kam parë si këto shtëpi, si ky terren i pjerrët, një atelje e gjallë, këtë s'e ka as Hollivudi. Mos jam në ëndërr? Këtë mendoj dhe mbeta duke pickuar krahët. Ndërsa regjisorit të montazhit i binte të fiket kur shikonte banditët e armatosur që shkrenin armët në mes të xhimit. Ai u mbyll brenda, nuk dilte më dhe komunikimi me të u bë me letra që i futeshin poshtë derës.

Gjithmonë i dukeshin para të thata në dorë. Edhe kur çonin filmin në Tiranë, në laborator, paguanin shoqëruesit me armë, se kudo kishte prita, banda, kusarë, keqbërës.

Aq e fortë ishte dëshira për të bërë filmin e fundit, sa Ladi herë-herë mbetej duke iu shpjeguar pjesëtarëve të ndonjë bande, që sapo kishin djegur me flakëhedhës pemët në të dy anët e rrugës nacionale, thjesht për të provuar efektin e flakëhedhësit, se ç'do të thotë në film një batutë e goditur dhe qeshte edhe vetë kur ata i kujtonin nga filmi i tij *Udha e shkronjave* plot batuta dhe shkrehnin armët për qejf. Njëherë i vranë tre kuaj në një rrëpirë për të provuar nishanin, kush shtinte më mirë. Kuajt u rrokullisën poshtë të vdekur dhe ata u larguan sikur s'kishte ndodhur asgjë. Këto qenë incidentet më të rëndë. Se bandat e ruajtën filmin, i donin batutat, i pëlqenin filmat shqiptarë dhe e kishin për mburrje ta mbronin dhe këtë film që fliste për një dasmë me një budalla. Kjo i kënaqte, puna e atij budallait që u bë nuse.

Dhe pas disa dokumentarëve, Ladi nuk bëri më film me metrazh të gjatë. E takova vjet në pranverë: tejet intim, i ngrohtë, miqësor, me atë mendjen e tij të kthjellët, me atë uri të pashuar për të bërë film, ndonëse nuk e kishte atë entuziazmin e parë, fliste dhe unë dëgjoja, unë heshtja dhe ai fliste, se shkrimtarët duhet të dëgjojnë, ndryshe mbarojnë, kjo ishte porosia që i dha Heminguej Fitxheraldit. E, ç'të harxhosh para në ndonjë universitet privat për filmin, Ladi është shkollë, ulu me të në ndonjë kafe dhe dëgjoje. Unë vazhdoja t'i vija veshin dhe më vinte keq, se ai s'bënte më filma dhe unë s'shkruaja më skenarë.

Natasha Lako ka mësuar që më të mirën e poezisë ta gjejnë larg ose të presim në heshtje, derisa të tjerët të na pohojnë se ajo çka kemi pikasur si të rëndësishme në poezinë tonë është me të vërtetë e tillë. Kjo pasi sa herë që mbajmë në dorë hartën poetike, gishti e mbulon krejt një vend të vogël si Shqipëria, duke e bërë atë thujtë të padukshme, kur bëhet fjalë për poezinë që niset t'i bashkohet denjësisht rrjedhave më të mëdha.

Natasha Lako është rasti kur poezia që, veç bukurisë, ka fituar edhe forcë, duhet kërkuar më afër. Jo e ëmbla jo, por e pjekura. Lirizmi - brenda një kohe dhe një autoreje të pa qetë - ky e ka mbrojtur krijimtarinë poetike të Natasha Lakos si përherë edhe tani.

Ky lirizëm ruan jo vetëm autoren, por edhe lexuesin nga vulgariteti, nga pajtimi me shijen dhe aromën e keqe të banales. Por vargjet e këtij libri, që i drejtohet qytetërimit të inteligjencës (atij që nuk po arrin të dallojë se dy palë çizme dhe dy palë atlete të njëjta mund të ndodhen pranë jo për shkak të globalizmit, por ngaqë duhet të ndajnë qeranë e një dhome të vogël, apo koston e diçkaje mbi të cilën shënohet për dy paguaj vetëm një) mund të na ndihmojnë të kthejmë mendjen drejt vëzhgimeve që bën poezia, asaj më të mirës, që vlerëson lartësinë dhe tregohet e pavëmendshme ndaj masave të tjera dhe numrave rendorë, që mëtojnë t'i vënë poetët në rresht. Natasha Lako është dalja nga rreshti. Nuk mendon të jetë e para apo e rëndësishme e poezisë. Çdo lavd mbi poezinë e saj do të tingëllonte si të gjitha gjërat e ëmbla që nuk na bëjnë aq mirë.

Janë kundërpërfitime dhe jo thjesht poezi, ato me të cilat do të përplasemi në lexim. Dhe kemi qenë të paralajmëruar. Që në titull. Nuk është një libër që sjell hare dhe paqë. Do të kthehen të uritur nga leximi edhe ndjekësit e hershëm, sidomos ata që e kanë mbërthyer autoren pas vargjeve *20 qindarka për të folur me ty... 30 qindarka për të qenë të dy*. Kjo pasi poezitë e këtij libri nuk ushqejnë askënd me ëmbëlsinë e më të bukurës së jetës.

Vargjet janë ndërtuar prej furisë së përfitimeve aq të forta sa jo gjithkush do të ishte i gatshëm t'i pranonte si të vetat, veç autorit që e di se i shton botës së vet ujëra të reja e të kreshpëruara dhe ajër të harlisur qiellor. Ato vargje kanë shijen e athët të skandalit që shkaktojnë ngjarjet apo fjalët kur vendosen për herë të parë pranë e pranë. Na zënë befasisht, na gjejnë të papërgatitur dhe na kujtojnë se për të qenë autor i tyre duhet paguar shpagë. Autori paguan me të njëjtën kokëfortësi që paguan edhe jetën. Por një gjë dihet dhe mund të merret me mend: prej poezive të tilla jeta e shqiptarëve mund të mos bëhet më e mirë, por poezia e tyre, sigurisht që është më e mirë.

Natasha Lako nuk ia ka lejuar poezisë së saj romantizimin e imazheve, të fjalës apo vargut, por kjo nuk na bën të harrojmë se vijmë nga ajo trashëgimi që kërkoi dhe kërkon nga poeti himnizonjës in apo disidentin. Heroin domethënë, pavarësisht se mes vargjeve të librit shënohet se nuk dimë ende asgjë mbi heroizmin apo lëshimin e zemrës dhe se të magjishmen duhet ta zhveshim trupi çdo mbrëmje. Ndryshe, mes nesh do të mbetej po ai paradoksi i vargjeve me rima, i kadencave me rima të puthura, i metrikës së rregullt dhe i ritmeve triumfale që poetët shkruan në kohën kur vendi rroposej dhe rrokullisej në heshtje dhe në krim.

Mëse një herë poezinë e Natasha Lakos e kanë kufizuar brenda një bote gruaje, madje prej Safoje ndonjëherë, vetëm e vetës se aty gjenden vargje mbi të dashurin që kalon përmes apo ngaqë ka përkëdhelje, fustane,

DY FJALË HYRËSE MBI POEZITË E NATASHA LAKOS

Nga Arian Leka


botë dallëndyshesh, puthje, komça xhakete, fjollë dëbore, trupa që i ngajnë një dhome të fresket plot me jastëkë e nime dhe shumë luledele, lulekumbulla e lulebore.

Edhe vetëm me këto kjo autore do të ishte e përveçme, nëse do të kuptonim se bota floreale në poezi bëhet mjet për të menduar se çfarë mund të bëjmë me dashurinë e tepërt. Por çdo krahasim me poetet e temave të përjetshme apo me poeteshat e motiveve të përditshmërisë sjell hare, pasi nën këto perde e dantella ruhen të fshehtat e një gruaje dhe një burri që mund të krijojnë një njeri të ndryshëm nga vetja / buzë një rruge plot agjensi udhëtimesh dhe spitalesh për zemrën, ku një viç i sapotherrur varet kokëposhtë në qetësi, shfaqen historitë e nënave me bijtë dhe bijat ose thënë shkurt janë marrëdhëniet e atyre që mund ta zbulojnë dritën, duke hedhur pas shpine diçka.

Duhet ta gjejnë një përgjigje edhe për lirikën që mbijetoi jo tek të gjithë poetët, në motet kur bora nuk lejonte të shihje asçatitë e kuqe dhe as pemët e zhveshura, por të ndjeje se nën të pranverën që lëvizte, siç i gjejnë



të shkruara që kohë më parë në poezinë e Natasha Lakos. Ndaj dhe poetët si ajo nuk e shmangin shikimin as nga dashuria, kohët e bukura të trupit dhe drita e Mesdheut e as nga të uriturit shqiptarë, plaga që shkohet në pe, aplikacioni për punë të rregullt në Gjermani, lajmi se nuk e ke fituar llotarinë amerikane, kredia e madhe dhe puthjet edhe më të mëdha të një të dashuri të fshehur në dallapin e shtëpisë, duke ndenjur përballë lexuesit drejt e drejt, njëllor si lauresha që këmbëhet në shteg me gjahtarin, në atë "qytetin femëror", që shfaqet dhe zhduket brenda këtij libri.



Kur avitet bota

Kur avitet bota, trupi hap gjinjtë,
kërmilli më përshëndet me samar
lulëkuqesh.

Me gërmat më të vjetra e më të
pakuptueshme,
shkruajnë thneglat, një letër që më do.

Mua më ze malli për lloj lloj perëndish,
si për drerin që vrapon në zemër.

Si t'ia bëjmë me dashurinë e tepërt,
ndërron rrugë e së vërtetës, nga jargavan
në jasemin,
në përzgjatimin e luleve.

Flutur e papërdorshme

Edhe agimi po ngrihet,
si flutur,
prej ajri të bardhë,
dhe ajri të zi.

Ca qenie të ikura,
poshtë meje,
kanë zbritur,
si poshtë ditës,
pa krahë engjëlli.

Poshtë dhe më poshtë,
të tjera qenie frymore,
si sy dhe veshë,
me krahët e tyre,
më nxjerrin në krye.

Një flutur e papërdorshme,
kthehet në panjeri,
gëzimi më ka rënë në pjesë,
por duhet të agojë.

Asaj që të gjithë i thonë pranverë

Të pamundurën kërkon,
ajo që të gjithë i thonë pranverë,
pret edhe pak,
të dalë pastaj edhe prej trupit.

E thua me pranverën të pamundurën,
di të presësh dhe pak,
të gjes atë që në mendje të vjen dhe të
flet.

Të ikësh, të shpërthesh përtej trupit,
të nevojshme janë fjalët kaq,
nuk kanë lidhje as me kostumet dhe
xhaketat,
që i mbyllin të gjitha brenda.

Dhe pastaj një shtesë lind, as det, as magji,
një eko e pathënë që nxjerr zë,
deri në kërcëllimën e një dere.
Ka lindur njeriu t'i verë fre,
asaj që të gjithë i thonë pranverë.

Në orën dymbëdhjetë të natës

Në orën dymbëdhjetë të natës,
njeriu që nuk ka marrë pjesë në krim,
i ngjan krimbit të mëndafshit,
dhe errësirrës.

Në orën dymbëdhjetë të natës,
të mbyllyra janë magazinat e mëdha,
por rruga e mëndafshit është e hapur,
përtej rrugës nga Korça në Elbasan.

E pamundur të mbulohen gjithë trupat me
mëndafsh,

megjithëse ai ekziston si krimi,
në orën dymbëdhjetë të natës,
nis nga e para butësia.

Jashtë historisë mbetet njeriu që nuk ka
marrë pjesë në krim,
vetëm në mëndafsh dhe gurë,
nis numërimi i orëve, i të lumturve, të
vrrarëve, të dashuruarve,
nga e para, në orën dymbëdhjetë të natës.

Mes-natë, mes-minutë, mes-sekundë, fjalë
goje,
njeriu që nuk ka marrë pjesë në krim,
dhe krimbi i mëndafshit që kërkon flutur
dhe paqe,
në orën dymbëdhjetë të natës, por nuk i
mjafton koha.

Larg

I mban fëshfërimat e pemëve të mia të
largëta zbrazëtia,
e pluhurit të palmave të ndenjura si peshq,
në guximin e diellit lëviz edhe nepërka ime
prej guri,
që të gjallë, reale dhe të freskët më bën,
larg maleve të mi dhe detit tim.

Si këpucët që më mbajnë përditë,
është ky vend i largët, i huaj,
por shumë i rehatshëm,
plot e përplot me një zbrazëti të ëmbël,
të mbushur me plasaritje të tjera të
hapura,
ku këmba mund të mbjellë humnera plot.

Vazo

Limoni i mbjellë në vazo,
kapër xen çdo triumf për të treguar,
arsyen dhe përmasat,
që mund të japin fruta dhe lulëzim,
përbetimin tregon, kalkulacionin më të
vetmuar,
përrjashtimin e çdo prove tjetër.

Gruaja dhe burri po kështu,
vendosen në një familje,
por tarraca është tjetër, s’pjell,
shkenca të lavdishme, as tradhëti,
të ardhmen e ka poshtë.

Të dëbuara prej plagëve,
janë këto vazo të vogla,
që përsërisin plot sukses,
mëmën dhe dheun.

Balta

Kur zemërohem, zemërohesha,
këpucët më shpinin dje.

Kur zemërohesha, zemërohem,
këpucët më shpinin sot.

Biblike, simfonike, akademike, butaforike,
skelektike, satirike, ironike, ciklike,
historike, histerike.

Balta kërkon gjurmë, jo të gishtërinjve,
të të gjithë trupit.

Përshëndetje dhe meteorë

Pluhur ka përshëndetjesh dhe meteorësh,
e gjatë është koha,
koha e një gruaje që me një makinë qepëse
të pluhrosur,

KUNDËRPËRFYTYRIMI

Poezi nga Natasha Lako

tegela u shkon fustanëve të vjetër në një
kthinë të vogël.

E shkurtër është koha,
koha e një burri që mbi një xham troket,
të ndjellë një grua si himn.

Në varësi të zogjve, gjetheve, makinave
qepëse,
birbove, fjalës ‘brick’ që thuhet për tullat,
llojit të mishit,
koha ndryshon brenda për brenda veten
e saj,
po një grua dhe një burrë thonë se,
ata mund të krijojnë një njeri të ndryshëm
nga vetja,
atje buzë një rruge plot agjensi
udhëtimesh dhe spitalesh për
zemrën,
ku një viç i sapo therur si gjithnjë në qetësi
varet kokëposhtë.

Jetoj tepër shkurt në këtë qytet,
pa i përmbledhur dot balonat e sapo
nisura për më tutje,
ndahet e vërteta ku marr pjesë, nga e
vërteta ku nuk marr pjesë,
pluhur ka meteorësh dhe përshëndetj

Të gjalla janë muret nëpër natë

Poshtë gozhdëve të ngulura,
të gjalla janë muret nëpër natë,
dyer e mbërthyer, dritaret,
tjetri pranë, tjetri është gjithnjë çudia.

Do të jetë një ditë shi vështrimi,
do të jetë një ditë vështrimi fjolla bore,
çfarë do të jemi ne s’e dimë aso ore.

Të gozhduara në asfalt, flenë makinat.

Gjithë ajo sipërfaqe e madhe

Kyç i dorës, që të kujton ligjet, por jo
dorën,
sqetullat përkëdhelëse, humbella fshatrash
që vijnë nga larg,
buzët sa një copë deodorant,
flamurët e arbitrave anësorë në faqe,
sumbullat e djersës, që dalin të derdhen
deri nëpër proskat,
kapërxejnë edhe malet,
zemra që të kujton se do pasqyrë dhe çati,
gjithë ajo sipërfaqe e madhe,
bark, bar, asfalt, luginë,
metamorfozë që kërkon të bëhet paqe,
por jo mbi lëkurën time.

Shtator, 2014

Dhé i largët

Flatra a krahë të engjëjve të ndritshëm
janë shtrirë,
ëndrra dhe flakë të trupit të natës,
vetëm dritaret janë zemërmira,
dhe e lënë zemrën time larg.

Të pamata janë vezullimet nga të kundroj,
deri ku lind ti moj foleja ime e vogël,
e largët, prej dheu,
zemra prej teje nis fluturimet, shtegtimet,
shpagimet,
e fjalës, refleksëve tej e përtej ajrit që na
qan në të gjallë,
dhe me përjetësinë na lidh.

E ndritshme, e vogël, e rrallë,
ti foleja ime e largët je,
më e bukur se gjithë bukuritë,
që dikur, humbur i kanë të gjithë
përbindëshat.
22 maj, 2008

E pamundur t’i afroresh qiellit të Tiranës

E pamundur t’i afroresh qiellit të Tiranës,
nëpër zhurma të pakapshme, por të afërta,
dritës, malit, pulave, gjelave prapa.

E pamundur t’i afroresh qiellit në Shën
Mri,
dhe pendimit të një drite të kthyer prapa,
drejt një faqe tjetër mali përkarshi.

E pamundur t’i afroresh malit tjetër në
Tiranë,
si braktisjes së një çështje dite, për një
qiellore,
me bileta të pakapshme si zjarri.

E pamundur t’i afroresh zjarrit të qiellit në
Tiranë,
që shpërthen, tretet, ndërron edhe shuhet
vetvetiu,
duke ikur nëpër ngjyra të paana.

E pamundur të gjesh ngjyrat e qiellit në
Tiranë,
ngjizja e pikturës që në barkun e nënës,
kërkon një pambarim.

Bien vetëm vjershat, qeveritë,
qiellin që e kanë të gjithë,
e pamundur ta rrëzojë, që ta arrijë, një
njeri.

Zonja të bukura

Zonja të bukura, lektorin e Eldorados,
nuk e njeh askush, sepse po fshin paqen,
që do të thotë, përdor peshqir, fshesë,
lecka,
gomë për vizatim të vijave të para të
drejta,
tastierë ‘delete’, frymëmarrje që heq
vdekjen.

Duken të gjitha këto,
po të brohorasim, për bukurinë tuaj,
si për të gjitha gjërat e vjedhura,
prandaj nuk na duhet,
të kthehemi edhe njëherë nga fillimi.



Ju keni shkruar shumë ese, veçanërisht një përmbledhje me titullin “Njeriu dhe ingranazhet” (1951), për efektet dehumanizuese të shkencës dhe teknologjisë. Si ndodhi që një shkencëtar si ju i sheh gjërat në këtë këndvështrim?

Ndonëse kam studiuar fizikë dhe matematikë, disiplina të cilat më ofruan një lloj strehimi abstrakt dhe ideal në një “parajsë platonike” larg kaosit të botës, shumë shpejt kuptova se besimi i verbër që disa shkencëtarë kanë te mendimi i “pastër”, tek arsyeja dhe progresi (zakonisht me “P” të madhe) i ka bërë të anashkalojnë dhe madje të përçmojnë aspekte të tilla thelbësore të jetës njerëzore si pavetëdija dhe mitet që janë në origjinën e shprehjes artistike, me pak fjalë, ana e fshehtë e natyrës njerëzore. Gjithçka që mungonte në veprën time thjesht shkencore e gjeta te romantizmi gjerman dhe, para së gjithash, te ekzistencializmi dhe surrealizmi. Duke larguar sytë nga logaritmet dhe sinusoidet e mia, shikova fytyrën e njeriut, nga e cila nuk e kam larguar kurrë vështrimin.

Disa shkrimtarë të mëdhenj bashkëkohorë kanë arritur të pajtojnë shkencën dhe krijimtarinë...

Mund të jetë kështu, por kjo nuk e lëkund bindjen time se epoka jonë karakterizohet fort nga kundërvënja midis shkencës dhe humanes, e cila sot është bërë e papajtueshme. Që nga iluminizmi dhe ditët e enciklopedistëve dhe para së gjithash që nga shfaqja e pozitivizmit, shkenca ka pësuar një lloj tërheqjeje olimpike, duke u shpëputur nga njerëzimi. Sovraniteti absolut i Shkencës dhe Progresit në pjesën më të madhe të shekujve XIX dhe XX, e ka zvogëluar individin në statusin e një ingranazhi të një makinerie gjigante. Si teoritë kapitaliste edhe ato marksiste, kanë kontribuar në përhapjen e këtij vizioni fatkeqësisht të shtrembëruar, në të cilin individ i shkrihet në rrëmujë dhe misteri i shpirtit zvogëlohet si pjesë e një rrezatimi fizikisht të matshëm.

Megjithatë, edhe në shekullin e nëntëmbëdhjetë, ekzistonte një rrymë e fortë filozofike që vinte në dyshim ngrehinën racionale monumentale të ndërtuar nga Hegeli, pesha e së cilës dërrmonte individin. Mendja më shkon te Kierkegardi, për të cilin keni shkruar shumë.

Kierkegardi ishte mendimtari i parë që pyeti nëse shkenca duhet të ketë përparësi ndaj jetës dhe u përgjigj me vendosmëri se jeta është e para. Që atëherë, objekti i hyjnizuar nga shkenca është zhvendosur si qendra e universit dhe është zëvendësuar nga subjekti, njeriu prej mishi dhe gjaku. Kjo çoi tek Karl Jaspersi dhe Martin Heidegeri, te filozofia ekzistencialiste e shekullit të njëzetë, sipas së cilës njeriu nuk është më një vëzhgues shkencor “i paanshëm”, por një “un” prej mishi, “qenia e paracaktuar të vdesë” për të cilën kam shkruar dhe që është burimi i tragjedisë dhe i metafizikës, format më të larta të shprehjes letrare.

Por jo të vetmet...

Sigurisht që jo, por për mendimin tim janë më të rëndësishmit për shkak të dimensionit të tyre tragjik, transcendent. Duhet të mendojmë për “Shënime nga nëndhesa” e Dostojevskit, atë akuzë të përgjakshme me të cilën, me urrejtje pothuajse të çmendur, ai denoncoi epokën moderne dhe kultin e saj të përparimit.

Jemi pikërisht te letërsia tani...

Po, sepse romani mund të shprehë gjëra që janë përtej qëllimit të filozofisë apo esesë, siç janë pasiguritë tona më të errëta për Zotin, fatin, kuptimin e jetës, shpresën. Romani u përgjigjet të gjitha këtyre pyetjeve, jo thjesht duke shprehur ide, por përmes mitit dhe simbolit, duke u mbështetur në vetitë magjike të mendimit. Gjithsesi, shumë nga personazhet në romane janë po aq realë sa vetë realiteti. A është Don Kishoti “joreal”? Nëse realiteti ka ndonjë lidhje me qëndrueshmërinë, atëherë personazhi i tij i lindur nga imagjinata e Servantesit është shumë më real se objektet që na rrethojnë, sepse ai është i pavdekshëm.

Pra, letërsia e interpreton realitetin?

Fatmirësisht, arti dhe poezia nuk kanë mëtur kurrë

Ernesto Sábato

DUHET TË ZBULOJMË NDJESINË E TË MREKULLUESHME

Përktheu: Granit Zela

të shpëputin racionalen nga joracionalja, ndjeshmërinë nga intelekt, ëndrrën nga realiteti. Ëndrra, mitologjia dhe arti kanë një burim të përbashkët në të pandërgjegjshmen, ato zbulojnë një botë që nuk mund të kishte asnjë formë tjetër shprehjeje. Është absurde të kërkoj nga artistët të shpjegojnë veprën e tyre. Mund ta imagjinoj Bethovenin duke analizuar simfonitë e tij apo Kafkën duke shpjeguar se çfarë donte të thoshte në të vërtetë në “Gjyqi”? Nocioni se çdo gjë mund të “shpjegohet” racionalisht është shenja dalluese e mentalitetit pozitivist perëndimor, tipik i epokës moderne, një epokë që mbivlerëson vlerën e shkencës, arsyes dhe logjikës. Megjithatë, kjo formë e kulturës përfaqëson vetëm një moment të shkurtër në historinë e njerëzimit.

Ju duket se e shihni epokën tonë si fazën përfundimtare në një linjë të mendimit modern që fillon në mesin e shekullit të nëntëmbëdhjetë dhe përfundon në kohën tonë.

Moda letrare nuk duhet të ngatërrohet me prirjet kryesore të mendimit. Në lëvizjen e gjerë dhe tragjike të ideve ka përparime dhe tërheqje, ekskursione anash dhe kundër-rryma. Është e qartë, megjithatë, se jemi dëshmitarë të fundit të një epoke. Ne po jetojmë një krizë qytetërimesh në të cilën ka një lloj konfrontimi midis forcat të përjetshme të pasionit dhe rendit, të patosit dhe etosit, të Dionisiakes dhe Apolonianes.

A mund të zgjidhet kjo krizë?

E vetmja mënyrë se si mund të shpëtojmë nga kjo krizë rrënoqthëse është duke e larguar njeriun e gjallë e të vuajtur nga makina gjigante pjesë e së cilës është bërë dhe që po e shtyp atë. Por nuk duhet harruar, se në agimin e një mijëvjeçari të ri, një epokë nuk përfundon

në të njëjtin moment për të gjithë. Në shekullin e nëntëmbëdhjetë, kur Progresi ishte triumfues, shkrimtarët dhe mendimtarët si Dostojevski, Niçe dhe Kierkegardi nuk ishin “të kohës së tyre”, sepse tashmë, megjithë optimizmin e shkencëtarëve, ata kishin një parandjenjë të katastrofave që na prisnin dhe që duhet të portretizoheshin nga Kafka, Sartri dhe Kamy.

A është kjo arsyeja pse e refuzoni konceptin e “progresit” në art?

Arti nuk mund të përparojë më shumë se një ëndërr, dhe për të njëjtat arsye. A janë makthet e bashkëkohësve tanë më të përparuara se ato të profetëve të Biblës? Mund të themi se matematika e Ajnshtajnit është më e mirë se ajo e Arkimedit, por jo se “Uliksi” i Xhojsit është sipëror ndaj Uliksit të Homerit. Një nga personazhet e Prustit është i bindur se Debussy është kompozitor më i mirë se Bethoveni për arsyen e thjeshtë se ai lindi pas tij. Nuk ka nevojë të jesh muzikolog për të vlerësuar ironinë satirike të Prustit në këtë fragment. Çdo artist gjakon drejt asaj që mund të quhet një absolute, ose drejt një fragmenti të Absolutit, me shkronjën “A”, qoftë ai një skulptor egjiptian në kohën e Ramsesit II, një artist grek i epokës klasike, apo Donatello. Kjo është arsyeja pse nuk ka përparim në art, por vetëm ndryshime dhe nisma të reja që i detyrohen jo vetëm ndjeshmërisë së secilit artist, por edhe vizionit të heshtur apo të qartë të një epoke apo kulture. Një gjë të paktën është e sigurt; asnjë artist nuk është në pozitë më të mirë se një tjetër për t’i arritur këto vlera absolute thjesht sepse ka lindur më vonë.


Pra, nuk besoni se mund të ketë një estetikë universale?

Relativiteti i historisë pasqyrohet në estetikë. Çdo periudhë ka një vlerë mbizotëruese – fetare, ekonomike apo metafizike – që ngjyron të gjitha të tjerat. Në sytë e njerëzve të një kulture fetare të angazhuar me të përjetshmen, kolosi hierarkik dhe gjeometrik i Ramsesit II do të përfshinte më shumë “të vërtetën” sesa një statujë krejtësisht realiste. Historia na tregon se bukuria dhe e vërteta ndryshojnë nga një periudhë në tjetrën, se kultura e zezë dhe kultura e bardhë mbështeten në kritere të ndryshme. Reputacioni i shkrimtarëve, artistëve dhe muzikantëve i nënshtrohet lëkundjeve të lavjerrësit.

Pra, nuk ka asnjë alibi të flasësh për epërsinë e një kulture ndaj një tjetre?

Sot ne kemi bërë një rrugë të gjatë që prej sigurisë pozitiviste dhe “mendimi i ndritur” në përgjithësi. Duke ndjekur punën e Levy – Bruhl, i cili pas dyzet vjet kërkimi pranoi me sinqeritet se nuk mund të shihej asnjë “përparim” në lëvizjen nga magjika te mendimi logjik dhe që të dyja duhej të bashkëjetonin në mënyrë të pashmangshme tek njeriu, të gjitha kulturat duhet të shihen si kultura që meritojnë respekt të barabartë. Më në fund kemi ardhur në pikën e dhënies së drejtësisë për ato që dikur quheshin me përbuzje “kultura primitive”.

Megjithatë, ju jeni të pakënaqur me edukimin në shkolla dhe universitete. Çfarë i mungon sipas jush?



Kur isha i ri, më detyronin të gëlltisja një mal me fakte që i harroja sa më shpejt të mundesha. Në gjeografi, për shembull, mbaj mend vetëm Kepin e Shpresës së Mirë dhe Kejpi Hornin¹, dhe ndoshta vetëm sepse përmenden shpesh në gazeta. Kanë thënë dikur se kultura është ajo që mbetet kur ke harruar gjithçka tjetër. Për një qenie njerëzore, të mësuarit do të thotë të marrësh pjesë, të zbulosh dhe të shpikësh. Nëse njerëzit duan të përparojnë, duhet të formojnë mendimin e tyre, edhe nëse, ndonjëherë, kjo do të thotë të bësh gabime dhe të duhet të kthehesh përsëri në fillim. Ata duhet të eksplorojnë shtigje të reja dhe të eksperimentojnë me metoda të reja. Përndryshe, ne, në rastin më të mirë, thjesht do të krijojmë një racë studiuesish ose, në rastin më të keq, krimba librash ose papagaj që nxjerrin fraza të gatshme nga librat. Libri është një mjet i mrekullueshëm, me kusht që të mos na pengojë të vazhdojmë kërkimin tonë.


Si e shihni rolin e edukatorit?

Sipas etimologjisë, të edukosh do të thotë të zhvillosh, të nxjerrësh atë që ekziston në formë embrionale, të përmbushësh potencialin. Kjo “punë”, ky proces nga mësuesi rrallëherë realizohet plotësisht dhe kjo ndoshta është origjina e të gjitha gabimeve të sistemeve tona arsimore. Nxënësit duhet të detyrohen t’i bëjnë vetes pyetje dhe të binden për padijen e tyre dhe tonën, në mënyrë që të jenë të përgatitur jo vetëm të bëjnë pyetje, por të mendojnë vetë, edhe nëse nuk janë dakord me ne. Është gjithashtu shumë e rëndësishme që ata të jenë në gjendje të bëjnë gabime dhe që ne të pranojmë pyetje dhe qasje që mund të duken të çuditshme. Duke pasur parasysh këtë gjendje shpirtërore, studentët do të kuptojnë se realiteti është pafundësisht më i ndërlikuar dhe më misterioz se zona e vogël që përfshin njohuritë tona. Çdo gjë tjetër do të pasojë vetvetiu. Kjo është ajo që krijon pyetje dhe siguri, përzierja e traditës dhe rrisë që përbën dinamikën kulturore. Siç ka thënë Kanti, njerëzve nuk duhet t’u mësohet filozofia, por duhet t’u mësohet të filozfojnë. Kjo është metoda e “Dialogëve” të Platonit, e mbështetur në shkëmbimin e drejtpërdrejtë, spontan, gjatë të cilit lindin pyetje nga vetëdija jonë për padijen tonë themelore.

Mund të na jepni një shembull konkret?

Shumë kohë më parë, udhëtova nëpër Patagonia² hipur në xhip me një pylltar i cili më tha se sa shumë po zvogëlohej pylli pas zjarrve të njëpasnjëshëm. Ai më tregoi për rolin mbrojtës që luanin selvitë, të cilët i krahasoi me heronjtë stoikë të gardës së ushtrisë, pasi ato sakrifkohen për të vonuar përhapjen e zjarrit dhe për të mbrojtur pemët e tjera. Kjo më bëri të pyes veten se si do të ishte mësimi i gjeografisë nëse do të lidhej me luftën midis specieve, pushtimin e oqeanëve dhe kontinenteve dhe me historinë e njerëzimit, e cila varet nga mjedisi tokësor. Në këtë mënyrë, nxënësi do të krijonte idenë e një aventure të vërtetë, të një beteje emocionuese kundër forcave armiqësore të Natyrës dhe të historisë. Larg peshës së vdekur të njohurive enciklopedike, vëllimeve të pluhurosura dhe ideve të gatshme, njohuritë e ripërtërira kësaj do t’i jepnin çdo nxënësi vazhdimisht ndjenjën e zbulimit dhe pjesëmarrjes në një histori shekullore. Për shembull, të gdhendësh në mënyrë të pashlyeshme në mendjet e studentëve gjeografinë e ndërlikuar të kontinentit amerikan, si përvojë e jetuar dhe jo e mësuar nga libri, a nuk do të ishte mënyra më e mirë për ta mësuar përmes aventurave të eksploruesve të mëdhenj si Magelani apo konkuistadorë të tillë si Kortesio? Duhet të jemi të formuar, jo të informuar. Siç ka thënë Montaigne, “duke mësuar përmendësh, nuk mëson”. Çfarë manuali emocionues i gjeografisë dhe etnologjisë për adoleshentët do të ishte “Rreth botës në tetëdhjetë ditë” i Zhyl Vernit! Duhet të ngjallim habi për misteret e thella të universit. Po ta mendosh, çdo gjë në univers është e habitshme. Por njohja na ka bërë të dëshpëruar dhe asgjë nuk na habit më. Duhet të zbulojmë ndjesinë e të mrekullueshmes.

Ju rekomandoni mësimdhënien “me



prapavështim”, duke filluar nga e tashmja për t’u kthyer në të kaluarën.

Besoj se mënyra më e mirë për t’i bërë të interesuar të rinjtë për letërsinë është të fillojmë me autorë bashkëkohorë, gjuha dhe shqetësimet e të cilëve janë më afër shpresave dhe frikës së studentit. Vetëm më vonë ata mund të kenë interes për atë që shkruan Homeri ose Servantesi për dashurinë dhe vdekjen, shpresën dhe dëshpërimin, vetminë dhe heroizmin. E njëjta gjë mund të bëhet me historinë duke gjurmuar rrënjët e problemeve aktuale. Është gjithashtu një gabim të përpikësh të rrokësh gjithçka. Duhet të jepen mësim vetëm disa episode dhe probleme thelbësore, të mjaftueshme për të siguruar një strukturë. Duhet të përdoren pak libra, por duhet të lexohen me pasion. Kjo është mënyra e vetme për të shmangur që leximi të duket si një shëtitje në një varrezë të botëve të vdekura. Leximi është i vlefshëm vetëm nëse shkakton një shkretimë mendjen e lexuesit. Ekziston një lloj mësimdhënie pseudoenciklopedike, e lidhur me mësimin e librit, e cila është një formë vdekjeje. A thua se nuk kishte kulturë para Gutenbergut!

Për vite me radhë keni vënë në dukje rreziqet e qenësishme të armëve bërthamore, në garën e armatimit dhe në konfrontimin ideologjik në mbarë botën. A nuk janë trazirat e viteve të fundit, dhe veçanërisht muajt e fundit, duke e hequr një pjesë të forcës nga ky mesazh?

Nuk jam i sigurt për këtë. Para së gjithash, përhapja e armëve bërthamore është një fakt. Shumë vende tashmë kanë “mini-bombat” e tyre atomike dhe një reaksion zinxhir që fillon me disa veprime terroriste

të papërgjegjshme nuk mund të përjashtohet. Por ky është vetëm aspekti thjesht “fizik” i çështjes, ai i përbindshmi. Ajo që më shqetëson vërtet është katastrofa shpirtërore me të cilën përballet epoka jonë, e cila është rezultati i trishtuar i shtypjes së forcave të pavetëdijes në shoqërinë bashkëkohore. Jetojmë në një epokë të ankthshme, neurotike, të paqëndrueshme, prej nga vjen shpeshtësia e çrregullimeve psikosomatike, rritja e dhunës dhe e përdorimit të drogës. Kjo është një çështje filozofike dhe jo policore. Deri vonë, rajonet “periferike” të botës ishin të paprekura nga ky fenomen. Në Lindje për shembull, si dhe në Afrikë dhe në Oqeani, traditat mitologjike dhe filozofike ruanin një harmoni të caktuar midis njeriut dhe botës. Kjo katastrofë mendore po na çon drejt një shpërthimi të tmerrshëm psikologjik dhe shpirtëror, i cili do të shkaktojë një valë vetëvrasjesh dhe skena histerie dhe çmendurie kolektive.

Nuk shihni asgjë pozitive në këtë bilanc?

Ndoshta po, por sinqerisht dyshoj se i përkas një race që është në rrugën e zhdukjes. Unë besoj te arti, dialogun, liria dhe dinjiteti i qenies njerëzore si individ. Po kujt i interesojnë sot marrëzi të tilla? Dialogu ia ka lënë vendin fyerjes dhe liria burgjeve politike. Cili është ndryshimi midis një shteti policor të krahut të majtë dhe atij të djathtë? Sikur paska tortura të mira apo të këqija! Duhet të jem reaksionar sepse ende besoj në demokracinë e mërzitshme, mediokre, të vetmin regjim që, në fund të fundit, e lejon njeriun të mendojë lirshëm dhe të përgatisë rrugën për një realitet më të mirë.


Revista, *Art Nouveau*, Gusht 1990

¹ Pjesa më jugore e arkipelagut Tierra del Fuego e Kilit jugor, në ishullin e vogël Hornos.

² Rajon gjeografik që përfshin skajin jugor të Amerikës së Jugut.

Shtatë dekada krijimtari në shtatë vëllime

botuar nga Onufri



KADARE

VEPRA E PLOTË

Sot, Ismail Kadare do të nënshkruajë librat e tij në
stendën e Onufrit në Panairin e Librit

E shtunë, 18 nëntor | Ora 12.30